



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 333 Akti

Nr. 479 Vendimi

Tiranë, më 3.12.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Steven Kessler, në datën 25.11.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*) Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arben Dosti**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) më 12.11.2019, zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Brunilda Bektoshi dhe Pamela Qirko. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 2.12.2019, u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Alma Faskaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Me vendimin nr. ***, datë 9.3.2020, Komisioni vendosi rishpërndarjen me short të çështjeve të vitit 2018 dhe 2019 të komisionerit, znj. Alma Faskaj, si pasojë e mungesës për shkaqe objektive të justifikuar. Në vijim, nga procedurat e shortit¹ zëvendësuese për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti, rezultoi komisioneri, znj. Genta Tafa (Bungo), e cila deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit.
7. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
10. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

¹ Vendimi i Komisionit nr. ***, datë 9.3.2020 “Për rishpërndarjen me short dhe transferimin e çështjeve të komisionerit znj. Alma Faskaj, me cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të caktuara me procedurat e shortit të muajit shtator, nëntor 2018 dhe janar, mars dhe nëntor 2019”.

11. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin² e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

12. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportet e mbajtura për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

14. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

15. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 5.11.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosti; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

16. Subjekti i rivlerësimit, në datën 5.11.2021, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 10.11.2021, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe të provave të reja në datën 22.11.2021.

17. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me e-mail, në datën 23.11.2021.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosti, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 25.11.2021, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

² Akti përfundimit të kontrollit me nr. *** prot., datë 21.11.2018.

³ Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. *** prot., datë 23.10.2020.

18.1. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Zoti Arben Dosti ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

19.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.3. Por, referuar vendimit nr. 2/2017⁴ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

20.4. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të

⁴ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

21.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe, duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

21.2. Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI, në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

22. Pasuria e llojit “apartament banimi” në bashkëpronësi, ndodhur në Kuçovë, përfituar në bazë të ligjit privatizimit (ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”). Subjekti ka deklaruar se zotëron 1/3 pjesë takuese të saj dhe se kjo pasuri është e pavlerësuar që nga koha e blerjes.

22.1. Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: konfirmohet deklarimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Kuçovë për apartamentin e përfituar nga privatizimi.

22.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: konstatohet se në deklaratën e interesave privatë/para fillimit të detyrës (dorëzuar në ILDKPKI në datën 13.1.2014) subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në vlerën prej 5,000,000 lekësh.

22.3. I pyetur nga Komisioni në lidhje me vlerën e deklaruar të kësaj pasurie në deklaratën e interesave privatë/para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *këtë çështje e ka sqaruar edhe në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI në datën 19.9.2014 - në të cilin ka shpjeguar se shuma e deklaruar 5,000,000 lekë është deklaruar prej tij si vlerë reale e apartamentit dhe jo çmimi i tij, i cili ka qënë simbolik, fakt⁵, i cili u vërtetua pas verifikimeve të kryera nga Komisioni.*

22.4. Si konkluzion, nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së⁶, Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie - për mënyrën e përfitimit dhe për pjesën takuese që ai zotëron mbi të.

23. Pasuria e llojit “automjet”, i markës “****”, blerë në vitin 2003, në vlerën prej 800,000 lekësh. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga puna.

23.1. Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: deklarim i pasaktë i subjektit lidhur me vlerën e automjetit tip “****”, deklaruar 800,000 lekë, si në deklaratën “Para fillimit të detyrës 2013”, ashtu

⁵ Shih dokumentacionin e dërguar bashkëlidhur shkresës së ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë 20.1.2021; (i) shkresa e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë 8.9.2014; dhe (ii) kthim përgjigjeje e subjektit të rivlerësimit, që mban datën 19.9.2014.

⁶ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti, kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.1994, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresa e ZVRPP-së Kuçovë nr. *** prot., datë 14.9.2017, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

edhe në deklaratën e rivlerësimit. Çmimi referuar kontratës së blerjes të paraqitur nga vetë subjekti është 950,000 lekë.

23.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: në deklaratën e interesave privatë/para fillimit të detyrës (dorëzuar në ILDKPKI në datën 13.1.2014) subjekti e ka deklaruar këtë automjet, blerë në vitin 2003 me të ardhurat nga puna, në shumën prej 800,000 lekësh.

23.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje⁷, rezulton se në datën 26.4.2003 subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin me targë FR *** B, në shumën prej 950,000 lekësh. Në vitin 2010 dosja e këtij automjeti është transferuar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Berat, duke u targuar KV *** B. Në vijim, konstatohet se ky automjet ka marrë targat AA *** BG, të cilat i ka disponuar edhe në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

23.4. Sa më sipër, konstatohet mospërputhje mes çmimit/vlerës të/së deklaruar nga subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në deklaratën “Vetting”, me çmimin/vlerën e referuar në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie.

23.5. I pyetur nga Komisioni në lidhje me këtë fakt – subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se, *...në momentin e deklarimit nuk kishte kohë për të konsultuar aktin e shitblerjes dhe ka kryer një deklaram të përafërt, por vlera e paguar ka qënë realisht 950,000 lekë.*

23.6. Komisioni konstaton se, megjithëse në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar vlerën e këtij mjeti në shumën prej 800,000 lekësh, gjithsesi ai ka depozituar si dokumentacion provues për këtë pasuri kontratën e shitblerjes⁸ të datës 26.4.2003, e cila referon çmimin prej 950,000 lekësh.

23.7. Gjithashtu, konfirmohet se, i pyetur nga ILDKPKI-ja, në datën 19.9.2014 subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtin shpjegim lidhur me mosdeklarimin e vlerës së saktë të blerjes së kësaj pasurie⁹.

23.8. Të njëjtin qëndrim subjekti e ka mbajtur edhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, duke shtuar se në kohën e blerjes së këtij automjeti, rreth 10 vjet para fillimit të detyrës, ka pasur të ardhura të konsiderueshme, të cilat mundësonin blerjen e tij.

23.9. Në këtë kuptim, trupi gjykues çmon se kemi të bëjmë me deklaram të pasaktë sa i përket çmimit të blerjes së kësaj pasurie, por gjithsesi krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur qëllim fshehjen e vlerës reale të blerjes, për sa kohë ky automjet është blerë shumë kohë më parë se të fillonte detyrën, dhe, për më tepër, ka qënë pasuri e luajtshme e regjistruar në regjistrat publikë.

23.10. Siç u konstatua më sipër, si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat e tij nga puna. Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ, rezulton se provohen me dokumentacion justifikues ligjor vetëm të dhëna të punësimit të subjektit në shoqërinë “***” sh.p.k., për periudhën para blerjes së këtij automjeti.

⁷ (i) Kopje e kontratës së shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.4.2003, redaktuar nga noteri, znj. A.B, depozituar nga subjekti si dokumentacion shoqërues – bashkëlidhur deklaratës “Vetting”, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së; (ii) Kthim përgjigjeje e DPSHTRR-së, me nr. *** prot., datë 14.7.2017 dhe nr. *** prot., datë 11.9.2017, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së; (iii) Kthim përgjigjeje e DPSHTRR-së - administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, me nr. *** prot., datë 26.3.2020, nr. *** prot., datë 1.4.2020, dhe nr. *** prot., datë 11.3.2021.

⁸ Kontratë e depozituar - si dokumentacion provues për kontrollin e ushtruar ndaj këtij subjekti nga ILDKPKI-ja në vitin 2014, si edhe me dorëzimin e deklaratës “Vetting”.

⁹ Shih dokumentacionin e dërguar bashkëlidhur shkresës së ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë 20.1.2021; (i) shkresa e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë 8.9.2014; dhe (ii) kthim përgjigjeje e subjektit të rivlerësimit, që mban datën 19.9.2014.

23.11. Por, rezulton se të ardhurat nga punësimi - të provuara me dokumentacion justifikues ligjor¹⁰, nuk janë të mjaftueshme për të mundësuar pagesën e çmimit prej 950,000 lekësh, për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

23.12. Gjithsesi, analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie do të kryhet në vijim – në këtë vendim, për sa kohë rezulton se ky automjet është blerë rreth 10 vjet para fillimit të detyrës dhe se të gjitha pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, të deklaruara si të krijuara para fillimit të detyrës, pretendohet se kanë të njëjtat burime të ardhurash të referuara nga subjekti në DIP-vjetore, shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, deklaratën “Vetting”, si edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

24. Pasuria e llojit “likuiditete”, deklaruar shuma prej 100,000 eurosh, e dhënë hua. Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se i ka dhënë hua shtetasve I.E dhe A.E shumën prej 100,000 eurosh, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.4.2014.

24.1. Konstatimi i ILDKPKI-së: (i) subjekti ka dokumentuar huadhënien me kontratën e huas, në të cilën citohet se huamarrësi e ka marrë huan për ta përdorur për nevoja të tij, si edhe kontratën e blerjes së apartamentit nga huamarrësit. Harta e pronës e paraqitur nuk vërteton ku ndodhet dhe në emër të kujt; (ii) referuar sqarimit të paraqitur nga subjekti, kushti i vënë në kontratën e huadhënies për kthimin e huas nuk është bazë për këtë marrëdhënie, pasi verbalisht palët kanë rënë dakord që huadhënësi do të shpërblehet me apartament banimi në pallatin që pritet të ndërtohet në tokën e huamarrësve në Tiranë. Nuk ka paraqitur dokument për këtë shpjegim.

24.2. Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar burimin e shumës prej 100,000 eurosh, të dhënë hua në favor të të tretëve. Por, nga ana tjetër Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës “Vetting”, dokumentin - shpjegime lidhur me deklaratimet për pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre¹¹, nëpërmjet të cilit ka shpjeguar se kjo shumë e dhënë hua është pjesë nga depozitat në total në shumën prej 200,000 eurosh, të cilat janë deklaruar si të krijuara prej tij para fillimit të detyrës, me burim krijimi: (i) të ardhura të padokumentuara nga puna në emigracionin në Greqi, për periudhën korrik 1992 – 28 maj 2000; (ii) të ardhura të padokumentuara nga bashkëpunimi me shoqërinë “****” sh.p.k., për periudhën 2000 - 2010; (iii) të ardhura të padokumentuara nga dhënia me qira lokalit të ndodhur në Kuçovë, i cili ishte përfituar nga privatizimi, për periudhën nga viti 1991 - 10.1.2005; (iv) të ardhurat nga shitja e lokalit në Kuçovë, të përfituar më parë nga privatizimi; (v) të ardhura nga punësimi në Komunën Perondi, në periudhën janar 2007 – dhjetor 2008; (vi) të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit si avokat, person fizik, në periudhën korrik 2008 – shtator 2011; dhe (vii) të ardhurat e bursës në Shkollën e Magjistraturës në periudhën tetor 2011 – nëntor 2013. Në mbështetje të deklaratimeve të tij subjekti ka depozituar një sërë dokumentesh.

24.3. Deklarimi i kësaj huaje në vite: referuar deklaratës së interesave privatë - para fillimit të detyrës (depozituar nga subjekti në datën 13.1.2014 në ILDKPKI) konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë: (i) depozitë bankare në bankën “Credins”, në shumën prej 100,000 eurosh; (ii) depozitë bankare në bankën “Credins”, në emër të bashkëshortes në shumën prej 50,000 eurosh; dhe (iii) depozitë bankare në bankën “Societe Generale Albania”, në emër të bashkëshortes, në shumën prej 49,800 eurosh. Si burim krijimi të këtyre pasurive, subjekti ka deklaruar të ardhura të grumbulluara nga puna si emigrant, sipërmarrës dhe avokat.

24.4. Në DIP/2014, subjekti ka deklaruar dhënie huaje të shumës 100,000 euro shtetasve A. E dhe I.E, shumë e cila ndodhej në depozitë në “Credins Bank”. Në seksionin e veçantë të kësaj deklarate ka deklaruar kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.4.2014, me shtetasit A.E dhe I.E për shumën 100,000 euro.

¹⁰ Shiko librezën e punës, depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së, si edhe shkresat e ISSH-së, Drejtoria Rajonale Berat - administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, me nr. *** prot., nr. *** prot., datë 7.1.2021.

¹¹ Dokument, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

24.5. Konfirmohet se me kontratën e huas së datës 28.4.2014, subjekti i rivlerësimit u ka dhënë hua shtetasve I. E dhe A.E, vlerën prej 100,000 euro, shumë e cila deklarohet nga palët se është dhënë dhe marrë jashtë zyrës noteriale.

24.6. Nga hetimi i kryer rezultoi se, në datën 14.5.2013, personi i lidhur ka depozituar *cash* në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”¹² (llogaria nr. ***) vlerën prej 100,000 euro, me përshkrimin “*E.D arkëton të ardhura nga emigracioni, kursime familjare, avokati, biznes privat*”, dhe, në vijim, kjo shumë së bashku me një pjesë të gjendjes së llogarisë prej 1,000 eurosh investohet brenda ditës në depozitë me afat 3-mujor. Konstatohet se, pasi kjo depozitë maturohet, në datën 15.8.2013, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr *cash* nga kjo llogari, shumën prej 100,000 eurosh.

24.7. Referuar informacionit/dokumentacionit të dërguar nga “Credins Bank”¹³ rezulton se, po në datën 15.8.2013, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e tij shumën prej 100,000 euro, me përshkrimin “*Derdh Arben Dosti tërhequr nga RZB*”, të cilën e ka investuar në depozitë me afat. Pas maturimit të kësaj depozite, në datën 2.4.2014, nga kjo llogari, subjekti ka tërhequr *cash* shumën prej 100,422 eurosh¹⁴.

24.8. Në materialin shpjegues të depozituar me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, lidhur me këtë marrëdhënie huaje - subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në bankën “Credins” ka pasur në llogarinë e tij shumën 100,000 euro. Këtë shumë e ka tërhequr nga banka “Credins”, filiali tek fillimi i rrugës “***”, në datën 02.04.2014 dhe ia ka dhënë hua *cash* menjëherë pas tërheqjes z. I.E (***) dhe motrës së tij znj. A.E (***), të cilët i ka miq që prej fëmijërie. Shumën e mësipërme e ka dorëzuar *cash* në filialin e bankës “Alpha” që ndodhet tek Stadiumi “***”, tek kryqëzimi i ***. Nuk bënë transaksion bankar pasi ishin banka të ndryshme dhe transaksioni kushtonte shumë. Paratë janë dorëzuar për blerjen e një apartamenti të rregulluar në zyrë pune në katin e tretë të kullës që ndodhet ngjitur me stadiumin “***”.

24.9. I pyetur nga Komisioni¹⁵ në lidhje me këtë marrëdhënie huaje, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se...*marrëdhënia me huamarrësin është miqësore dhe familjare...Huaja është dhënë për blerjen e një apartamenti tek stadiumi “***”...Shuma prej 100,000 eurosh ka qenë në llogarinë e subjektit në “Credins Bank”, të cilat më pas janë tërhequr cash dhe i janë dhënë shtetasve I dhe A.E.*

24.10. Në vijim, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës “Vetting”¹⁶, në datën 2.4.2014 shtetasja A.E (pala huamarrëse) ka depozituar *cash* në “Alpha Bank” shumën prej 100,000 eurosh - në llogari të noterit publik, znj. V.S, me përshkrimin “*Derdhje për shitblerje apartament banimi, blerës A.E shitës kompania “***”sh.p.k*”. Gjithashtu, rezulton se në datën 28.4.2014 është lidhur kontrata e shitblerjes¹⁷ midis shtetasës A.E, në cilësinë e palës blerëse dhe shoqërisë “***” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse, me objekt shitjen e pasurisë së paluajtshme, të llojit “apartament”, të ndodhur në Tiranë, për çmimin prej 28,697,950 lekësh, nga të cilat 14,698,950 janë likuiduar nga pala blerëse, ndërsa pjesa tjetër prej 13,999,000 lekësh është depozituar në llogarinë e noterës V.S. Konfirmohet se në datën 7.5.2014 pasuria objekt i kontratës së mësipërme është regjistruar në emër të shtetasës A.E¹⁸.

24.11. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se konfirmohet dhënia e huas në vlerën prej 100,000 eurosh nga subjekti i rivlerësimit, me burim fondet e tërhequra nga “Credins Bank”.

24.12. Ndërsa, analiza e burimit të krijimit të shumës prej 100,000 eurosh, të dhënë hua, do të kryhet në vijim – në këtë vendim, për sa kohë rezulton se të gjitha pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, të deklaruara si të krijuara para fillimit të detyrës, pretendohet se kanë të njëjtat burime të ardhurash – të referuara nga subjekti në DIP-të vjetore, shpjegimet e dhëna në ILDKPKI,

¹² Shkresa e “Raiffeisen Bank” nr. *** prot., datë 12.3.2020, (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.4.2020).

¹³ Shkresa nr. *** prot., datë 9.4.2020, protokolluar në Komision me nr. **** prot., datë 14.4.2020.

¹⁴ Mandattërheqje i shumës 100,422 euro nga “Credins Bank”, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁵ Pyetëtori nr. 2, pyetja nr. 10.

¹⁶ Mandatarkëtimi në “Alpha Bank”, i datës 2.4.2014.

¹⁷ Depozituar nga subjekti kontratë shitblerjeje prone -pasurie të paluajtshme, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.4.2014.

¹⁸ Depozituar nga subjekti – bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, kopje e dokumentit certifikatë pronësie nr. ***.

deklaratën “Vetting”, si edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

Deklarimi i pasurive veçmas, nga personi i lidhur – bashkëshortja, znj. E.D.

25. Pasuria e llojit “likuiditet”, depozitë bankare - në bankën “Societe Generale Albania” në shumën prej 45,000 eurosh – me burim krijimi të ardhurat nga puna e bashkëshortit.

25.1. Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: konfirmohet depozita e deklaruar dhe dokumentuar nga subjekti me përgjigjen e ardhur nga “Societe Generale Bank”.

25.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (dorëzuar në ILDKPKI në datën 13.1.2014), në seksionin “Deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitën bankare në bankën “Societe Generale Albania”, në emër të bashkëshortes, shumën prej 49,800 eurosh. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga puna e tij si emigrant, sipërmarrës dhe nga aktiviteti i avokatisë.

25.3. Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga “OTP Bank”¹⁹ (shoqëria e cila ka blerë “SGA Bank”), rezulton se:

(i) në datën 11.10.2013, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka depozituar *cash* në llogarinë dyemërore në valutë, në emër të saj dhe subjektit (llogaria me nr. ***) vlerën 49,800 euro, duke e investuar këtë shumë në depozitë me afat. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2013, ka qenë në shumën 49,800 euro. Komisioni konstaton se në deklaratën para fillimit të detyrës subjekti ka deklaruar se kjo depozitë është në emër të bashkëshortes së tij, ndërkohë pas verifikimit të kryer rezultoi se ajo ka qenë në llogari të përbashkët dyemërore.

(ii) Gjatë vitit 2014 është përfituar si interes i kësaj depozite shuma 546 euro, për të cilën është mbajtur tatimi në shumën 54,63 euro. Në vijim, në datën 14.4.2014 personi i lidhur ka tërhequr nga kjo llogari shumën 280 euro dhe më pas e ka kaluar të gjithë shumën e mbetur në llogarinë dyemërore në valutë – referuar si më sipër, në llogarinë në valutë në emër të saj, në po të njëjtën bankë (llogaria nr. ***). Rezulton se gjendja e kësaj llogarie, në datën 31.12.2014, ka qenë në vlerën 50,012 euro.

Komisioni konstaton se në DIP/2014, përfshirë edhe deklarinimin e bërë veçmas nga personi i lidhur, nuk është pasqyruar kalimi e këtyre fondeve nga llogaria dyemërore në llogarinë e bashkëshortes së subjektit, si dhe nuk është deklaruar si shtesë pasurie shuma 212 euro, që përfaqëson diferencën pozitive mes gjendjes së llogarisë bankare në “SGA Bank” në datën 31.12.2014 (llogaria në emër të personit të lidhur) me gjendjen e saj në datën 31.12.2013 (llogaria dyemërore). Por, nga ana tjetër, rezulton se në seksionin e të ardhurave, personi i lidhur ka deklaruar shumën 550 euro, si të ardhura nga depozitat bankare.

(iii) në datën 11.5.2015, shuma 50,000 euro (pjesë e shumës 50,012 euro) është investuar në depozitë me afat (llogaria nr. ***)

(iv) pas përfitimit të interesave bankarë nga maturimi i kësaj depozite, mbajtjes së tatimit përkatës mbi to, si edhe tërheqjeve të kryera nga personi i lidhur, gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2015, rezulton të jetë në shumën 50,012 euro.

(v) pas investimit disa herë në depozita më afat të vlerave, pjesë të shumës 50,012 euro, si edhe disa tërheqjeve të kryera dhe depozitimeve të konstatuara në këtë llogari, rezulton se gjendja e saj në datën 31.12.2016 ka qenë në vlerën 45,012 euro.

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur në DIP/2016 nuk ka deklaruar në seksionin përkatës pakësimin e gjendjes së llogarisë në “Societe Generale Albania”, por, nga ana tjetër, rezulton se në DIP/2016, në seksionin e shpenzimeve të deklarueshme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar tërheqjen e shumës prej 5,000 eurosh nga llogaria bankare në emër të bashkëshortes, në bankën “Societe Generale Albania”, shpenzuar për nevoja familjare, pushime, arsimimin e fëmijëve, arredim shtëpie me qira (vendndodhja Gjirokastër) etj.

¹⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 9.4.2020 (protokolluar në Komision nr. ***prot., datë 14.4.2020).

(vi) Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie, për periudhën 1.1.2017 – 25.1.2017 (data e dorëzimit të deklaratës “Vetting”), nuk konstatohen transaksione të kryera. Si rrjedhim, rezulton se gjendja e kësaj depozite në datën 25.1.2017 ka qenë në vlerën 45,012 euro.

25.4. Sa më sipër, Komisioni konstaton se personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) – në deklaratën “Vetting” ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me gjendjen e llogarisë “depozitë” në “Societe Generale Bank” (sot banka “OTP”).

25.5. Analiza e burimit të krijimit të kësaj pasurie do të kryhet në vijim – në këtë vendim, për sa kohë rezulton se të gjitha pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, të deklaruara si të krijuara para fillimit të detyrës, pretendohet se kanë të njëjtat burime të ardhurash – të referuara nga subjekti në DIP-të vjetore, shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, deklaratën “Vetting”, si edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

26. Pasuria e llojit “likuiditet”, depozitë bankare në “Credins Bank”, në shumën prej 50,000 eurosh, me burim krijimi të ardhurat nga puna e bashkëshortit

26.1. Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: konfirmohet depozita e deklaruar dhe dokumentuar nga subjekti me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

26.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (dorëzuar në ILDKPKI në datën 13.1.2014), në seksionin “Deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitën bankare në bankën “Credins”, në emër të bashkëshortes, shumën 50,000 euro. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga puna e tij si emigrant, sipërmarrës dhe nga aktiviteti i avokatisë.

26.3. Komisioni konstaton se në DIP/2014 (deklarimin e bërë veçmas) – në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit” personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka deklaruar se i ka dhënë hua shtetasve A.E dhe I.E shumën 50,000 euro, e cila përfaqëson vlerën të cilën ajo e kishte gjendje në llogarinë “depozitë” në “Credins Bank”, sipas deklarimit të bërë në deklaratën para fillimit të detyrës. Gjithashtu, në seksionin e veçantë të DIP/2014, personi i lidhur ka deklaruar kontratë verbale huaje me shtetasit A.E dhe I.E, për shumën 50,000 euro.

26.4. Ndërsa, në DIP/2015 (deklarimin e bërë veçmas), në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka deklaruar kthimin e shumës 50,000 euro nga huamarrësit A.E dhe I.E dhe depozitim të saj në “Credins Bank”.

26.5. Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga “Credins Bank”²⁰, rezulton se:

(i) në datën 4.10.2013, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka depozituar *cash* (në llogarinë në emër të saj në valutë, me nr. ***) vlerën 50,000 euro, duke e kaluar këtë shumë në depozitë me afat 1-mujor.

(ii) në datën 5.11.2013, mbas maturimit të depozitës, nga gjendja e llogarisë me nr. ***, – personi i lidhur ka transferuar në llogarinë me nr. ***, shumën prej 49,000 euro, duke e kaluar në depozitë me afat 3-mujor. Gjendja e kësaj llogarie depozitë në datën 31.12.2013 ka qenë në shumën 49,000 euro. Ndërsa, gjendja e llogarisë me nr. ***, në datën 31.12.2013, ka qenë në shumën 98.5 euro.

(iii) në datën 5.2.2014, mbas maturimit të depozitës dhe përfitimit të interesave kreditorë në shumën 200 euro, nga gjendja e llogarisë me nr. ***, personi i lidhur ka transferuar në llogarinë me nr. *** shumën 49,000 euro.

(iv) në datën 2.9.2014, mbas përfitimit të disa interesave kreditorë (total rreth 350 euro) dhe kryerjes së disa tërheqjeve në vlera të vogla monetare, rezulton se nga llogaria me nr. *** është tërhequr *cash* shuma 20,050 euro;

(v) gjithashtu, po në datën 2.9.2014, nga llogaria nr. ***, personi i lidhur ka transferuar në llogarinë me nr. ***, shumën 29,000 euro, duke e kaluar në depozitë me afat 3-mujor.

²⁰ Shkresa e “Credins Bank” me nr. *** prot., datë 9.4.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 14.4.2020).

(vi) në datën 2.12.2014 është maturuar depozita në llogarinë nr. *** dhe janë përfituar interesat kreditorë në shumën 58 euro, të tërhequra *cash* në datën 4.12.2014;

(vii) në datën 31.12.2014, personi i lidhur ka depozituar *cash* në llogarinë nr. *** shumën prej 1,000 euro;

(viii) po në datën 31.12.2014, nga kjo llogari është tërhequr *cash* shuma 30,000 euro. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2014 ka qenë zero euro.

26.6. Siç u konstatua më sipër, në DIP/2014, personi i lidhur ka deklaruar se u ka dhënë hua shtetasve A.E dhe I.E shumën 50,000 euro.

26.7. Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit bankar të dërguar nga “Raiffeisen Bank”²¹ rezulton se, në datën 7.1.2015, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në llogarinë e tij në këtë bankë shumën 50,000 euro dhe, në vijim, në datën 8.1.2015, e ka transferuar këtë shumë në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin “Kontratë rep ***, kol *** shlyerje detyrimi nga I.E”.

26.8. I pyetur nga Komisioni lidhur me këto transaksione, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në datën 31.12.2014, shuma 50,000 euro i është dhënë *cash* në dorë shtetasit I.E, por për efekt dokumentimi për interes të dy palëve, disa ditë më vonë vendosën ta bëjmë kalimin nëpërmjet bankës. Për të mos pasur kalime të kota nëpër llogari, shumën e depozituar në llogari e ka kaluar direkt tek personi, të cilit I.E. dhe A. E. do të kalonin këtë shumë. Në vijim deklaroi se është një shumë e vetme e dhënë hua dhe e kthyer plotësisht *cash* nga huamarrësit dhe bashkëshortja e ka ridepozituar në bankë.

26.9. Në mbështetje të deklarimit të tij, subjekti ka depozituar kontratën e porosisë²² të datës 7.1.2015, në referim të së cilës konstatohet se shtetasi I.E. ka porositur nga shoqëria “***” sh.p.k., dy pasuri të llojit “apartment”, me vlerë totale 90,000 euro.

26.10. Komisioni vëren se në DIP/2015, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka deklaruar shumën 50,000 euro, me burim kthimin e saj prej huamarrësve A.E dhe I.E. Gjithashtu, personi i lidhur ka deklaruar se e ka depozituar këtë shumë në “Credins Bank”.

26.11. Në vijim të verifikimit të informacionit/dokumentacionit të dërguar nga “Credins Bank”²³, rezulton se në datën 23.10.2015, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka depozituar *cash* në llogarinë e saj (llogaria me nr. ***) në këtë bankë, shumën 50,000 euro, me përshkrimin “*kthim huaje E.D*” dhe më pas e ka kaluar këtë shumë në depozitë me afat 6-mujor, duke e transferuar në llogarinë me nr. **. Gjendja e kësaj llogarie “depozitë” në datën 31.12.2015 ka qenë në shumën 50,000 euro. Në datën 10.6.2015, pasi më parë ishin përfituar dhe tërhequr interesat kreditorë, nga llogaria me nr. **, personi i lidhur ka transferuar në llogarinë nr. ** vlerën 50,000 euro, duke e kaluar këtë shumë në depozitë me afat 6-mujor. Mbas përfitimit të disa interesave kreditorë dhe tërheqjes së tyre, në datën 31.12.2016, gjendja e llogarisë (nr. **) ka qenë në shumën 50,000 euro. Gjithashtu, rezulton se deri në datën 25.1.2017, data e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, nuk janë kryer transaksione në këtë llogari.

26.12. Sa më sipër, Komisioni konstaton se personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) – në deklaratën “Vetting” ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me gjendjen e llogarisë “depozitë” në “Credins Bank”.

26.13. Analiza e burimit të krijimit të kësaj pasurie do të kryhet në vijim, në këtë vendim, për sa kohë rezulton se të gjitha pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, të deklaruara si të krijuara para fillimit të detyrës, pretendohet se kanë të njëjtat burime të ardhurash – të referuara nga subjekti në DIP-të vjetore, shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, deklaratën “Vetting”, si edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

²¹ Shkresa e “Raiffeisen Bank” me nr. *** prot., datë 12.3.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.4.2020).

²² Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.1.2015.

²³ Shkresa e “Credins Bank” me nr. *** prot., datë 9.4.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 14.4.2020).

Deklarimi i pasurive veçmas, nga personi i lidhur – nëna e subjektit, znj. L.D

27. Pasuria e llojit “likuiditet”, depozitë bankare në bankën “Societe Generale Albania”, në shumën prej 4,000,000 lekësh

27.1. Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: konfirmohet depozita e deklaruar dhe dokumentuar nga subjekti, me përgjigjen e ardhur nga “SGA Bank”.

27.2. Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, personi i lidhur nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, por vetëm të ardhura nga pensioni i pleqërisë (familjar) që përfiton prej vitit 2004, në total në shumën afërsisht 1,500,000 lekë.

27.3. I pyetur nga Komisioni për burimin e krijimit të kësaj depozite²⁴ – subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka shpjeguar se *nëna ka pasur në pronësi pasurinë e llojit njësi tregtare, të privatizuar prej saj në vitin 1991, si punonjëse e Ndërmarrjes së Tregtisë Kuçovë. Vlera e privatizimit të dyqanit ka qenë rreth 20,000 – 30,000 lekë dhe është paguar në vitin 1992 ose 1993. Në vitin 1997, fillim viti 1998, lokalit i janë bërë disa shtesa, para dhe pas, dhe sipërfaqja është dyfishuar. Gjithashtu, në vitin 2002 kur ai është kthyer nga Greqia, ka kryer rikonstruksionin e kësaj pasurie, duke e përshtatur sipas kohës lokalit, dhe se më pas lokali është shitur në shumën prej 12,800,000 lekë. Nga kjo shumë, vlera prej 500,000 lekë i është dhënë motrës së tij, që jeton në Vlorë...shuma 300,000 lekë është lënë në shtëpi për nevoja familjare, ndërsa shuma prej 12,000,000 lekë është ndarë mes tij dhe nënës. Pra, nëna e tij ka marrë shumën prej 6,000,000 lekë, po aq sa ka marrë dhe ai nga shitja e lokalit, dhe se këtë shumë e ka dakordësuar me nënën, për shkak të investimeve të vazhdueshme që ishin bërë në lokal nga të ardhurat që dispononte, të cilat i kanë rritur vlerën lokalit. Në vijim subjekti ka shpjeguar se, siç tregohet edhe në llogarinë bankare, shuma prej 6,000,000 lekë ka lëvizur nga llogaria e tij në llogari të nënës, dhe se sot ajo disponon shumën prej 4,000,000 lekë.*

27.4. Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga shitja e pasurisë së paluajtshme (lokal shërbimesh), në datën 10.1.2005, në Kuçovë, shumën prej 12,800,000 lekë²⁵.

27.5. Gjithashtu, referuar informacionit shpjegues të depozituar në ILDKPKI me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, subjekti ka sqaruar se vlera reale e shitjes së kësaj pasurie është 13,000,000 lekë (nga të cilat 200,000 lekë – në marrëveshje me blerësin u kthyen mbrapsht për shkak të pagesave që do bëheshin për legalizimin e një shtese të objektit).

27.6. Nga verifikimi i informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Kuçovë²⁶, konfirmohet blerja e kësaj pasurie prej nënës së subjektit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Dega Kuçovë. Gjithashtu, konfirmohet se në datën 10.1.2005, personi i lidhur, znj. L.D, ia ka shitur²⁷ këtë pasuri, njësinë e shërbimit me sipërfaqe 59 m², shtetasit S.B., për çmimin 3,900,000 lekë.

27.7. Sa më sipër, Komisioni konstatoi mospërputhje mes çmimit të shitblerjes së kësaj pasurie të referuar në kontratë dhe vlerës së pretenduar nga subjekti, si të përfituar nga shitja e kësaj pasurie.

27.8. I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë fakt²⁸ – subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se *në kohën e shitjes në janar të vitit 2005, lokali ka qenë në gjendje pune dhe të nesërmen e ndryshimit të pronësisë, lokali funksionoi me të njëjtin destinacion dhe personel. Sipërfaqja e lokalit të shërbimit ka qenë rreth 90-100 m², ka pasur dhe ka banjë dhe parabanjë, dhe ka pasur një magazinë rreth 30-35 m², e cila përpara shitjes përdorej si magazinë – por se blerësi e ka përshtatur në shtëpi banimi. Kur është dakordësuar për shitjen e dyqanit, është dakordësuar për çmimin 100,000 euro, konvertuar sipas kursit të kohës 13,000,000 lekë. Siç ka deklaruar edhe më parë, 200,000 lekë i janë ulur blerësit, për shkak se në atë periudhë filloi të flitej për legalizimin e shtesave. Çmimi real*

²⁴ Pyetëtori nr. 2.

²⁵ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratën “Vetting” (aneksi *** në dosjen e ILDKPKI-së); kopje kontrate shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.1.2005.

²⁶ Shkresa e ZVRPP-së Kuçovë me nr. *** prot., datë 14.9.2017.

²⁷ Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.1.2005.

²⁸ Përgjigjet e pyetëtorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.

i shitjes së dyqanit nga nëna e tij është 12,800,000 lekë. Kur është shkuar dhe është parë lista e tarifave te noteri, me kërkesë të blerësit (djalit të tij që paguante realisht lekët dhe që jetonte dhe jeton në Itali) dhe me orientim të noterit është vendosur në akt shuma 3,900,000 lekë. Nëna e tij ra dakord dhe ky akt u përpilua. Për aktin u pagua nga blerësi tarifa rreth 60,000 lekë, sipas marrëveshjes së mëparshme për pagimin e shpenzimeve, por nëse do të vendosej çmimi real i blerjes – kjo tarifë do ishte më e madhe dhe do paguhej përsëri nga blerësi.

27.9. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale²⁹ të datës 5.12.2018, të shtetasit S.B, blerësi i kësaj pasurie. Me anë të këtij dokumenti noterial, shtetasi S.B. deklaroi se ka blerë këtë pasuri për shumën prej 12,800,000 lekë dhe se marrëveshja përfshinte kalimin e pronësisë jo vetëm të ndërtesës, por edhe të biznesit, në gjendjen siç shfrytëzohej nga shitësi. Krahas pagimit të shumës së mësipërme, ka marrë përsipër edhe pagimin e çdo detyrimi që vinte si pasojë e kalimit të pronësisë, pasi pala shitëse i bëri zbritje 200,000 lekë, për pagimin e çdo detyrimi, si te noteri, ashtu edhe në ZVRPP. Në kontratën e hartuar te noteri, me kërkesën e tij është shënuar si çmim shuma prej 3,900,000 lekësh, por shuma reale që ka paguar është 12,800,000 lekë, të paguara me dy këste, një këst një muaj më parë dhe kësti i dytë, ditën e lidhjes së kontratës.

27.10. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dokumentin “Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës për objektin lokal dhe bilardo”, të depozituar nga shtetasi S.B., në datën 30.10.2006 në Zyrën e Urbanistikës të Njësisë së Qeverisjes Vendore Kuçovë, i cili rezultoi se lidhet me objektin “njësi shërbimi”, të shitur nga personi i lidhur, ku, ndër të tjera, referohen të dhënat si vijon:

1. të dhënat sipas lejes së miratuar: (a) sipërfaqja e shesh ndërtimit 59 m²; dhe (b) sipërfaqja e ndërtimit 59 m²;
2. të dhënat sipas gjendjes faktike: (a) sipërfaqja e shesh ndërtimit 100 m²; dhe (b) sipërfaqja e ndërtimit 92 m².

27.11. Ndërsa, pasi Komisioni verifikoi dhe analizoi informacionin/dokumentacionin bankar të administruar në dosjen e hetimit administrativ³⁰, rezultoi se:

(i) në datën 26.11.2004 subjekti ka depozituar *cash* shumën prej 8,000,000 lekësh në llogari personale me nr. ***, në “Procredit Bank”, shumë e cila investohet në depozitë me afat 1-vjeçar.

(ii) Pas maturimit të kësaj depozite, në datën 30.11.2005, tërhiqet *cash* nga subjekti interesi i përfituar në shumën 480,960 lekë, ndërsa në datën 9.12.2005 tërhiqet *cash* shuma prej 8,000,000 lekësh.

(iii) në datën 9.12.2005, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank” shumën prej 8,000,000 lekësh, duke e kaluar këtë shumë në depozitë me afat.

(iv) në datën 27.3.2006, subjekti ka tërhequr *cash* nga “Raiffeisen Bank” shumën 8,500,000 lekë, e cila përfaqëson fondet nga: (a) shuma e depozituar në datën 9.12.2005 (b) shuma të cilat i ka pasur më parë gjendje në këtë llogari; dhe (c) vlera të përfituara nga interesat bankarë.

(v) po në datën 27.3.2006, subjekti ka depozituar *cash* në llogari e tij në Bankën Popullore (sot “OTP Bank”) shumën 8,500,000 lekë.

(vi) në datën 2.10.2006, subjekti ka transferuar në llogarinë e nënës së tij, znj. L. D, në Bankën Popullore (sot “OTP Bank”) shumën 6,000,000 lekë.

(vii) prej vitit 2006 e në vijim, nga llogaria e personit të lidhur në “OTP Bank” (më parë Banka Popullore dhe “Societe Generale Albania”), fonde të kësaj shumë janë investuar disa herë në depozita me afat dhe se konstatohen disa tërheqje *cash* të kryera ndër vite nga personi i lidhur.

²⁹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.12.2018.

³⁰ Shkresa e “Raiffeisen Bank” me nr. *** prot., datë 12.3.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.4.2020); shkresa e “OTP Bank” me nr. *** prot., datë 24.4.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.4.2020; dhe (iii) shkresa e “Procredit Bank” me nr. *** prot., datë 17.3.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.3.2020).

(viii) në datën 30.9.2016, personi i lidhur ka investuar shumën prej 4,000,000 lekë në depozitë me afat dhe rezulton se në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, vlera totale e fondeve në këtë llogari ka qenë në shumën 4,000,000 lekë.

27.12. Sa më sipër, Komisioni konstaton se personi i lidhur (nëna e subjektit) – në deklaratën “Vetting” ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me gjendjen e llogarisë “depozitë” në “OTP Bank”, pasuri kjo e cila rezulton të jetë krijuar në tetor të vitit 2006, rreth 7 vjet para fillimit të detyrës si gjyqtar nga subjekti.

28. Analiza e të ardhurave të referuara si burim krijimi i pasurive të deklaruara në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” të subjektit dhe personave të lidhur

28.1. Sikurse u konstatua më sipër, rezulton se në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të dispononin këto pasuri: (1) pasuria e llojit “apartament banimi”, përfituar me ligjin e privatizimit; (2) pasuria e llojit “automjet”, me vlerë 950,000 lekë; (3) pasuria e llojit “likuiditet”, në shumën 100,000 euro - dhënë hua nga subjekti; (4) pasuria e llojit “likuiditet”, dy depozita bankare në emër të bashkëshortes së subjektit, me vlerë totale në shumën 95,000 euro; dhe (5) pasuria e llojit “likuiditet”, depozitë bankare në emër të nënës së subjektit, në shumën 4,000,000 lekë.

28.2. Pra, rezulton se pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” është në total në shumën 4,950,000 lekë dhe 195,000 euro (pa përfshirë këtu vlerën e apartamentit në Kuçovë – të përfituar nga privatizimi).

28.3. Nga ana tjetër, pasuria e deklaruar dhe konstatuar nga Komisioni, si e krijuar para fillimit të detyrës, është në vlerë më të lartë se pasuria e deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar – “Vetting”. Si rrjedhim, trupi gjykues vëren se nga deklarimi fillestar deri në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, subjekti ka pasur pakësim pasurie, fakt ky i konstatuar edhe në raportin e mbajtur nga ILDKPKI. Vlen të theksohet se, deri në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” nuk ka pasur ndryshime në pasurinë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, ndërsa në pasurinë e luajtshme ka ndryshuar vetëm vlera e likuiditetit.

28.4. Në këtë kuptim, Komisioni çmoi të verifikojë dhe marrë në analizë të ardhurat e referuara nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi i pasurisë së deklaruar para fillimit të detyrës, e konkretisht të tri depozitave bankare në emër të subjektit dhe bashkëshortes, në vlerë totale rreth 200,000 euro (nga të cilat shuma 100,000 euro dhënë hua nga subjekti në vitin 2014), automjetit me vlerë 950,000 lekë dhe depozitës në emër të nënës në vlerën 4,000,000 lekë.

28.5. Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të ardhurash të realizuara para fillimit të detyrës: (i) të ardhurat nga emigracioni në Greqi, nga viti 1992 – 2000, në total shumën 35,000,000 dhrami, konvertuar në vlerën 14,000,000 lekë; (ii) të ardhurat nga dhënia me qira e lokalit për periudhën 1998 deri 2004, privatizuar nga nëna e tij në vitin 1991 dhe shitur në vitin 2005, në total shumën 5,000,000 lekë; (iii) të ardhurat nga punësimi në shoqërinë “***” sh.p.k., në formën e partneritetit, për periudhën shtator 2000 deri në vitin 2010, në shumën nga 8,000,000 lekë deri 10,000,000 lekë; (iv) të ardhurat nga shitja e lokalit në Kuçovë, shumën 12,800,000 lekë; (v) të ardhurat nga puna si jurist në Komunën Perondi, Kuçovë, për periudhën 23 janar 2007 deri më 31 dhjetor 2008, shumën 690,335 lekë; (vi) të ardhurat nga puna si avokat për periudhën 2008 – 2011, mbi 5,000,000 lekë; (vii) të ardhurat nga paga në Shkollën e Magjistraturës, nga tetori 2011 deri në nëntor 2013, shumën 1,045,330 lekë; (viii) të ardhurat nga mësimdhënia në Universitetin “UFO”, Fier, për periudhën 11.2.2012 deri 12.6.2013, shumën 102,600 lekë.

28.6. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga puna në “Raiffeisen Bank” për periudhën 1.1.2011 deri 11.5.2015, shumën 2,092,076 lekë, ku një pjesë e të ardhurave rezulton se janë përfituar para deklarimit fillestar të pasurisë (deklaratës para fillimit të detyrës). Ndërsa, siç u konstatua më sipër – nëna e subjektit ka deklaruar vetëm të ardhura nga pensioni i pleqërisë (familjar) në total për shumën 1,500,000 lekë.

28.7. Sa më sipër, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit pretendon se para fillimit të detyrës ka gjeneruar të ardhura në total për shumën prej rreth 46.6 deri në 48.6 milionë lekë. Duke i shtuar dhe

të ardhurat e referuara dhe të përlogaritura si të përfituara veçmas nga personat e lidhur, në total të ardhurat e pretenduara dhe të deklaruara deri në momentin para fillimit të detyrës (datë 21.10.2013), janë në shumën prej rreth 51.2 milionë lekë.

28.8. Bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe pas verifikimit dhe analizimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ, Komisioni konstatoi të ardhurat e provuara me dokumentacion justifikues ligjor (të subjektit dhe personave të lidhur), si të përfituara për periudhën para fillimit të detyrës (para datës 21.10.2013), të paraqitura në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1.

Burimi i të ardhurave para fillimit të detyrës	Të ardhurat e provuara me dokumentacion (vlerat në lekë)
Të ardhura nga bursa, Shkolla e Magjistraturës ³¹	1 045 330
Të ardhura nga paga e bashkëshortes ³²	1 546 769
Të ardhura nga aktiviteti, person fizik (avokat) ³³	352 930
Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin “UFO” ³⁴	102 600
Të ardhura nga punësimi Komuna Perondi ³⁵	690 335
Të ardhura nga shitja e njësisë tregtare në Kuçovë ³⁶	3 900 000
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare ³⁷	1 453 192
Të ardhura nga pensioni i nënës ³⁸	1 016 000
Të ardhura nga qiraja e dyqanit në Kuçovë	-
Të ardhura nga puna në emigracion, në Greqi	-
Të ardhura nga punësimi/bashkëpunimi me shoqërinë “***” sh.p.k ³⁹ .	138 994
TOTAL	10 246 150

28.9. Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk provon plotësisht me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e deklaruara si të përfituara para fillimit të detyrës.

³¹ Vërtetimi i Shkollës së Magjistraturës me nr. *** prot., datë 24.1.2017, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³² Vërtetimi i “Raiffeisen Bank” i datës 24.1.2017, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së; Shkresa e ISSH-së me nr. *** prot., datë 6.3.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.3.2020.

³³ Shkresa e DRT-së Berat me nr. *** prot., datë 22.1.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.1.2021.

³⁴ Vërtetimi i “Albania University” me nr. *** prot., datë 23.1.2017, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së. Shkresa e “Albania University” me nr. *** prot., datë 7.1.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.1.2021.

³⁵ Vërtetimi i Komunës Perondi me nr. *** prot., datë 24.1.2017, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁶ Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.1.2005.

³⁷ Sipas verifikimit të kryer mbi depozitat e subjektit dhe personave të lidhur ndër vite, interesave bankarë të përfituara nga to.

³⁸ Shkresa e ISSH-së me nr. ***prot., datë 6.3.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.3.2020 (përlogaritur nga Komisioni në mënyrë alternative vlera e përfituar deri para fillimit të detyrës).

³⁹ Shkresa e DRSSH-së Berat me nr. *** prot., datë 7.1.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.1.2021.

28.10. Por, nga analizimi në tërësi i të gjitha akteve, pjesë të dosjes së hetimit administrativ, si dhe në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vëren se si burime kryesore që kanë shërbyer për krijimin e pasurive⁴⁰ janë referuar të ardhurat e pretenduara/deklaruara nga: (1) emigracioni; (2) bashkëpunimi me shoqërinë “***” sh.p.k.; dhe (3) shitja e lokalit në Kuçovë, pasi për pjesën më të madhe të të ardhurave të tjera të pretenduara/realizuara ndër vite, subjekti deklaroi se kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve, të jetesës dhe të tjera.

28.11. Sa më sipër, në kushtet kur gjatë hetimit administrativ – rezultoi se janë konstatuar burimet kryesore, të cilat pretendohen se kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, trupi gjykues çmoi të thellohet në analizimin e të ardhurave të deklaruara/ të pretenduara si të përfituara nga emigracioni, bashkëpunimi me shoqërinë “***” sh.p.k. dhe nga shitja e lokalit në Kuçovë.

a) Të ardhurat e pretenduara nga emigracioni

29. Trupi gjykues vëren se krahas deklaramit të bërë në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, në vazhdimësi, në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga ILDKPKI në shtator të vitit 2014, në materialin shpjegues të depozituar prej tij me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, si edhe në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar se ka përfituar të ardhura nga puna e tij si emigrant ekonomik në shtetin grek, për periudhën nga viti 1992 deri në vitin 2000, shumën prej rreth 14,000,000 lekë. Subjekti ka vetëdeklaruar se këto të ardhura janë të padokumentuara.

29.1. Konkretisht, i pyetur nga Komisioni në lidhje me të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga puna në emigracion, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se *...fillimisht në shtetin grek nuk ka qënë me leje qëndrimi dhe vizën e parë e ka marrë në vitin 1996 të cilën nuk e disponon⁴¹, dhe se nuk ka pasur as leje pune, por se ka punuar në ishullin Tinos në fushën e turizmit dhe në sipërmarrje ndërtimi me vëllain e nënës - duke punuar i paregjistruar dhe duke arritur të kursejë të ardhura të konsiderueshme duke i sjellë pjesë – pjesë në Shqipëri me anë të personave të afërm apo të njohur. Për arsye shëndetësore, pas sëmundjes së babait, shuma e sjellë në Shqipëri është dashur të dërgohet përsëri në Greqi në vitin 2000 për të filluar kurimet e tij, transporti i parave është dakordësuar me anë të shtetasve A. C dhe P.K, me të cilët familjarët e tij kanë deklaruar dhënien e fondeve me hua pa interes, por duke qënë se babai ka ndërruar jetë në datën 29.5.2000, përpara se fondet të shkonin në Greqi, fondet kanë qëndruar në Shqipëri.*

29.2. Për të provuar deklaramet e tij lidhur me qëndrimin e tij në shtetin grek dhe të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga puna në emigracion, me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, si edhe me përgjigjet e pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka depozituar dokumentacionin si më poshtë vijon:

(i) Kopje të fletës së pasaportës, ku pasqyrohet viza njëvjeçare për kalimin në shtetin grek, në vitin 1999.

(ii) Aktmarrëveshje për dhënie huaje⁴², e datës 18.5.2000, me palë huadhënëse, znj. L.D. (nëna e subjektit) dhe palë huamarrëse shtetasin A.C. Referuar kësaj aktmarrëveshjeje, rezultoi se personi i lidhur i ka dhënë hua pa interes shtetasit A.C, shumën prej 20,000,000 dhrami (konvertuar në shumën rreth 8,000,000 lekë), për një afat kthimi deri në datën 31.12.2000.

(iii) Deklaratë noteriale⁴³ e datës 10.10.2000, me palë deklaruese subjektin e rivlerësimit dhe shtetasin P.K. Referuar kësaj deklarate, shtetasi P.K deklaroi se i ka kthyer subjektit të rivlerësimit shumën prej 18,000,000 dhrami (konvertuar në shumën prej rreth 7,200,000 lekë), deklaruar si të marra hua prej babait të subjektit në muajin prill të vitit 2000. Bashkëlidhur deklaratës është depozituar edhe kopje të ekstraktit historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “***” sh.p.k., themeluar në

⁴⁰ Të deklaruara dhe të evidentuara si të trupëzuara (materializuar në llogari bankare) para fillimit të detyrës.

⁴¹ Ka depozituar kopje pasaporte, ku duket se ka vizë njëvjeçare për kalimin në shtetin grek, të marrë në vitin 1999.

⁴² Konfirmuar me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 18.5.2000, nga noteri publik, znj. N.D.

⁴³ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr *** kol., datë 10.10.2000, redaktuar nga noteri publik, znj. N.D.

datën 15.1.1995, regjistruar në datën 10.12.2001, me aktivitet në fushën e ndërtimit, hotelerisë etj., në të cilën z. P.K zotëron 84% të kuotave të kapitalit.

29.3. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se ka pasur llogari bankare në emër të tij të hapur në shtetin grek dhe në vazhdimësi ka bërë përpjekje për disponimin e informacionit lidhur me këto llogari. Ka rezultuar se, me qëllim që të provojë përpjekjet e tij për identifikimin e këtyre llogarive bankare dhe gjetjen e informacionit lidhur me to, gjatë hetimit administrativ subjekti ka depozituar 2 (dy) prokura të posaçme, me anë të të cilave ka autorizuar avokatët për të marrë të informacion në bankën “Alpha” në Greqi, për të dhëna në lidhje me llogaritë bankare të tij⁴⁴.

b) Të ardhura e pretenduara si të përfituara nga puna e kryer, bashkëpunimi/partneriteti në biznes – në/me shoqërinë “*” sh.p.k.**

30. Trupi gjykues vëren se, krahas deklaramit të bërë në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting, në vazhdimësi – në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga ILDKPKI në shtator të vitit 2014, në materialin shpjegues të depozituar prej tij me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, si edhe në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar se ka përfituar të ardhura nga puna, bashkëpunimi/partneriteti në biznes me shoqërinë “***” sh.p.k., shumën prej 8,000,000 deri 10,000,000 lekë. Subjekti ka vetëdeklaruar se marrëdhënia me këtë shoqëri ka qenë e paformalizuar dhe, si rrjedhojë, këto të ardhura janë të padokumentuara.

30.1. Konkretisht, i pyetur nga Komisioni lidhur me përfitimin e këtyre të ardhurave – subjekti ndër të tjera ka deklaruar se *shoqëria “***” ka pasur dhe ka si ortak të vetëm, njëkohësisht dhe administrator, z. A.C, i cili është mik i tij i hershëm dhe personi që ka marrë përsipër kalimin e një shume të të hollave (dhrami) për në shtetin e Greqisë (shpjeguar si më sipër). Pas kthimit të tij në Shqipëri, ai i ka ofruar të bashkëpunonin në shoqërinë e tij. Shkaku i ofertës ka qenë se kishte shumë punë në këtë periudhë, si edhe i nevojiteshin likuiditete, të cilat i mungonin. Për shkak të punëve që kishte dhe mori në vijim dhe në mungesë të likuiditeteve, i ka ofruar shumën 20 milion dhrami, fiks shumën të cilën e kishte marrë nga nëna e tij për ta dërguar në shtetin e Greqisë. Siç është shprehur edhe në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, bashkëpunimi i tyre ka qenë miqësor dhe i padokumentuar në aktin e themelimit apo në statutin e shoqërisë. Detyrimet e tij në shoqëri fillonin që nga momenti i përpilimit të dokumentave të tenderave ku konkuronin, përfaqësimin e shoqërisë në tendera, ndjekjen e punimeve dhe gjithçka tjetër që nevojitej, deri në përfundimin e plotë të punimeve. Nga momenti i fillimit të bashkëpunimit, tremujori i fundit i vitit 2000 deri në periudhën e verës së vitit 2002 përfshirja e tij në veprimtarinë e shoqërisë ka qenë me kohë të plotë. Kjo tregohet edhe në librezën e tij të punës...Në shtator – tetor 2002 ka filluar shkollën e lartë në Shkodër me shkëputje nga puna dhe për këtë arsye veprimtaria e tij në shoqëri ka qenë e kufizuar. Pas vitit 2006 – kohë kur ka mbaruar studimet e larta, për shkak edhe të disa angazhimeve të tjera publike të tij në qytetin e Kuçovës, bashkëpunimi me shoqërinë ka ardhur duke u reduktuar, deri sa në vitin 2010 është mbyllur përfundimisht. Siç ka deklaruar në vitin 2014 edhe në ILDKPKI si edhe me shpjegimet e dhëna në kohën e dorëzimit të dokumentave për procesin Vetting, shuma që ka përfituar për gjithë këtë periudhë nga bashkëpunimi është rreth 8,000,000 lekë, kjo e thënë me përparësi – pasi nuk ka mbajtur llogari as ai as ortaku i shoqërisë, pasi dhënia e shpërblimit ka ndodhur pas përfundimit të çdo pune publike. Asnjëherë nuk është paguar me pagë fikse, por ka marrë shpërblim në përqindje, të cilën e llogarisnin në përfundimin e punës. Kontributi më i madh është dhënë deri në vitin 2002, kohë që ka deklaruar që në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në shtator të vitit 2014, se është paguar nga shoqëria në vitin 2001 ose 2002 në shumën 4-6 milion lekë dhe pagesa është kryer në çek. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se në këto shpjegime është shprehur se: “Marrëdhënia me ortakun e shoqërisë ka qenë miqësore dhe shumica e transaksioneve ka qenë kesh dhe dorazi. E vetmja pagesë që është kryer me bankë është kryer në vitin 2001 ose fillim viti 2002, ku ka tërhequr nga llogaria e shoqërisë afërsisht shumën prej 4-6 milion lek, tërheqje të cilën e ka kryer me çek. Në të njëjtën periudhë ka hapur edhe një depozitë bankare në bankën e kursimeve në emrin e tij”.*

⁴⁴ Prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. ***kol., datë 1.10.2018, redaktuar nga noteri publik, z. E.A; prokura e datës 25.6.2020 në gjuhën greke, e përkthyer në gjuhën shqipe, konfirmuar me dokumentin vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 18.1.2021, redaktuar nga noteri publik, z. G.B.

30.2. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se *ka arritur të gjejë llogarinë e tij në Bankën e Kursimeve, ku tregohet se në fillim të vitit 2002 ka çelur llogari në këtë bankë (datë 11.3.2002) fillimisht në shumën prej 1,400,000 lekë dhe në datën 14.3.2002 llogaria ka qenë në shumën 4,000,000 lekë. Për këtë vlerë deklaron se janë paratë e fituara nga bashkëpunimi me shoqërinë “****” në këtë periudhë.*

30.3. Lidhur me kontributin e tij të investuar deklaron se *siç ka sqaruar në shpjegimet e dhëna në datën 25.1.2017 për efekt të këtij procesi, e ka marrë në fund viti 2005, fillim viti 2006. Këto para ia ka huazuar mikut të tij I.E (me të cilin ka edhe shumë transaksioneve të mëvonshme), i cili në datë 24.6.2005 ka themeluar në Shqipëri shoqërinë “****”, ku kishte 49% të kuotave dhe kishte nevojë për likuiditete. Shoqëria përfshinte “****” dhe “****” dhe ndodhej te C.I. Që prej asaj periudhe, një pjesë e konsiderueshme e parave të tij, në lekë apo valutë, janë përdorur në funksion të kësaj shoqërie. Për këtë arsye, në datën 19.4.2008 kanë kontraktuar shitjen e 20% të kuotave në pronësi të I.E, ku ai vetë është në cilësinë e blerësit, por pa e përfunduar këtë kontratë, për shkak të mosdhënies së miratimit nga ortaku kryesor F.Z.*

30.4. Në përfundim, në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka sqaruar se *marrëveshjen e bashkëpunimit me shoqërinë “****” sh.p.k., nuk e kanë dokumentuar me kalim kuotash etj. Ka kontribuar në shoqëri që nga paraqitja e shoqërisë në tendera dhe deri në mbikëqyrjen e punimeve, dhe se shpërblehej me përqindje në varësi të punëve që kryenin. Në atë kohë kjo shoqëri ka kryer shumë punë si psh: shtrirjen e fibrave optike nga A, sistemim kanalesh vaditëse nga PMU, Ministria e Bujqësisë, ndriçime rrugësh, rikonstruksion ndërtesash etj.*

30.5. Ndërsa, në shpjegimet shtesë të dhëna për marrëdhënien me shoqërinë “****” sh.p.k., subjekti ka evidentuar ekzistencën e një kontrate huapërdorje automjeti, të vitit 2000, lidhur midis tij dhe z. A.C. Gjithashtu, subjekti ka vënë në dijeni se i është drejtuar me shkresa disa institucioneve publike dhe private për vendosjen në dispozicion të dokumenteve të tenderave që ka fituar shoqëria “****” sh.p.k., por vetëm një pjesë e tyre kanë khyer përgjigje, të cilat i janë vënë në dispozicion të Komisionit.

30.6. Për të provuar deklaratimet e tij për marrëdhënien dhe të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga puna/bashkëpunimi në biznes me shoqërinë “****” sh.p.k., me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, si edhe me përgjigjet e pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka depozituar dokumentacionin si më poshtë vijon:

(i) Aktmarrëveshje për dhënie huaje⁴⁵, e datës 18.5.2000, me palë huadhënëse – znj. L.D (nëna e subjektit), dhe palë huamarrëse shtetasin A. C.

Referuar kësaj aktmarrëveshjeje, personi i lidhur i ka dhënë hua pa interes shtetasit A.C, shumën prej 20,000,000 dhrami (konvertuar në shumën prej rreth 8,000,000 lekë), për një afat kthimi deri në datën 31.12.2000. Siç u evidentua edhe më sipër, subjekti ka deklaruar se kjo shumë nuk i është kthyer sipas aktmarrëveshjes, por i është lënë në dispozicion shtetasit A.C për nevoja të aktivitetit të shoqërisë.

(iii) Kopje të librezës së punës⁴⁶, në referim të së cilës subjekti figuron i regjistruar si punëtor i shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën nga data 1.1.2001 - 31.5.2002.

ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Berat⁴⁷, ka dërguar informacionin mbi të dhënat e punësimit dhe pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të subjektit të rivlerësimit. Nga verifikimi i informacionit të dërguar dhe analizimit të tij në harmoni me librezën e punës, rezulton se për periudhën janar 2001 – maj 2002, subjekti i rivlerësimit ka qenë i regjistruar si i punësuar në shoqërinë “****” sh.p.k., periudhë në të cilën janë paguar edhe kontributet përkatëse.

⁴⁵ Konfirmuar me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 18.5.2000, nga noteri publik, znj. N.D.

⁴⁶ Dokument, për të cilin është vërtetuar njësia me origjinalin, nëprmet vërtetimit notarial nr. *** rep., datë 19.1.2021, redaktuar nga noteri publik E.A.

⁴⁷ Shkresat nr. *** prot., dhe nr. *** prot., datë 7.1.2021.

(iii) Vërtetim⁴⁸ (shkresë e thjeshtë – pa datë), lëshuar nga përfaqësuesi i shoqërisë “****” sh.p.k., z. A. C

Me anë të këtij vërtetimi konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka punuar pranë kësaj shoqërie prej datës 1.1.2001 deri në 31.5.2002, periudhë gjatë së cilës i janë paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Që prej fillimit të punës dhe më pas, z. Arben Dosti ka kontribuar financiarisht shumën 8,000,000 lekë, nëpërmjet kontratave verbale të huas, shumë e cila është shlyer periodikisht nga shoqëria deri në vitin 2010. Për këtë kontribut është shpërblyer periodikisht afërsisht në shumën 8,000,000 lekë, duke filluar që nga viti 2000 deri në vitin 2010, në varësi të punëve dhe fitimit që ka pasur shoqëria për punët që ka kryer gjatë kësaj periudhe. Marrëdhënia e bashkëpunimit me z. Arben Dosti, përveç vitit të parë të bashkëpunimit, nuk ka qenë e formalizuar, pasi ka qenë një marrëdhënie miqësore bashkëpunimi, si e tillë filloi e përfundoi në vitin 2010.

(iv) Shkresë e thjeshtë⁴⁹ e shtetasit A.C (pa datë)

Referuar kësaj shkrese, zoti C, në cilësinë e ortakut të vetëm dhe administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit për periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2010 ka kontribuar në funksionimin e shoqërisë, e konkretisht:

-Në vitin 2001 ka kontribuar duke financuar një shumë afërsisht 8,000,000 lekë, shumë e cila i është kthyer në vitin 2006.

-Falë punës së tij, si investues, përfaqësues i shoqërisë në tenderime, si edhe konsulencës juridike, është shpërblyer afërsisht 8,000,000 deri 10,000,000 lekë (të rinj), shlyer periodikisht, pas përfundimit të punëve që kryente shoqëria.

- Kthimi dhe pagesa e shumave të mësipërme është kryer në cash, përveç një pagese të kryer në fund të vitit 2001, fillim të vitit 2002, kur është paguar me çek.

- Falë miqësisë pas vitit 2002 marrëveshja ka qenë e paformalizuar, duke funksionuar normalisht deri në përfundim të saj në vitin 2010.

(v) Shkresa e datës 22.1.2021, e noterit publik, znj. A.B

Referuar kësaj shkrese, bazuar në kërkesën e bërë nga subjekti i rivlerësimit, noteri publik, znj. A.B, konfirmon se në regjistrin e përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale, në faqen me nr. ***, është regjistruar akti noterial me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.7.2000, “Kontratë huapërdorje automjeti me palë, huadhënës: A.C, huamarrës: Arben Dosti”. Në vijim, znj. B, informon se bazuar në udhëzimin “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumentave noteriale si dhe për ruajtjen arkivave noteriale”, afati i ruajtjes në arkivë i kontratës së huapërdorjes së autojetit është 5 (pesë) vjet pas mbarimit të afatit të përcaktuar në kontratë dhe, në këto kushte, meqënëse afati i ruajtjes ka mbaruar, nuk mund të lëshojë kopje të aktit noterial. Bashkëlidhur, ka vënë në dispozicion kopje të vërtetuar të faqes së regjistrit ku është shënuar akti noterial i sipërcituar.

30.7. Gjithashtu, Komisioni konstaton se pas kërkesës së bërë nga ILDKPKI shoqërisë “****” sh.p.k., për të deklaruar dhe dokumentuar kontributin financiar të subjektit të rivlerësimit, në marrje, kthim, si edhe përfitimet financiare nga paga, shpërblime etj., bruto dhe neto, që ka pasur për të gjithë periudhën e bashkëpunimit, me shkresën “kthim përgjigje”⁵⁰ përfaqësuesi ligjor dhe ortaku i vetëm i shoqërisë, z. A.C, ka informuar sa më poshtë vijon:

-Siç është shprehur dhe në vërtetimin e lëshuar me kërkesën e z. Arben Dosti, bën me dije se në muajt qershor – korrik të vitit 2000, ka filluar një bashkëpunim me z. Arben Dosti, me të cilin prej vitesh

⁴⁸ Dokument i depozituar nga subjekti bashkëlidhur shpjegimeve të dhëna prej tij në datën 19.9.2014 në ILDKPKI, në përgjigje të pyetjeve të dërguara me shkresën nr. *** prot., datë 8.9.2014.

⁴⁹ Depozituar nga subjekti si dokumentacion bashkëlidhur deklaratës “Vetting”, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së. Depozituar sërish pjesë e dokumentacionit bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni.

⁵⁰ Shkresë e protokolluar në ILDKPKI me nr.*** prot., datë 6.7.2017.

kishte miqësi personalisht dhe familjarisht. Qëllimi i bashkëpunimit ka qenë një shtim i punëve publike të përfituara në institucione të ndryshme shtetërore, që shoqëria kishte në atë periudhë. Kontributi i z. Dosti ishte fizik dhe financiar. Konkretisht kryente detyrën e përfaqësimit të shoqërisë te të tretët, si dhe ndjekjen e kryerjes së punimeve, detyrë të cilën e ka kryer deri në vitin 2002, vit kur filloi shkollën e lartë. Më pas ka vazhduar të jetë i angazhuar në shoqëri, por me kufizime në kohë, për shkak të angazhimeve shkollore, duke u kufizuar vetëm në marrëdhënie me të tretët. Deri në vitin 2002 i janë paguar sigurimet shoqërore nga shoqëria, më pas bashkëpunimi ka vazhduar i padokumentuar.

-Për të gjithë këtë periudhë nuk është paguar me pagë, por ka përfutur pjesë të konsiderueshme nga fitimi i shoqërisë. Është i dokumentuar si përfaqësues i shoqërisë në procedurat e zhvilluara në fitimin e tenderave publikë, të shumtë të asaj periudhe. Konkretisht, në tenderat e zhvilluara në Albtelekom sh.a., për vendosjen e fibrave optike nga qyteti i Beratit për në Kuçovë, rikostruksionin e godinës së A në Kuçovë, disa tendera të fituara nga PMU në varësi të Ministrisë së Bujqësisë për rikonstruksionin e kanaleve vaditëse në Qarkun e Beratit, ndriçime të rrugëve në Bashkinë e Kuçovës dhe të Lushnjës dhe shumë tendera të tjerë të zhvilluara në atë periudhë.

-Pagesën e parë ia ka kryer rreth vitit 2001 – 2002, afro 4-6 milionë lekë (të rinj), të cilën ia ka paguar me çek, në Bankën e Kursimeve. Pagesat e tjera më pas janë kryer ‘Kesh’ gjithmonë pas përfundimit të plotë të punëve publike të kryera. Sasia caktohej me marrëveshje në varësi të fitimit dhe kontributit të tij, që nga fitimi i tenderit deri në përfundimin e punimeve.

-Bashkëpunimi ka zgjatur pothuajse deri në vitin 2010, por nga viti 2006 deri në vitin 2010 ka qenë më i pakët për shkak të disa angazhimeve publike të tij në qytetin e Kuçovës.

*-Në total shuma që ka përfutur z. Dosti nga bashkëpunimi me shoqërinë “***”, është në masën 8,000,000 – 10,000,000 lekë (të rinj). Rithekson se marrëveshja ka qenë miqësore dhe e tillë dhe ka përfunduar, pagesat janë kryer kesh prej tij, përveç një pagese kryer në Bankën e Kursimeve, si më sipër treguar. Pagesa të tjera nuk i kujtohen të jenë bërë nëpërmjet bankës, kjo për shkak të kohës së gjatë të kaluar.*

-Në lidhje me kontributin financiar, sqaron se z. Dosti ka kontribuar financiarisht në shoqëri, që në momentin e fillimit të bashkëpunimit. Ka kontribuar shuma të konsiderueshme, sidomos në vitin e parë të bashkëpunimit, për shkak të aktivitetit të shtuar të shoqërisë, nevojës së saj, si për likuiditete, ashtu edhe për bazë materiale dhe mjete pune. Kontributi ka qenë afro 8,000,000 lekë i likuiduar në dy këste, shlyer plotësisht deri në vitin 2006.

*- Shumica e fakteve që deklarohen nuk janë të dokumentuara, por mund të provohen lehtësisht nga ish-personeli i shoqërisë, dokumentacioni që ndodhet në institucionet që kanë prokuruar punë publike (A, Ministria e Bujqësisë, F.Sh.Zh., Bashkia Kuçovë, Bashkia Berat etj.) si edhe një pjesë e konsiderueshme e komunitetit të Kuçovës, të cilët kanë parë këtë bashkëpunim, në disa investime të rëndësishme të kryer në qytetin e Kuçovës. Shoqëria “***” për shkak të kalimit të një kohe të gjatë, nuk disponon dokumentacion vërtetues.*

c) Të ardhura të pretenduara - përfutur nga shitja e dyqanit në Kuçovë

31. Siç u konstatua më sipër, në trajtimin e pasurisë së llojit “likuiditet” në emër të personit të lidhur – depozitës në vlerën 4,000,000 lekë, rezulton se në datën 10.1.2005 nëna e subjektit ka shitur pasurinë e llojit “njësi shërbimi”, për shumën 3,900,000 lekë (pasuri e përfutur më parë nga privatizimi).

31.1. Ndërkohë, referuar shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI, deklarimeve të bëra në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, si edhe përgjigjeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, të kryer nga Komisioni, subjekti pretendon se kjo pasuri është shitur për 12,800,000 lekë dhe se ai ka përfutur shumën prej 6,000,000 lekësh. Lidhur me këtë pretendim, ai ka shpjeguar se lokali ishte i investuar prej tij pas ardhjes nga emigracioni dhe, për më tepër, kishte bërë dhe shtesë ndërtimi. Subjekti ka sqaruar se vlera reale e shitblerjes së kësaj pasurie është ajo e vetëdeklaruar, por për shkak se blerësi dhe noteri sugjeruan vendosjen e një vlere më të ulët, nëna e tij vendosi të pranojë këtë kërkesë, duke firmosur kontratën me vlerën 3,900,000 lekë.

31.2. Në mbështetje të deklarimeve të tij, ndër të tjera, ka depozituar: (i) deklaratë noteriale të datës 5.12.2018, të shtetasit S.B, blerësi i kësaj pasurie; (ii) vetëdeklarim për legalizim e shtesës i shtetasit S.B, i datës 30.10.2006; (iii) vërtetim i datës 21.10.2016 nga “Raiffeisen Bank”, sipas të cilit konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka derdhur në datën 9.12.2005 pranë kësaj banke shumën 8,000,000 lekë.

31.3. Nga shqyrtimi në harmoni i deklarimeve dhe dokumentacionit të depozituar, vërehet se subjekti pretendon se shuma e depozituar në “Raiffeisen Bank” në dhjetor të vitit 2005 ka si burim të ardhurat nga shitja e lokalit në Kuçovë, pasi, në vijim, pikërisht nga kjo llogari ka kaluar në llogari të nënës së tij shumën 6,000,000 lekë.

31.4. Por nga ana tjetër, Komisioni konstaton se kjo shumë është krijuar si rezultat i tërheqjes së shumës së depozituar nga subjekti në datën 26.11.2004 (rreth 1 muaj para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së lokalit) në “Procredit Bank”, në vlerën 8,000,000 lekë. Gjithsesi, vlen të përmendet fakti se në deklaratën noteriale, blerësi, z. S.B, ka deklaruar se shuma reale që ka paguar për blerjen e lokalit është 12,800,000 lekë, e paguar me dy këste, një këst një muaj më parë dhe kësti i dytë, ditën e lidhjes së kontratës.

31.5. Sa më sipër, Komisioni konstatoi mospërputhje mes çmimit të shitblerjes së kësaj pasurie të referuar në kontratë dhe vlerës së pretenduar nga subjekti, si të përfituar nga shitja e kësaj pasurie. Subjekti nuk provon me dokumentacion justikues ligjor përfitimin prej tij dhe familjarëve të vlerës së pretenduar nga shitja e kësaj pasurie, përtej çmimit 3,900,000 lekë, të përcaktuar në kontratën e shitblerjes.

31.6. Gjithashtu, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar marrëdhënien mbi të cilën ka përfituar pothuajse gjysmën e vlerës së shitjes së kësaj pasurie, sipas vetëdeklarimit të bërë, të bazuar në vlerën e pretenduar të shitjes.

31.7. Në vijim, trupi gjykues vëren se, krahas dokumenteve të pasqyruara si më sipër, subjekti ka depozituar dokumentacion shtesë, në dukje me qëllim provueshmërinë e disponimit prej tij të vlerave monetare ndër vite, që kanë si burim të ardhurat nga emigracioni, bashkëpunimi në biznes me shoqërinë “****” sh.p.k., dhe shitjen e njësisë në Kuçovë, e konkretisht:

(i) Vërtetim nga “Raiffeisen Bank”⁵¹, Dega Gjirokastër (ish-Banka e Kursimeve), i datës 8.6.2018

Nëpërmjet këtij vërtetimi konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë klient i Bankës së Kursimeve – Dega Kuçovë, me një depozitë kursimi me afat 6-mujor, çelur më 11.3.2002, në shumën 1,400,000 lekë. Me këtë depozitë kursimi janë kryer disa veprime derdhje e tërheqje dhe se gjendja e llogarisë në datën 14.3.2002 ka qenë 4,000,000 lekë. Depozita është mbyllur nga vetë klienti më 29.4.2003. Gjendja e llogarisë në momentin e mbylljes ka qenë 2,079,706 lekë.

Gjithashtu, rezulton se subjekti ka bërë përpjekje për të disponuar informacion për tërheqjen e pretenduar prej tij – si të bërë me çek në ish-Bankën e Kursimeve, në periudhën 2001 – 2002, duke depozituar si provë shkresën “kthim përgjigje”⁵² të “Raiffeisen Bank”, të datës 1.11.2016. Me anë të kësaj shkrese informohet subjekti se në lidhje me pagesën/at e kryera me çek nuk disponojnë dokumente të asaj periudhe, pasi ka kaluar afati i ruajtjes së tyre, që është 10 vjet.

(ii) Kontratë shitje kuotash me kusht⁵³ e datës 19.4.2008, me palë shitëse shtetasin I.E dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit

Referuar kësaj kontrate, pala shitëse – z.I.E, në cilësinë e ortakut që zotëron 49% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “****” sh.p.k., i shtet palës blerëse, subjektit të rivlerësimit, 20% të kuotave të kapitalit të kësaj shoqërie në shumën 250,000 euro, vlerë e cila do të likuidohet në këtë mënyrë: (i) kësti i parë në shumën 200,000 euro, likuiduar nga pala blerëse në favor të palës shitëse jashtë zyrës

⁵¹ Vërtetimi nr. *** prot., datë 8.6.2018.

⁵² Shkresa e “Raiffeisen Bank”, me nr. *** prot., datë 1.11.2016.

⁵³ Kontratë shitjeje me kusht (kuotash) nr. *** rep., nr. *** rep., datë 19.4.2008, redaktuar nga noteri publik, znj. M.D.

noteriale; (ii) kësti i dytë në shumën 50,000 euro do të likuidohet brenda një viti, afati i të cilit fillonte nga dita e nënshkrimit të kontratës së shitjes.

Gjithashtu, në këtë kontratë përcaktohet se palët bien dakord që pala blerëse ka të drejtë të regjistrojë kontratën në momentin që ortaku tjetër i shoqërisë jep miratimin me shkrim për kalimin e 20% të kuotave nga pala shitëse tek pala blerëse, me afat miratimi brenda 6 muajve, i cili fillon që nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka sqaruar se ortaku tjetër i shoqërisë nuk e dha miratimin e tij për shitjen e kuotave dhe, si rrjedhojë, palët u kthyen në gjendjen e mëparshme. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar kopje të ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e shoqërisë “****” sh.p.k.

(iii) Kontratë huaje⁵⁴ e datës 20.12.2012, lidhur midis subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e huadhënësit dhe shtetasit A.D, në cilësinë e huamarrësit.

Referuar kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit i ka dhënë hua pa interes shtetasit A.D, shumën 122,000 euro. Rezulton se pala huamarrëse ka vendosur si garanci për shlyerjen e shumës së marrë hua, pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 127.6 m², të ndodhur në Tiranë⁵⁵.

Gjithashtu, rezulton se nëpërmjet dokumentit noterial⁵⁶ të datës 18.11.2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale nga z. A.D, në lidhje me shumën prej 122,000 eurosh, objekt i kontratës së sipërcituar.

I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë marrëdhënie huaje, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *shtetasin A.D e ka njohur kur ka punuar avokat, pasi dhe ai ushtronte profesionin e avokatit. Shuma është dhënë hua për shkak të një bashkinvestimi që do të kryente së bashku me mikun e tij, I.E, pasi të dy janë miq të përbashkët. Investimi nuk u krye dhe paratë u kthyen. Paratë i ka marrë kesh, ashtu edhe siç i ka dhënë. Paratë i ka marrë përpara përpilimit të deklaratës noteriale për shlyerjen e detyrimit. Këto para (euro) janë depozituar në bankë dhe janë deklaruar në ILDKPKI.*

(iv) Subjekti ka depozituar dokumentacion mbi korrespondencën e mbajtur prej tij me disa ente publike dhe private, nëpërmjet të cilave kërkon të provojë pjesëmarrjen në tendera dhe shpalljen fitues ndër vite të shoqërisë “****” sh.p.k.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti, rezulton se shoqëria “****” sh.p.k., të jetë shpallur fituese: (i) në datën 30.4.2001, nga Bashkia Kuçovë, për tenderin “Ndriçimi rrugor i qytetit”, me vlerë 3,982,778 lekë; (ii) në datën 29.10.2001, nga Bashkia Kuçovë, për tenderin “Ndriçimi rrugor i qytetit”, me vlerë 3,869,508 lekë; (iii) në vitin 2001 nga A., për tenderin “Punime civile për ndërtimin e rrjetit me fibra optike”, për vlerën 31,444,491 lekë.

31.8. Pas verifikimit të kryer nga Komisioni në faqen zyrtare të QKB-së, rezulton se shoqëria “****” sh.p.k., është themeluar në datën 20.9.1995, regjistruar në datën 20.10.1995, me aktivitet në fushën e ndërtimit etj., dhe se z. A.C. është ortak i vetëm dhe përfaqësues ligjor i saj.

31.9. Në vijim të hetimeve lidhur me aktivitetin e kësaj shoqërie, pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁵⁷, DRT-ja Berat ka dërguar informacion⁵⁸ mbi të ardhurat e realizuara dhe fitimet e deklaruara ndër vite nga shoqëria “****” sh.p.k.

31.10. Referuar informacionit të dërguar nga DRT Berat konstatohet se për vitet 2000 – 2010 (vite të cilat pretendon subjekti se ka bashkëpunuar me këtë shoqëri) qarkullimi i realizuar nga kjo shoqëri ka qenë në total në shumën 154,122,411 lekë, e konkretisht: (i) për vitin 2000, vlera prej 12,830,815 lekësh; (ii) për vitin 2001, vlera prej 50,035,424 lekësh; (iii) për vitin 2002, vlera prej 20,412,786 lekësh; (iv) për vitin 2003, vlera prej 963,034 lekësh; (v) për vitin 2004, vlera prej 4,584,354 lekësh;

⁵⁴ Kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.12.2012, redaktuar nga noteri publik, znj. Dh.Q.

⁵⁵ Kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.12.2012.

⁵⁶ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.11.2013, redaktuar nga noteri publik, znj. A.E.

⁵⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 19.1.2021.

⁵⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 25.1.2021.

(vi) për vitin 2005, vlera prej 30,497,554 lekësh; (vii) për vitin 2006, vlera prej 8,210,404 lekësh; (viii) për vitin 2007, s'ka të dhëna; (ix) për vitin 2008, zero lekë; (x) për vitin 2009, vlera prej 19,672,947 lekësh; dhe (xi) për vitin 2010, vlera prej 6,951,093 lekësh.

31.11. Por nga ana tjetër, rezulton se fitimi total bruto i deklaruar si i realizuar nga kjo shoqëri për periudhën 2000 – 2010 është në vlerën 14,972,569 lekë, ndërsa fitimi neto pas pagesës së tatimit në vlerën prej 12,442,920 lekë, por për vitin 2007 nuk ka të dhëna, ndërsa vitet 2003 dhe 2010 paraqiten me humbje.

Konstatimi në mënyrë të përmbledhur i të dhënave mbi disponimin e likuiditeteve ndër vite nga subjekti dhe personat e lidhur - në periudha të caktuara, para fillimit të detyrës

32. Bazuar në verifikimin dhe analizimin e dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ, Komisioni përpunoi informacionin mbi disponimin e likuiditeteve nga subjekti i rivlerësimit dhe/apo personat e lidhur, në periudha të caktuara para fillimit të detyrës, të pasqyruar në mënyrë të përmbledhur dhe kronologjike si më poshtë vijon:

1. Shuma rreth 8,000,000 lekë, dhënë hua nga nëna e subjektit në datën 18.5.2000;
2. Shuma rreth 7,200,000 lekë, hua e kthyer subjektit në datën 10.10.2000, pasqyruar në deklaratën e kthimit të kësaj vlere monetare – si hua e dhënë më parë nga babai i tij në prill të vitit 2000.
3. Shuma prej 4,000,000 lekësh, gjendje në datën 14.3.2002 në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit në Bankën e Kursimeve (sot “RFZ Bank”).
4. Shuma prej 10,021,000 lekësh, pasqyruar në datën 31.12.2004, si gjendje në total në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit, nga të cilat shuma prej 8,000,000 lekësh në “Procredit Bank” dhe shuma prej 2,021,000 lekësh në “Raiffeisen Bank”.
5. Shuma prej 3,900,000 lekësh përfituar në datën 7.1.2005 nga shitja e njësisë së shërbimit të regjistruar në emër të nënës, pretenduar se është shitur në vlerën prej 12,800,000 lekësh.
6. Shuma prej 9,093,000 lekësh, pasqyruar në datën 31.12.2005 si gjendje në llogarinë bankare të subjektit në “Raiffeisen Bank”.
7. Shuma prej 6,000,000 lekësh, pasqyruar në datën 2.10.2006 si gjendje në llogarinë depozitë të nënës së subjektit në “OTP Bank”;
8. Gjendja e llogarisë depozitë në emër të nënës në datën 2.10.2006 në “OTP Bank”, në shumën prej 6,000,000 lekësh;
9. Në datën 19.4.2008, në referim të dokumentit noterial subjekti ka paguar shumën prej 200,000 eurosh – për blerjeje kuotash në shoqërinë “****” sh.p.k.;
10. Shuma prej 122,000 eurosh dhënë hua nga subjekti në datën 20.12.2012, shtetasit A.D.;
11. Në datën 14.5.2013, depozituar *cash* nga personi i lidhur – në llogarinë e subjektit në “Raiffeisen Bank”, shuma prej 100,000 eurosh. Rezulton se kjo shumë është tërhequr nga kjo bankë dhe më pas është depozituar në datën 15.8.2013 në “Credins Bank”;
12. Në datën 4.10.2013, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka depozituar *cash* në llogarinë e saj në “Credins Bank”, vlerën prej 50,000 eurosh;
13. Në datën 11.10.2013, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka depozituar *cash* në llogarinë dyemërore në “OTP Bank”, vlerën prej 49,800 eurosh.

32.1. Por, gjithsesi sikurse u konstatua edhe më sipër, nga analiza e të ardhurave të kryer nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk provojnë plotësisht me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e deklaruara si të realizuara para fillimit të detyrës me burim nga: (i) puna në emigracion; (ii) puna/bashkëpunimi me shoqërinë “****” sh.p.k.; (iii) qiradhënia e njësisë së shërbimit (lokalit); (iv) shitja e njësisë së shërbimit; (v) aktiviteti tregtar si person fizik, avokat; të ardhura këto të cilat janë referuar si burim krijimi i pasurive të deklaruara në deklaratën “Vetting” dhe se kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të tjera të kryera ndër vite.

32.2. Sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës, duke i kërkuar të paraqesi argumentet/shpjegimet e tij përfundimtare, si edhe të depozitojë prova të reja të mundshme për të dokumentuar ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara, ku bëjnë pjesë edhe të ardhurat e referuara prej tij si burim krijimi i pasurive të deklaruara në deklaratën “Vetting”, të konstatuara si pasuri të krijuara/trupëzuara para fillimit të detyrës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

33. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e lokalit, Komisioni vëren subjekti u ka qëndruar deklarimeve të dhëna më parë se lokali është shitur në shumën prej 12,800,000 lekësh, nga të cilat, shuma prej 8,000,000 lekë është marrë rreth një muaj para nënshkrimit të kontratës së shitjes dhe është depozituar në bankë. Nga kjo shumë i ka kaluar nënës shumën prej 6,000,000 lekë me transfertë bankare.

33.1. Ndërsa lidhur me deklarinimin e bërë se ka përfutuar shumën prej 6 milionë lekë nga shitja e lokalit, ka argumentuar se kjo ka ndodhur për shkak se ka qenë ai që ka paguar vlerën e privatizimit të kësaj pasurie dhe se me të ardhurat e tij është realizuar çdo investim i kryer në atë objekt deri në momentin e shitjes.

33.2. Subjekti ka depozituar si provë të re deklaratën noteriale⁵⁹ të datës 19.11.2021, në referim të së cilës, znj. L.D. (nëna e subjektit) konfirmon se vlera e privatizimit dhe çdo shpenzim tjetër për rikonstrukcionin e njësisë së shërbimit janë paguar nga djali i saj. Në vijim ka deklaruar se në datën 10.1.2005 lokali i është shitur z. S.B, në shumën prej 12,800,000 lekësh dhe se pagesa është kryer me dy këste me një diferencë afro njëmuajore. Nga këto të ardhura, shumën prej 500,000 lekësh ia ka dhënë vajzës së saj, që jeton në Vlorë; shuma prej 300,000 lekë është lënë në shtëpi për nevoja personale familjare, ndërsa pjesën tjetër e ka ndarë në mënyrë të barabartë me djalin e saj, Arben Dosti, duke marrë secili shumën prej 6,000,000 lekësh. Kjo ndarje është bërë pasi çmimi i shitjes reflekton në shumicë, pjesën e investimit të kryer dhe llojin e shërbimit që kryhej në atë lokal. Në përfundim, ajo ka deklaruar se depozita në emrin e saj në bankë është nga pjesa e përfutuar nga shitja e lokalit.

33.3. Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore, subjekti u ka qëndruar shpjegimeve të mësipërme të dhëna prej tij dhe deklaratës noteriale të bëra nga nëna e tij. Subjekti ka deklaruar se ka qenë i pranishëm në përpilimin e aktit të shitblerjes së pasurisë dhe ka ritheksuar se ka qenë orintimi i noterit që të shënohej çmimi në kontratë në vlerën prej 3.9 milionë lekë, pasi i bëri me dije se mbi këtë vlerë rriteshin në mënyrë eksponenciale tarifat dhe detyrimet që duhet të paguheshin, dhe si rrjedhim palët kështu u dakordësuan. Ai ka argumentuar se nuk mund ta parashikonte se pas 10 vitesh do të emërohej gjyqtar dhe do t'i duhet të jepte shpjegime për diçka që nuk ishte personalisht e tij, duke referuar se gjithsesi në atë periudhë ai nuk kishte njohuritë e duhura ligjore, pasi nuk kishte kryer ende arsimin e lartë.

33.4. Në lidhje me veprimtarinë e tij në shtetin grek, subjekti u ka qëndruar deklarimeve të mëparshme, duke sqaruar se qëndrimin në këtë shtet e ka ndarë midis ishullit të Tinos dhe Athinës. Ka punuar së bashku me z. Sh.K. (vëllai i nënës) dhe M.Gj. (bashkëshorti i motrës së babait) dhe se aktiviteti i tyre ka qenë i lidhur me një arkitekt grek⁶⁰, i cili mernte punë ndërtimi dhe se ata kishin një brigatë punëtorësh shqiptarë, me të cilët kryenin punimet. Punën ndërtimore, e cila ka zgjatur për të deri në vitin 2000, deklaroi se e kanë zhvilluar më shumë në ishullin e Tinos, në qytetin e Athinës dhe një herë të vetme në ishullin e Rodosit. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se është përpjekur të gjejë se ku ndodhet arkitekti grek me të cilin ata bashkëpunonin, por se nuk ka mundur, si për shkak të mungesës së adresës, por edhe mospasjes dijeni të qenies gjallë të tij. Por, ka mundur të gjejë një prej personave që ka bashkëpunuar në Athinë, z. L.M, të cilin, pas shumë përpjekjesh, e ka gjetur në qytetin e Patrës, ku jeton së bashku me familjen e tij dhe se djali i tij, i cili ka qenë prezent gjatë punimeve i ka dhënë një deklaratë në formë ligjore, lidhur me faktet që kujtonte nga veprimtaria e

⁵⁹ Deklarata noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2021, redaktuar nga noteri publik, z. V.M.

⁶⁰ Për të cilin gjatë seancës dëgjimore deklaroi se e ka njohur gjatë kohës që punonte në një lokal në ishullin Tinos.

tyre e përbashkët⁶¹. Në lidhje me punët e kryera me z. L.M, ai ka shpjeguar se ato janë realizuar në qytetin e Athinës, dhe meqënëse ai ishte person i pajisur me dokumente, për shkak të kombësisë greke që kishte, nëpërmjet tij u rregullua procedura ligjore për deklaratimet në organet tatimore. Kryesisht, të gjitha punët në Athinë deklarohen se i ka kryer në bashkëpunim me këtë person, i cili kujdeset jo vetëm për dokumentacionin, por edhe për gjetjen e punëtorëve të kualifikuar, pasi në Athinë ishte shumë herë më e vështirë se në ishull të punoje pa leje qëndrimi dhe pa leje pune në atë periudhë.

33.5. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se që prej vajtjes së tij e deri aktualisht shumë nga të afërmit e tij, pjesa më e madhe e fisit si nga ana e nënës dhe nga ana e babait, jetojnë e punojnë në ishullin e Tinos. Në lidhje me bashkëpunimin me arkitektin grek, ka shpjeguar se ishte ai që merrte përsipër të gjitha detyrimet tatimore fiskale dhe se ata paguheshin jo me ditë pune, por me zëra punimesh. Ka deklaruar se në atë periudhë Greqia ka pasur zhvillim të lartë në sektorin e ndërtimit, çka ka sjellë përfitimin e të ardhurave të kondiderueshme, duke ritheksuar se çdo punë që ata kryenin, ka qenë e kontraktuar nga arkitekti grek dhe se detyrimet në shtetin grek janë përmbushur prej tij, pasi ata thjesht kanë qenë krahu zbatues dhe se në atë periudhë nuk kanë pasur dokumente. Në vijim, ka argumentuar se vërtetë ata mund të pajiseshin me ndonjë vizë turistike, por se ka qenë e pamundur që të merrnin leje qëndrimi në shtetin grek, pasi vonë, pas viteve 2000, ka filluar që në Greqi të aplikohet mundësia për t'u dhënë shtetasve shqiptarë leje qëndrimi dhe leje pune.

33.6. Për të ardhurat e krijuara në shtetin grek subjekti ka parashtruar se ekzistenca e tyre tregohet në kontratën e huas të datës 18.5.2000 dhe deklaratën e kthimit të huas, të datës 10.10.2000. Sqaron se këto pasuri në vlera monetare disponoheshin nga familja e tij, kryesisht falë punës së tij si emigrant në shtetin grek dhe se kjo gjë duket edhe nga fakti që ato kanë qenë të disponuara në monedhën dhrami⁶², monedha zyrtare e shtetit të Greqisë në atë periudhë.

33.7. Mbi disponimin e një pjesë të këtyre të ardhurave në sistemin bankar në shtetin grek, subjekti ka parashtruar se që në vitin 2014 ka deklaruar në ILDKPKI se ka pasur llogari në “Emporiki Trapeza” (Banka Tregtare), në këtë shtet, duke pretenduar se për një periudhë disamujore, fund viti 1999, deri në fillim viti 2000, nga persona të tretë janë derdhur në llogarinë e tij shuma të konsiderueshme, afro 6-8 milion dhrami, mbase dhe më shumë, por se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nuk e kujton shumën e saktë të kredituar në bankë nga të tretët. Për këto shuma, deklarohen se i janë derdhur në bankë për një punë në ndërtim që po kryenin në ishullin e Rodosit, pasi për shkak të largësisë, dakordësuan pagesën nëpërmjet bankës. Subjekti referon faktin se në vazhdimësi ka kontaktuar disa avokatë (mund të jenë 10 avokatë, grekë dhe shqiptarë) për të marrë informacion mbi këtë llogari dhe gjendjet e saj në atë periudhë, por se nuk ka arritur asnjë rezultat, duke pretenduar se kjo lidhet me faktin se banka “Emporiki Trapeza” është blerë nga “Alpha Bank” në vitin 2012, dhe se historiku i të gjitha llogarive të mbyllura ndër vite në “Emporiki Trapeza”, nuk është përthithur nga “Alpha Bank”. Subjekti pretendon se këtë informacion bankierët e japin verbalisht, por nuk e dokumentojnë, pasi sqarojnë se është veprim i pakryer nga “Alpha Bank”, të cilin në bazë të ligjit duhet të kryente dhe se këtë paligjshmëri nuk mund ta dokumentojnë shkesërisht.

33.8. Gjatë seancës dëgjimore subjekti ka sqaruar se për hapjen e llogarisë bankare në atë kohë është paraqitur fillimisht në “Etniki Trapeza”, që është Banka Kombëtare e Greqisë, por atje nuk ia kanë hapur si llogari, pasi i kanë thënë që duhet të kishte leje qëndrimi, e pastaj ka shkuar në bankën “Emporiki Trapeza”, e cila ishte bankë private dhe aty e kanë lejuar që të hapi llogari pa i kërkuar leje qëndrimi, por vetëm me pasaportën që dispononte. Subjekti ka pretenduar se ka disponuar dhe librezën e hapjes së kësaj llogarie deri në vitin 2007, por për shkak se ka seleksionuar dokumentet, nuk e ka ruajtur më atë.

33.9. Gjithashtu, në parashtrimet e tij, subjekti ka vënë në dijeni se edhe para njohjes nga Komisioni me rezultatet e hetimit administrativ, ka kontaktuar një avokat grek dhe një studio ligjore në Shqipëri,

⁶¹ Në mbështetje të deklaratimeve të tij ka depozituar tri deklarata të ndryshme përpiluara në gjuhën greke, të nënshkruara sipas rastit nga deklaruesit, shtetasit Sh. K, M.Gj dhe K.M, të apostiluar dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtar, z. S.K, konfirmuar me dokumentin noterial vërtetim përkthimi me nr. *** rep., datë 19.11.2021.

⁶² Referuar përmbajtjes së dokumenteve si vijon: (i) aktmarrëveshje për dhënie huaje, e datës 18.5.2000; dhe (ii) deklaratës noteriale të kthimit të huas të datës 10.10.2000.

duke i autorizuar që të paraqiten para bankës “Alpha” në Greqi, me qëllim marrjen e të dhënave mbi llogarinë/të e tij bankare. Gjithsesi, subjekti ka deklaruar se shpresat e tij për gjetjen e të dhënave të llogarisë bankare janë të vakëta, në kushtet kur, pavarësisht përpjekjeve të tij të vazhdueshme, ka rreth 4 vjet që nuk ka mundur të marrë këtë informacion, apo të marrë një përgjigje lidhur me ekzistencën ose jo të llogarive të mbyllura të bankës “Emporiki Trapeza”⁶³. Ai ka sqaruar se vazhdon të jetë në kërkim të marrjes së informacionit në “Alpha Bank”, Greqi, nëpërmjet dy kërkesave të reja që ka bërë nëpërmjet avokatit grek, I.P, i cili sipas orientimit të Degës Qendrore të Bankës në Athinë (për shkak të pandemisë) ka paraqitur dy kërkesa online⁶⁴, duke sqaruar se nga banka është konfirmuar se kërkesat janë regjistruar dhe se gjithashtu në dokumentin e konfirmimit është referuar se: *“Do përpunojmë kërkesën tuaj dhe do të komunikojmë me ju sa më shpejt të jetë e mundur”*⁶⁵, por se ende nuk i kanë kthyer një përgjigje mbi verifikimet e kryera.

33.10. Në vijim të prapësimeve të tij, me qëllim që të provojë pamundësinë për disponimin e këtij informacioni nga “Alpha Bank” në Greqi, subjekti ka evidentuar një rast të ngjashëm me rastin e tij, për të cilin kërkesa për disponimin e informacionit mbi gjendje të llogarisë bankare dhe tërheqjet e kryera (për vitet 1995 – 2000) në një nga bankat e Greqisë, është bërë me letërporosi nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, për nevoja të hetimeve që po kryeshin lidhur me një procedim penal, por se sërish nuk ka qenë e mundur marrja e informacionit. Subjekti ka evidentuar faktin se, në këtë rast, nga hetimet e kryera ka dalë që edhe vetë i kallëzuar ka pranuar tërheqjen e shumave që vëllai i tij i ndjerë ka pasur në bankë në shtetin grek, por se përgjigja e ardhur nga Banka Kombëtare Greke ka referuar se për të dhënat në lidhje me bankat bashkëpunuese (duke referuar disa banka), bëjnë me dije se sikurse janë njoftuar nga drejtoria kompetente, pasi kërkimi ka të bëjë me periudhën para përthithjes së tyre nga Banka Kombëtare, duhet të kontaktojnë me likuidatorin special “L. S. U.”. Dhe si rrjedhim, për shkak të mungesës së disponimit të informacionit, subjekti referon se Prokuroria ka paraqitur kërkesë për pushimin e procedimit penal⁶⁶.

33.11. Në këto kushte, subjekti ka argumentuar se, kur pamundësinë për të marrë informacion e ka prokuroria shqiptare nëpërmjet gjykatës dhe prokurorisë së shtetit grek, mundësitë reale të tij për të disponuar këtë informacion janë të pakta, kjo edhe për faktin se ka rreth 4 vjet që e kërkon. Për më tepër, subjekti sqaron se deri në këtë moment atë nuk e kanë referuar te ndonjë likuidator, që të ketë bërë veprimet e kalimit të aseteve nga “Emporiki Trapeza” në “Alpha Bank”.

33.12. Në lidhje me të ardhurat e krijuara nga bashkëpunimi me shoqërinë “***” sh.p.k., subjekti u qëndron deklarimeve të mëparshme dhe ka analizuar qarkullimin e deklaruar të kësaj shoqërie për periudhën, vitet 2001 – 2002, periudhë të cilën ka deklaruar se ka gjeneruar të ardhurat me të shumta nga ky partneritet në biznes, pasi bashkëpunimi me shoqërinë ka qenë i plotë dhe i vazhdueshëm. Duke referuar faktin se për këtë periudhë qarkullimi/të ardhurat e deklaruar në organin tatimor nga kjo shoqëri kanë qenë rreth 70 milionë lekë, pretendon se fitimi ka qenë më i lartë (rreth 50% e qarkullimit), në kushtet edhe të informalitetit të kohës.

33.13. Edhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka parashtruar se deri në vitin 2002 marrëdhënia me këtë shoqëri është e dokumentuar në librezën e punës, kjo e bërë edhe me qëllimin që ai të ishte i regjistruar për efekt sigurimesh shoqërore dhe shëndetësore, për sa kohë punonte dhe ishte në partneritet me këtë shoqëri. Më pas, në vitin 2002, filloi shkollën e lartë dhe për këtë arsye kishte shkëputje nga puna dhe kontributi i tij në shoqëri ra. Mbas mbarimit të shkollës së lartë, në vitin 2006

⁶³ Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar si prova të reja dokumentet: prokurë e posaçme, të lëshuar për avokatin N.B, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.10.2018, redaktuar nga noteri publik, z. E.A; prokurë e datës 25.6.2020 për avokatin Dh. K (e cila duket se është depozituar vetëm në gjuhën greke); dhe prokurë e lëshuar për studion ligjore “***” sh.p.k., me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2021, redaktuar nga noteri publik, z. E.A.

⁶⁴ Kërkesa e parë e datës 11.11.2021, regjistruar me numër reference *** dhe kërkesa e dytë e datës 15.11.2021, regjistruar me nr. reference ***.

⁶⁵ Në mbështetje të deklarimeve të tij subjekti ka depozituar si prova dy kërkesat drejtuar “Alpha Bank” në datat 11.11.2021 dhe 15.11.2021, regjistrimin e tyre dhe përgjigjen paraprake të dhënë nga banka “Alpha” në Greqi, si edhe autorizimin e lëshuar prej tij në datën 30.10.2021 avokatit, z. I. P, (të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtar, z. S.K).

⁶⁶ Në mbështetje të prapësimeve të tij subjekti ka depozituar kopje të kërkesës për pushimin e çështjes penale të bërë nga prokurori dhe kopje të dokumentave të sjellë nëpërmjet letërporosisë në Prokurorinë Gjirokastër.

e në vijim, kontributi i tij erdhi në rënie edhe për shkak të angazhimeve politike që kishte ndërmarrë, deri sa në vitet 2009 – 2010 është likuiduar edhe për pjesën e mbetur të përfitimeve që i takonin dhe rridhnin nga marrëdhënia e krijuar me këtë shoqëri.

33.14. Gjithashtu, në vijim të parashtrimeve të bëra gjatë senacës dëgjimore, ashtu sikurse ka deklaruar gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se një pjesë të likuiditeteve, të cilat disponoheshin prej tij në atë periudhë, ia ka huazuar mikut të ngushtë që prej fëmijërisë, z. I.E, i cili pasi u kthye nga Norvegjia në vitin 2006, solli në Shqipëri shoqëritë daneze “****” dhe “****”, duke regjistruar në Shqipëri shoqërinë “****”, e cila në fillim e ka ushtruar aktivitetin tek C.I, në hyrje të Tiranës. Deklaron se miku i tij së bashku me një shtetas kosovar kishin marrë ekskluzivitetin e këtyre shoqërive dhe se z. I.E zotëronte 49% të aksioneve të shoqërisë së regjistruar në Shqipëri. Për shkak se në atë kohë mikut të tij i nevojiteshin likuiditete, e ka ndihmuar pa interes me një pjesë të konsiderueshme të parave që ka pasur në disponim, të cilat deklaroi se janë përdorur prej tij në funksion të aktivitetit. Nisur nga lënia në përdorim e një pjese të mirë të likuiditeteve mikut të tij, z. I.E, në funksion të aktivitetit të shoqërisë së sipërcituar, në vitin 2008 është marrë nisma e shitjes së një pjese të kuotave të kapitalit të kësaj shoqërie, me një vlerë që përfaqësonte huan e dhënë, duke përpiluar kontratën e shitblerjes së aksioneve, por transaksioni nuk u realizua, për shkak se nuk u dha miratimi nga ortaku tjetër i shoqërisë. Në këtë kuptim, fondet iu lanë sërish në përdorim pa kundërshtpërbllim, z. I.E, deri në momentin që subjekti deklaroi se ia ka kërkuar që t’ia kthente, për arsye se duke qenë se ishin paratë e tij, do duhej t’i deklaronte për shkak të fillimit të detyrës, duke argumentuar se nuk ishte normale që një gjyqtar të deklaronte pasuri vetëm me deklarata noteriale.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

34. Komisioni vlerëson se, pavarësisht se pasuritë e subjekti i rivlerësimit, përfshirë dhe të personave të lidhur, janë krijuar përpara fillimit të detyrës, ato duhet të jenë objekt verifikimi në kuadër të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë çmohet se nëpërmjet procesit të rivlerësimit shqyrtohet edhe e shkuara e subjekteve të rivlerësimit.

34.1. Në vijim të arsyetimit, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit është analizë edhe e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria dhe, për këtë shkak, institucionet e rivlerësimit kontrollojnë burimin në të shkuarën, për të cilin është krijuar kjo pasuri dhe rivlerësimi mund të përkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike.

34.2. Në interpretim të nenit 179/b, pika 3 e nenit D të Kushtetutës dhe nenit 1 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në konkluzionin se nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezultojnë të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj.

34.3. Në këtë këndvështrim, për efekt të këtij procesi, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ka pasur detyrimin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe të mos fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij dhe organet e rivlerësimit kanë si qëllim që të identifikojnë ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

34.4. Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe nëpërmjet parashtrimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit u ka qëndruar të njëjtave shpjegime të dhëna më parë për krijimin e pasurive, duke argumentuar shkurtimisht dhe depozituar disa prova të reja mbështetëse lidhur me veprimtarinë dhe të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga puna në emigracion, shitja e njësisë së shërbimit në Kuçovë, si edhe nga bashkëpunimi me shoqërinë “****” sh.p.k., të cilat i ka referuar si burim krijimi të pasurive të tij dhe personave të lidhur. Vlen të theksohet se subjekti ka shpjeguar se të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga qiradhënia e lokalit

dhe nga aktiviteti i avokatisë kanë shërbyer vetëm për mbulimin e shpenzimeve familjare të kryera ndër vite⁶⁷.

34.5. Gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka depozituar disa dokumente mbështetëse, me anë të të cilave kërkon të provojë deklaratimet e tij lidhur me qiradhënien e lokalit dhe të ardhurat e përfituara si rrjedhojë e kësaj marrëdhënieje⁶⁸. Vlen të evidentohet fakti se kjo njësi shërbimi ka qenë në pronësi të nënës së subjektit dhe se të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e saj janë deklaruar se janë përdorur për shpenzime familjare. Në këtë këndvështrim, rezultojnë se gjithsesi, formalisht, ka qenë përgjegjësi dhe detyrim i nënës së tij të dokumentonte ligjërisht këtë marrëdhënie dhe të ardhurat e përfituara prej saj. Kjo vlerësuar edhe në konsideratë të vetëdeklarimeve të bëra, nga ku rezultojnë se për periudhën më të madhe të kohës gjatë të cilës referohet se kjo njësi ka qenë e dhënë me qira, subjekti i rivlerësimit ka qenë në emigracion. Nga ana tjetër, duke qenë se subjekti ka qenë gjithmonë në të njëjtin trung familjar me nënën e tij (djalin e vetëm), rezultojnë se në deklaratën “Vetting” këto të ardhura janë deklaruar prej tij si të ardhura të realizuara nga familja ndër vite, ashtu sikurse rezultojnë të jenë deklaruar vetëm prej tij dhe jo në deklaratimin e bërë veçmas nga nëna – si person i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016, të ardhurat nga shitja e kësaj njësie shërbimi.

34.6. Gjithashtu, Komisioni konstaton se gjatë hetimit administrativ⁶⁹ subjekti ka pranuar pasaktësinë në deklaratim lidhur me të ardhurat nga aktiviteti i avokatisë, duke argumentuar se ky nuk mund të konsiderohet si deklaratim i rremë, por vetëm lapsus nga ana e tij, pasi duket qartë se ka ngatërruar masën e qarkullimit vjetor, për efekt klasifikimi si biznes i vogël, me masën e fitimit real. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se nuk e di se sa të ardhura ka pasur nga puna si avokat, por di që nga këto të ardhura nuk ka para të akumuluar dhe se ato kanë shërbyer për mbajtjen e familjes në atë periudhë dhe për nevoja personale, duke parashtruar se gjithë pasurinë e tij e provon me dokumente që e ka pasur përpara periudhës kur ka punuar si avokat.

34.7. Nga hetimi i kryer, rezultoi se subjekti tregtar “A.D” person fizik, është regjistruar në QKB⁷⁰ në datë 11.6.2008 dhe ka pezulluar aktivitetin në datën 17.12.2010. Në vijim, ka kryer edhe procedurat e çregjistrimit. Në këtë kuptim, Komisioni vlerëson se, në kushtet kur edhe vetë informacioni i dërguar nga Bashkia Kuçovë⁷¹ nuk përputhet me informacionin e dërguar nga DRT Berat⁷², sa i përket qarkullimit të realizuar për periudhën që ka ushtruar aktivitet tregtar tatimpaguesi “A.D”, person fizik, rezultojnë bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ se ka deklaruar në tërësi qarkullimin maksimal për të cilin klasifikohet një biznes i vogël, në këtë rast për reth 2 vjet e gjysmë aktivitet, që i përgjigjet shumës prej 5 milionë lekë.

34.8. Gjithsesi, vlen të ritheksohet fakti se nga ana e subjektit, të ardhurat e deklaruara me burim nga qiradhënia e lokalit dhe nga aktiviteti i avokatisë, janë referuar se kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve familjare dhe jo për krijimin e pasurive. Si rrjedhojë, Komisioni u fokusua në verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

34.9. Nga analizimi në tërësi i shpjegimeve dhe provave të administruara, Komisioni krijoi bindjen se gjatë viteve 90’ deri në vitin 2000, subjekti i rivlerësimit ka qenë emigrant ekonomik në shtetin grek, fakt ky që rezultojnë të jetë i deklaruar prej tij edhe në formularin e dekriminalizimit⁷³, të

⁶⁷ Referohu përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore.

⁶⁸ Në mbështetje të deklaratimeve të tij, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar ndër të tjera: deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2014 (redaktuar nga noteri publik, znj. K.M), në referim të së cilës, shtetasi K.Z ka deklaruar se ka ushtruar aktivitet tregtar në një njësi tregtare të ndodhur në Kuçovë të marrë me qira nga L dhe Arben Dosti për periudhën maj 1998 – nëntor 2004 (duke referuar dhe vlerat përkatëse të qirasë mujore; dhe dy procesverbale me shkrim të lirë, njëri i datës 16.4.1998 dhe tjetri i datës 27.11.2000 të mbajtur midis shtetasit K. Z dhe nënës së subjektit L.D, për marrjen në dorëzim të pajisjeve të ndryshme që lidhen me njësinë e shërbimit.

⁶⁹ Referohu përgjigjeve të pyetësorit nr.2.

⁷⁰ Shkresa e QKB-së nr. *** prot., datë 31.3.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.4.2020.

⁷¹ Shkresa e Bashkisë Kuçovë me nr. *** prot., datë 20.1.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.1.2021.

⁷² Shkresa e DRT-së Berat me nr. *** prot., datë 22.1.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.1.2021.

⁷³ Formulari i përcjellë me shkresën e KLGJ-së me nr. *** prot., datë 11.10.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.10.2021.

depozituar për efekt të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në të cilin referon se ka jetuar në Tinos dhe Athinë, Greqi, për arsye punësimi, në periudha që i përkasin viteve të caktuara, nga viti 1992 deri në vitin 2000.

34.10. Nga ana tjetër, Komisioni vëren se në vitin 2000, familjarët e subjektit të rivlerësimit kanë disponuar vlera të konsiderueshme likuiditetesh në monedhën dhrami, monedha zyrtare e shtetit grek në atë periudhë. Kështu, nga analiza e provave rezulton se në prill të vitit 2000 babai i subjektit i ka dhënë hua shtetasit P.K shumën 18,000,000 dhrami, të cilat i janë kthyer subjektit të rivlerësimit në datën 10 tetor të vitit 2000. Gjithashtu, rezulton se datën 18 maj të vitit 2000, nëna e subjektit i ka dhënë hua shtetasit A.C, shumën 20,000,000 dhrami, vlerë për të cilën subjekti i rivlerësimit deklaroi se në vijim është lënë në përdorim dhe në funksion të aktivitetit tregtar të shoqërisë “****” sh.p.k.

34.11. Nga sa më sipër, rezulton e provuar se në prill të vitit 2000 familjarët e subjektit të rivlerësimit kanë disponuar shumën prej 38,000,000 dhrami, konvertuar me kursin e këmbimit të kohës në vlerën prej rreth 15,200,000 lekë. Lidhur me këto vlera monetare, pasi analizoi shpjegimet e dhëna në vazhdimësi nga subjekti i rivlerësimit në harmoni me provat e administruara në dosjen e hetimit administrativ, trupi gjykues krijoi bindjen se ato kanë si burim kryesor të ardhurat e përfituara nga puna e subjektit të rivlerësimit në emigracion.

34.12. Në këtë kuptim, duket i besueshëm dhe i vërtetë deklarimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit mbi shumën e të ardhurave të përfituara nga puna në emigracion, të cilat janë referuar se kanë shërbyer si burim krijimi i pasurive të tij, në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në deklaratën “Vetting”.

34.13. Sa i përket ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, Komisioni vlerëson se në arsyetimin e tij duhet të mbajë parasysh rrethana të tilla, të cilat përbëjnë fakte të njohura botërisht, se remitancat nga jashtë në ato vite kanë qenë në nivele të larta dhe kryesisht të pashoqëruara me burime legale të pagesës nga punëdhënësit dhe për më tepër të pataksuara në Shqipëri.

34.14. Në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti, Komisioni vëren se ai ka punuar në Greqi në mënyrë informale, pa leje qëndrimi/pa leje pune dhe, në këtë këndvështrim, rezulton se ka qenë në pamundësi objektive për deklarimin e këtyre të ardhurave si individ në atë shtet, e për rrjedhojë as për kryerjen e pagesës së detyrimeve tatimore përkatëse lidhur me to.

34.15. Nga ana tjetër, vlen të përmendet fakti se ekonomia shqiptare në ato vite është karakterizuar nga informaliteti në nivel të lartë. Koncepti i taksimit mbi të ardhurat është parashikuar në mënyrë të plotë vetëm pas miratimit të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

34.16. Në arsyetim logjik, bazuar në parimin e objektivitetit, trupi gjykues çmon se argumente të rëndësishme në këtë rast përbëjnë provueshmëria e ekzistencës së këtyre të ardhurave disa vite para fillimit të detyrës dhe shpjegimi bindës mbi ligjshmërinë e burimit të tyre – nga puna në emigracion, në kuptim të mosekzistencës së asnjë dyshimi se ato mund të jenë krijuar nga ndonjë aktivitet i paligjshëm kriminal⁷⁴, por se janë të ardhura të cilat janë përfituar nga punë e ligjshme e kryer në mënyrë informale, kjo në pamundësi objektive për të qenë ndryshe, për shkaqe që nuk vareshin prej tij. Në këtë kontekst vlerësohet edhe përpjekja e vazhdueshme e bërë nga subjekti për kërkimin e provave mbi ekzistencën e vlerave monetare të pretenduara si të disponuara prej tij në atë periudhë, në sistemin bankar të shtetit grek.

34.17. Duke mbajtur në konsideratë arsyetimin logjik më lart, duke e parë në tërësi kuptimin e normës kushtetuese që rregullon konceptin e të ardhurave të ligjshme, të ardhurat e deklaruara nga puna në emigracion, deklaruar me vërtetësi përgjatë gjithë këtij procesi, vlerësohet se duhet të konsiderohen si burime të ligjshme.

⁷⁴ Referohu verifikimeve të kryera dhe vlerësimit përfundimtar të Komisionit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, të analizuara në vijim - pjesë e këtij vendimi.

34.18. Gjithashtu, bazuar në prova e indicie të besueshme, Komisioni krijoi bindjen se pas kthimit nga emigracioni, për periudhën 2000 – 2010 subjekti i rivlerësimit ka qenë në marrëdhënie me shoqërinë “****” sh.p.k., dhe se ka përfituar të ardhura nga ky bashkëpunim.

34.19. Sikurse u konstatua më sipër, rezultoi e provuar se në maj të vitit 2000, nëna e subjektit të rivlerësimit i ka dhënë hua shumën 20,000,000 dhrami shtetasit A.C, i cili figuron si përfaqësues ligjor dhe ortak i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k. Për këtë shumë të dhënë, me burim të ardhurat e krijuara nga puna në emigracion, subjekti ka deklaruar se pasi humbi qëllimi fillestar i dhënies së saj, u la në përdorim dhe në funksion të zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë “****” sh.p.k., dhe se për këtë shkak ai filloi bashkëpunimin/partneritetin me këtë shoqëri.

34.20. Nga analiza e provave ka rezultuar se, për periudhën 1.1.2001 deri 31.5.2002 subjekti ka qenë i regjistruar si punonjës i shoqërisë “****” sh.p.k., dhe se gjithashtu në atë periudhë ka pasur në përdorim automjetin e shtetasit A.C, identifikuar si përfaqësues ligjor dhe ortak i vetëm i shoqërisë së sipërcituar.

34.21. Gjithashtu, rezulton se zoti C në vazhdimësi ka konfirmuar marrjen e vlerës monetare në vitin 2000, si kontribut nga subjekti i rivlerësimit, përdorimin e saj për nevoja të aktivitetit tregtar, si edhe bashkëpunimin në biznes me të. Në vijim, vërehet se prej tij janë konfirmuar plotësisht deklaratimet e bëra nga subjekti, përfshirë këtu edhe faktin se kryesisht marrëdhënia e tyre ka qenë e paformalizuar, përveçse vitit të parë të bashkëpunimit, duke sqaruar se krahas kthimit të shumës së marrë hua, z. Arben Dosti është shpërblyer prej tij gjatë viteve 2000 – 2010 për punën që ka kryer në këtë shoqëri.

34.22. Në vijim të arsyetimit, Komisioni vlerëson se bazuar në nenin 246 të Kodit të Procedurës Civile, shkresat e shoqërisë “****” sh.p.k., të nënshkruara nga përfaqësuesi ligjor dhe ortak i vetëm i saj, z. A.C, marrin fuqi provuese për efekt të këtij procesi, për sa kohë që gjejnë mbështetje dhe harmonizohen me të dhënat, informacionet dhe provat e grumbulluara nga Komisioni në kuadër të hetimit administrativ të kryer.

34.23. Parë në një këndvështrim tjetër, në kushtet kur Komisioni krijoi bindjen mbi punën e kryer/bashkëpunimin e subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “****” sh.p.k., në rastin e kategorizimit të saj si një marrëdhënie shërbimi të kryer nga subjekti për shoqërinë (ashtu sikurse është deklaruar nga subjekti dhe konfirmuar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë), në vlerësim të ligjshmërisë së burimit të krijimit të këtyre të ardhurave të pretenduara, u analizua kuadri ligjor mbi bazën e së cilit do të duhej të deklaroheshin, mbaheshin dhe paguheshin detyrimet tatimore mbi to.

34.25. Komisioni vëren se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është ligji bazë mbi të cilën rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat në tri kategori kryesore: (i) tatimi mbi të ardhurat personale; (ii) tatimi mbi fitimin; dhe (iii) tatimi i mbajtur në burim i të ardhurave. Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit në fuqi.

34.26. Në nenin 4 të këtij ligji, “Burimi i të ardhurave”, janë përcaktuar llojet e të ardhurave të realizuara nga një burim në Republikën e Shqipërisë, por pa u kufizuar vetëm në to, dhe një nga kategoritë e këtyre të ardhurave janë të ardhurat e parashikuara në germën b) “të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera personale në Republikën e Shqipërisë”.

34.27. Fusha e veprimit të tatimit mbi të ardhurat për kategoritë e të ardhurave personale, shtrihet mbi të ardhurat e individëve (neni 6), të cilët janë rezidentë në kuptim të Kodit Civil dhe në kuptim të nenit 7 të ligjit të sipërcituar, i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu.

34.28. Për sa më sipër, si edhe bazuar në parashikimet e bëra në nenin 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Komisioni vlerëson se të ardhurat e përfituara nga z. Arben Dosti, në funksion shërbimeve të kryera në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., janë të ardhura të tatueshme.

34.29. Por, nga ana tjetër, Komisioni vëren se në referim dhe interpretim të përcaktimeve të bëra në nenin 33 të këtij ligji (i cili ka pësuar vazhdimisht ndryshime) “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë në burim nga shuma bruto e pagesave edhe mbi pagesat e kryera ndaj individëve për shërbimet e kryera prej tyre.

34.30. Edhe me anë të udhëzimit të ministrit të Financave me nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, e konkretisht në pikën 5.1., të tij është përcaktuar se në zbatim të nenit 33 të ligjit, të gjithë personat, përfshirë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë tregtarë rezidentë tatimorë në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, që bën pagesë të çdonjërës nga llojet e pagesave që listohen në nenin 33, është i detyruar të mbajë tatim në burim dhe ta derdhë atë në organin tatimor përkatës.

34.31. Pra, duke e analizuar këtë marrëdhënie nën prizmin e një shërbimi të kryer nga subjekti i rivlerësimit si individ, detyrimi për deklarimin, mbajtjen dhe pagesën e tatimit mbi këto të ardhura i takonte shoqërisë “****” sh.p.k., e cila në këtë rast do të luante rolin e agjentit tatimor.

34.32. Gjithsesi, Komisioni vlen të theksojë faktin se që në deklarimin fillestar (deklarata para fillimit të detyrës dorëzuar në datën 13.1.2014 në ILDKPKI), si edhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në datën 19.9.2014 drejtuar ILDKPKI-së, subjekti ka referuar si burim krijimi të pasurive të ardhurat nga puna/si sipërmarrës/nga bashkëpunimi në biznes me shoqërinë “****”, të ardhura të cilat deklarohen se janë krijuar për periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2010, pra, para fillimit të detyrës.

34.33. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e njësisë së shërbimit në pronësi të nënës së tij, Komisioni konstatoi se provohet me dokumentacion justifikues ligjor vetëm përfitimi i shumës prej 3,900,000 lekë nga ky transaksioni i kryer dhe se këto të ardhura i përkasin nënës së subjektit të rivlerësimit, si pronare e vetme e kësaj pasurie.

34.34. Gjithsesi, në kuadër të verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve të subjektit, vërehet se nga ana e blerësit nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 5.12.2018 është pranuar fakti i pagimit të çmimit në shumën prej 12,800,000 lekësh. Gjithashtu, rezulton se janë në harmoni dhe përputhen shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me origjinën e shumës prej 8,000,000 lekësh, të depozituar prej tij në “Raiffeisen Bank”, në datën 9.12.2005 (të deklaruar me burim nga shitja e njësisë së shërbimit) me deklaratimet e bëra nga blerësi, pasi edhe pse Komisioni konstatoi se në dukje kjo shumë është krijuar si rezultat i tërheqjes së vlerës së depozituar më parë prej tij në datën 26.11.2004 (rreth 1 muaj para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së lokalit) në “Procredit Bank”, në dokumentin noterial të nënshkruar në datën 5.12.2018, z. S.B. ka deklaruar se shumën prej 12,800,00 lekë e ka paguar në dy këste, një këst një muaj më parë dhe këstin e dytë, ditën e lidhjes së kontratës.

34.35. Sa më sipër, në vlerësim të provave të administruara dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues krijoi bindjen se njësia e shërbimit është shitur realisht më shumë se vlera e përcaktuar në kontratë, por se gjithsesi rezulton se nuk janë paguar plotësisht detyrimet tatimore për çmimin e pretenduar. Trupi gjykues çmon se, në këtë rast, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti i rivlerësimit, qoftë edhe të karakterit etik, vlerësuar kjo për kohën kur është kryer transaksioni, si edhe për faktin se titullare e pasurisë ka qenë vetëm nëna e tij, e cila ka pasur të drejta dhe detyrime të plota në këtë marrëdhënie juridike. Nga ana tjetër, Komisioni vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit se ka përfituar një pjesë të vlerës së përfituar nga shitja e kësaj pasurie, fakt ky i pranuar nga nëna e tij, me argumentin se kjo ka ndodhur për shkak të pagesës së çmimit të privatizimit dhe investimeve të kryera tek kjo pasuri nga subjekti, ku përfshihen edhe shtesat funksionale të kësaj pasurie të pasqyruara në vetëdeklarimin për legalizimin e shtesës së datës 30.10.2006.

34.36. Në këtë kuptim, rezulton se subjekti ka deklaruar marrëdhënien reale të përfitimit të kësaj shume, duke mos e konsideruar si dhurim. Komisioni edhe më sipër konstatoi se në deklaratën “Vetting” të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie janë deklaruar vetëm nga subjekti i rivlerësimit dhe

jo nga nëna e tij, si person i lidhur. Këtë fakt, trupi gjykues e vlerëson si pasaktësi në deklaram me peshë specifike të vogël dhe pa pasoja për procesin e rivlerësimit, për sa kohë rezulton se nëna e tij ka qenë gjithmonë në të njëjtin trung familjar me të dhe rezulton se ka qenë subjekti që ka deklaruar të gjitha të ardhurat që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive, përfshirë dhe të personave të lidhur (bashkëshortes dhe nënës së tij).

34.37. Komisioni, pasi vlerësoi provat e depozituara nga subjekti, shqyrtoi parashtrimet dhe shpjegimet e tij të paraqitura me shkrim dhe pasi e dëgjoi në seancë dëgjimore, si dhe duke marrë parasysh vetë kohën në të cilën janë krijuar këto të ardhura të deklaruara si burim për krijimin e pasurive - të shpjeguara si më lart, konstaton se ato janë realizuar shumë kohë para miratimit dhe hyrjes në fuqi të paketës kushtetuese të Reformës në Drejtësi, duke përfshirë dhe ligjin nr. 84/2016, të cilët përcaktuan rregulla specifike në drejtim të provueshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të siguruara nga subjektet e rivlerësimit, për efekt të kontrollit e verifikimit të pasurive të tyre. Për më tepër, rezulton se ato janë krijuar edhe shumë kohë para fillimit të detyrës. Në këtë kuptim, standardi i provueshmërisë për këto të ardhura duhet të jetë ai i nxjerrjes së justifikimit bindshëm edhe për një nivel më të ulët të provave, sesa do të duhej për të kënaqur standardin e provueshmërisë për pasuritë e vëna gjatë ushtrimit të detyrës apo periudhës së rivlerësimit. Kjo mënyrë e të arsyetuarit lidhet me logjikën se këto të ardhura me të cilat janë krijuar pasuri presupozohen që janë vënë, duke mos abuzuar me detyrën (që efektivisht nuk mbahej) dhe as ndonjë funksion tjetër publik, dhe për pasojë, duke shmangur për këto pasuri mundësinë e mosbesimit të publikut drejt ligjshmërisë së krijimit të tyre.

34.38. Trupi gjykues vëren se këto burime të ardhurash janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit që në deklaramin fillestar të pasurisë (deklarata para fillimit të detyrës dorëzuar në ILDKPKI në datë 13.1.2014), si edhe më specifikisht nëpërmjet shpjegimeve të drejtuara ILDKPKI-së në datën 19.9.2014, duke shuar çdo dyshim për abuzim nga subjekti me burimin e të ardhurave vetëm në funksion të deklaramit “Vetting”. Pra, nuk jemi përpara rastit kur këto të ardhura deklarohen rishtas vetëm në deklaramtën “Vetting” për qëllime të procesit të rivlerësimit. Vlen të përmendet edhe qëndrimi konsistent i subjektit të rivlerësimit, i cili ka vetëdeklaruar se një pjesë të këtyre të ardhurave nuk i justifikon me dokumentacion justifikues ligjor, pasi janë krijuar nga marrëdhënie pune të paformalizuara, çka të bën të arrish në përfundimin se ai ka qenë i vërtetë në gjithë deklaramet e tij.

34.39. Nën dritën e këtyre fakteve, bazuar në analizën dhe arsyetimin logjik të kryer si më sipër, pasqyrimin ndër vite të vlerave monetare të konsiderueshme në disponim të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, gjendjes së trupëzuar/materializuar në sistemin bankar të pasurive të llojit “likuiditete” para fillimit të detyrës, si edhe në konsideratë të faktit se subjekti në vazhdimësi ka mbajtur të njëjtin qëndrim në deklaramet e bëra për krijimin e pasurive, Komisioni arrin në përfundimin se për pasuritë të cilat janë konstatuar si të krijuara para fillimit të detyrës, të deklaruara edhe në deklaramtën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm ligjshmërinë e të ardhurave të referuara si burim krijimi i tyre.

34.40. Komisioni kreu verifikime edhe për pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit pas dorëzimit të deklaramtës “Vetting”, nga ku rezultoi se si burim për blerjen e tyre kanë shërbyer likuiditetet e disponuara në bankë nga personi i lidhur, të deklaruara në deklaramtën “Vetting”, konstatuar nga Komisioni si të krijuara para fillimit të detyrës (të analizuara si më sipër). Në këtë kuptim, nuk ka dyshime për krijimin e këtyre pasurive.

34.41. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaramet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI si edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, për periudhën nga fillimi i detyrës në datë 21.10.2013 – 31.12.2013 dhe vitet 2014, 2015, 2016, nga ku rezultoi se për çdo periudhë të marrë në analizë subjekti paraqitet me balancë pozitive fondesh.

34.42. Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendime dhe ka depozituar prova të reja mbështetëse për të kundërshtuar disa zëra shpenzimesh të përlllogarituara dhe të reflektuara në analizë financiare. Por, në kushtet kur,

gjithsesi, analiza financiare për periudhën e sipërcituar paraqitet me balancë pozitive fondesh, trupi gjykues nuk vlerësoi të thellohet në analizimin e tyre.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

35. Nga hetimi administrativ dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

35.1. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij dhe personave të lidhur. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

35.2. Siç u pasqyrua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor.

35.3. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaram, nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia.

35.4. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

36. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (“DSIK”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ai ka/ka patur kontakte të pa përshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

36.1. Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, DSIK-ja ka përcjellë në Komision raportin për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosti, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

36.2. Në vijim të informacioneve të ardhura rishtazi nga institucioni i verifikimit, në kohështrirje përpara dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, në raportin të përditësuar⁷⁵ referohet se për subjektin e rivlerësimit ka dyshime se mund të ketë qenë i përfshirë në vepra të ndryshme penale në shtete të huaja (Greqi/Itali), në bashkëpunim me persona të tjerë, dhe se gjatë viteve 1997 – 1998, ka qenë i dënuar me burg në shtet të huaj (Itali), periudhë në të cilën mendohet të ketë përdorur gjeneralitete të tjera. Si rrjedhojë, për subjektin e rivlerësimit ngrihen dyshime se ka pasur kontakte me disa persona të përfshirë në krimin e organizuar, me të cilët ka njohje shoqërore.

36.3. Gjithsesi, Komisioni vëren se vetë DSIK-ja raporton se⁷⁶ informacionet e sipërcituar, të cilat ngrejnë dyshime se subjekti i rivlerësimit mund të ketë qenë i përfshirë në vepra të rënda kriminale, nuk janë konfirmuar.

36.4. Në vijim, në raportin e DSIK-së pasqyrohet se, sipas informacionit të dërguar nga institucioni i verifikimit, për subjektin e rivlerësimit ngrihen dyshime për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës, me qëllim lirim nga burgu të një të

⁷⁵ Raporti me nr. *** prot., datë 2.2.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 18.3.2021.

⁷⁶ Bazuar në të dhënat/indikiet/raportin e dërguar nga institucioni i verifikimit, i cili ka qenë burimi i këtij informacioni.

pandehuri, gjatë ushtrimit të detyrës së gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Gjithashtu, në raport referohet fakti se institucionet verifikuese kanë ndarë informacione me institucionet shtetërore, ku ndër të tjera thuhet se një avokat është i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës – ndaj shtetasit Arben Dosti me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Konkretisht, në raportin e DSIK-së referohet se i është dërguar Prokurorit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë për Krime të Rënda informacioni për “...veprimtari të kundërligjshme në sistemin e drejtësisë Gjirokastrë...”.

36.5. Si përfundim, në raportin e saj, DSIK-ja ka parashtruar se:

a. Informacionet e tjera që disponohen për subjektin e rivlerësimit, vlerësohen për aktualitetin e tyre, kohëzgjatjen, pra më shumë se një herë, të përfshirjes apo implikimit në veprimtari të kundërligjshme, në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit, në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës së tij funksionale.

b. Situata pasqyron korrupsion sistematik në vetë sistemin e drejtësisë, ku në rastin në fjalë përfshihet në veprime korruptive një gjyqtar. Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale “Krimi i organizuar dhe korrupsioni”.

c. Marrëdhënia e dyshuar korruptive ndërmjetësohet dhe shtrihet në persona të tretë (palët në hetim), lidhje pune të subjektit të rivlerësimit, duke vendosur sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit 84/2016, një *kontakt të papërshtatshëm*, në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës nga ky subjekt rivlerësimi.

d. Bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, ligjvënësi u është referuar kontakteve të papërshtatshme, që mund të ketë subjekti i rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Nisur nga qëllimi dhe fryma e ligjit, ku procesi i rivlerësimit përfshin kontrollin tërësor të prokurorëve dhe gjyqtarëve, duke filluar nga vetë subjekti e më pas duke zbuluar ose identifikuar lidhjet e subjekteve me krimin e organizuar, më së pari subjekti i rivlerësimit është vetë subjekti i kontrollit të ligjit dhe përfshirjes ose jo në krimin e organizuar.

e. Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në këtë rast të një gjyqtari, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, të çfarëdoqdo përfitimi të parregullt, për të kryer ose moskryer një veprim, që lidhet me detyrën e tij funksionale, cenon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht përcaktimet e germave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ku Arben Dosti, vlerësohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale.

36.6. Për sa më sipër, në raportin e përditësuar, grupi i punës në DSIK ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosti, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

36.7. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve/sinjalizimeve të dërguara/përfituara nga agjencitë ligjzbatuese (institucionet e verifikimit), sa më poshtë vijon:

36.7.1. Bazuar në kërkesën e bërë nga Komisioni⁷⁷, Prokuroria e Përgjithshme⁷⁸, ka përcjellë të gjithë informacionin për subjektin e rivlerësimit, të ardhur nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka informuar se nga institucionet ligjzbatuese ka ardhur informacioni me nr. *** prot., datë 17.4.2019 me lëndë “Mbi dyshime për veprimtari korruptive në sistemin e drejtësisë Gjirokastrë”, për të cilin referon se është dërguar edhe në ish-Prokurorinë për Krime të Rënda dhe se, për shkak se kjo e fundit ka qenë prokurori kompetente për hetimin e këtyre veprave penale, prej saj nuk janë kryer verifikime dhe ky informacion është arkivuar.

⁷⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 26.1.2021.

⁷⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 2.6.2021, protokolluar në Komision nr. *** prot., datë 3.6.2021.

36.7.2. Komisioni i kërkoi⁷⁹ Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të informojë lidhur me trajtimin e informacionit dërguar nga institucionet ligjzbatuese dhe në këtë kuadër të konfirmojë nëse për subjektin e rivlerësimit ka pasur procedim penal të mosfilluar, pushuar, pezulluar, transferuar, apo dërguar për gjykim.

36.7.3. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁸⁰ konfirmon se, pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale nuk rezulton që në emër të shtetasit Arben Dosti, të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Por, nga ana tjetër informon se ndaj shtetasit Arben Dosti, rezulton të jenë regjistruar 2 (dy) kallëzime penale, për të cilët pas verifikimeve të kryera është vendosur mosfillimi i procedimit.

36.7.4. Nga verifikimi i dosjeve të këtyre dy materialeve kallëzuese ka rezultuar se:

i) bazuar në kallëzimin e bërë nga shtetasi V.Ç ndaj shtetasit Arben Dosti, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjqësor Gjirokastrë, Prokuroria për Krime të Rënda, në datën 18.3.2019 ka regjistruar materialin kallëzues nr. ***. Pas verifikimeve të kryera mbi pretendimet e ngritura në kallëzim, nga prokurori i çështjes është vlerësuar se ato nuk ekzistojnë, si edhe nuk ka elemente të ndonjë veprave penale nga gjyqtari Arben Dosti, duke vendosur në datën 25.3.2019, mosfillimin e procedimit penal.

ii) bazuar në kallëzimin e bërë nga shtetasi S.Q, i cili duket se lidhet me vendimmarrjen e gjyqtarit Dosti, Prokuroria për Krime të Rënda, në datën 16.1.2020, ka regjistruar materialin kallëzues nr. ***. Pas verifikimeve të kryera mbi pretendimet e ngritura në kallëzim, nga prokurori i çështjes është vlerësuar se ekzistojnë rrethanat për të vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke disponuar në datën 29.1.2020 me vendim mosfillimi.

44.4 Trupi gjykues vëren se dy kallëzimet e regjistruara në ish-Prokurorinë për Krime të Rënda, në të cilat përmendet subjekti i rivlerësimit, nuk lidhen me informacione të mundshme të dërguara nga institucionet ligjzbatuese. Sjellim në vëmendje këtu se Prokuroria e Përgjithshme ka informuar Komisionin se në ish-Prokurorinë për Krime të Rënda, nga institucionet ligjzbatuese është dërguar informacioni me nr. *** prot., datë 17.4.2019, me lëndë “Mbi dyshime për veprimtari korruptive në sistemin e drejtësisë Gjirokastrë”, nga ku lihet të kuptohet se në këtë informacion përmendet edhe subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti.

36.7.5. Si rrjedhim logjik, duket se mbi informacionet e institucioneve ligjzbatuese të cilat janë ndarë edhe me organet shtetërore (siç është pasqyruar edhe në raportin e DSIK-së) në këtë rast me organin e Prokurorisë, nuk është regjistruar ndonjë kallëzim apo procedimin penal ndaj subjektit të rivlerësimit, kjo në këndvështrim edhe të faktit që mund të jenë zhvilluar hetime kryesisht për verifikimin e këtyre informacioneve.

36.8. Gjithashtu, konstatohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë⁸¹ ka dërguar kopje të materialit kallëzues të mosfilluar ku përmendet subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti. Nga verifikimi i dosjes së këtij materiali kallëzues, rezulton se bazuar në kallëzimin e bërë nga shtetasi K.M ndaj disa gjyqtarëve, përfshirë dhe gjyqtarin Dosti, për konsumimin e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në datën 26.12.2018, është regjistruar kallëzimi nr. ***. Pas verifikimeve të kryera mbi pretendimet e ngritura në kallëzim, prokurori i çështjes ka vlerësuar se nuk plotësohen elementet e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe as të ndonjë veprave tjetër penale, dhe për këto arsye, po në datën 26.12.2018, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

36.9. Në vijim të verifikimit të dokumentacionit të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme, rezultoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë ka informuar se për shtetasin Arben Dosti janë regjistruar dy materiale kallëzuese: (i) kallëzimi nr. ***, datë 14.12.2018; dhe (ii) kallëzimi nr. ***, datë 25.10.2018, të cilat janë dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës

⁷⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 14.9.2021.

⁸⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 1.10.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 4.10.2021.

⁸¹ Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me nr. *** prot., datë 24.2.2021, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, përcjellë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 2.6.2021.

së Parë Gjirokastër. Ndërkohë, nga ana tjetër konstatohet se kjo prokurori⁸² ka informuar Prokurorinë e Përgjithshme se nuk rezulton të ketë materiale kallëzuese të mosfilluara dhe se nuk ka procedime penale të pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim, ku të përmendet subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti.

36.9.1. Nisur nga informacioni i dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme nga Prokuria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, Komisioni i kërkoi⁸³ Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër të informojë lidhur me ecurinë e dy materialeve kallëzues, të konstatuara si më sipër.

36.9.2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër⁸⁴, informon se nga këqyrja e regjistrave të kallëzimeve penale rezultoi se: (i) në datë 3.8.2018, është regjistruar materiali kallëzues me nr. ***, ndaj shtetasit Arben Dosti, dhe se në datën 5.12.2018, ky material kallëzues është dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë; (ii) në datën 11.9.2018, është regjistruar materiali kallëzues me nr. *** ndaj shtetasit Arben Dosti dhe se në datën 19.10.2018, ky material kallëzues është dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

36.9.3. Në këto kushte, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë duke i kërkuar⁸⁵ informacion lidhur me ecurinë e këtyre dy materialeve kallëzues, si edhe vënien në dispozicion të fashikujve përkatës të tyre.

36.9.4. Prokuroria⁸⁶ konfirmon se nga verifikimet e bëra në arkivin e saj, rezulton se për subjektin Arben Dosti janë regjistruar dy kallëzime penale, kallëzimi nr. ***, datë 25.10.2018 dhe kallëzimi nr. ***, datë 14.12.2018, për të cilat është vendosur mosfillim.

36.9.5. Nga verifikimi i dosjesve të dërguara konstatohet se këto materiale kallëzuese janë regjistruar bazuar mbi të njëjtat fakte nga kallëzimet me të njëjtën përmbajtje të bëra nga shtetasit A.S., I.Q., E.K., Sh.Xh., A.M., dhe A.J. Rezulton se, më parë gjyqtari Dosti i ka kallëzuar këta shtetas për ekspertim të rremë dhe duket se pikërisht për këto shkaqe ata e kanë kallëzuar atë për konsumimin e veprës penale të “Kallëzimi i rremë”, fakt për të cilin, siç u konstatua më sipër, në dy rastet është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

36.10. Gjithashtu, nga institucionet verifikuese disponoheshin indicie, sinjalizime të dhëna mbi ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti, duke referuar disa shtetas për të cilët pretendohen se janë të përfshirë në vepra penale që lidhen me krimin e organizuar.

36.10.1. Megjithëse gjatë hetimit administrativ nuk u konstatua ndonjë kontakt i subjektit të rivlerësimit me shtetasit e referuar në sinjalizimet e organit verifikues – gjatë periudhës së ushtrimit prej tij të detyrës së gjyqtarit, Komisioni i kërkoi⁸⁷ Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar informacion nëse për këta shtetas ka pasur procedim penal të mosfilluar, të pushuar, të pezulluar, të transferuar, apo të dërguar për gjykim.

36.10.2. Në përgjigje, Prokuroria⁸⁸ informon se, pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale nuk rezulton që në emër të këtyre shtetasve të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

36.11. Komisioni kreu verifikime edhe mbi informacionet/sinjalizimet (të pakonfirmuara) e organeve të verifikimit, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit mund të ketë qenë i përfshirë në vepra penale apo të ketë qenë i dënuar në shtete të huaja.

⁸² Shkresa nr. *** prot., datë 16.2.2021.

⁸³ Shkresa nr. *** prot., datë 14.9.2021.

⁸⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 21.9.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.9.2021.

⁸⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 23.9.2021.

⁸⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 28.9.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.9.2021.

⁸⁷ Shkresat nr. *** prot., datë 22.2.2021; dhe nr. *** prot., datë 14.9.2021.

⁸⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 1.10.2021.

36.11.1. Komisioni u kërkoi⁸⁹ institucioneve përkatëse formularin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (ligji i dekriminalizimit).

36.11.2. KLGJ-ja⁹⁰, si organi përgjegjës për administrimin e formularit të vetëdeklarimit të personave që mbartin detyrimin ligjor të deklarimit të mosegzistencës së shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar sipas parashikimeve të ligjit nr. 138/2015, ka dërguar kopje të formularit të vetëdeklarimit të gjyqtarit Arben Dosti, i depozituar në datën 18.4.2016 dhe që mban numrin unik ***.

36.11.3. Nga verifikimi i këtij formulari rezulton se subjekti i rivlerësimit z. Arben Dosti ka deklaruar se: (i) nuk është dënuar ndonjëherë me vendim të formës së prerë apo jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj; (ii) nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose në gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e ndonjë vepre penale; (iii) nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale; (iv) ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale; dhe se (v) nuk është lëshuar ndonjëherë ndaj personit të tij urdhër kërkimi ndërkombëtar për kryerjen e ndonjë vepre penale.

36.11.4. Nga ana tjetër, Komisioni vëren se, në përgjigje të pyetjes nr. 8 të këtij formulari: “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj?” dhe kërkesës për të specifikuar të dhënat mbi qëndrimin në shtetin e huaj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka jetuar në Tinos dhe Athinë, Greqi, për arsye punësimi, në periudha që i përkasin viteve të caktuara, nga viti 1992 deri në vitin 2000.

36.11.5. Në vijim të hetimeve, Komisioni i kërkoi⁹¹ Prokurorisë së Përgjithshme të konfirmojë nëse në referim ligjit nr. 138/2015, të jenë kryer verifikime për subjektin e rivlerësimit. Prokuroria e Përgjithshme⁹² informon se në zbatim të ligjit nr. 138/2015, nuk janë kryer verifikime për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosti.

37. Në Komision janë depozituar edhe dy denoncime nga publiku, të cilat hidhnin dyshime për kryerjen e veprimeve të kundërligjshme, integritetin dhe figurën e subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Arben Dosti, të pasqyruara si më poshtë:

Denoncimi i shtetasit, identifikuar me gjeneralitet (emër/mbiemër) A.Ç⁹³

37.1. Referuar ankesës së depozituar në Komision, denoncuesi hedh dyshime se subjekti i rivlerësimit është i përfshirë në veprime korruptive që lidhen me ushtrimin e detyrës së tij si gjyqtar. Gjithashtu, ai pretendon se subjekti i rivlerësimit ka qenë i dënuar jashtë shtetit dhe se i është drejtuar edhe më parë me ankesë Komisionit.

37.1.1. Nga verifikimi i këtij denoncimi vërehet se denoncuesi nuk ka paraqitur gjeneralitete të plota, nuk ka deklaruar adresën e tij dhe as ka referuar ndonjë numër telefonik, të cilat do të bënin të mundur që Komisioni kontaktonte me të, me qëllim marrjen e të dhënave të reja dhe/apo dëshmisë së tij - lidhur me faktet e denoncuar.

37.1.2. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, para zhvillimit të seancës dëgjimore, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit është depozituar një letër⁹⁴ nga shtetasi me gjeneralitet, A.Ç, i datëlindjes 6.6.1972 (identifikuar me dokumentin letërnjoftim me nr. ***), sipas së cilës ai ka parashtruar ndër të tjera se, *...ka rënë në dijeni të faktit se nga Komisioni është administruar një ankesë në drejtim të gjyqtarit Dosti, ku në fund të letrës është emri dhe nënshkrimi i tij. Deklaron se kjo shkresë është e falsifikuar dhe nuk është shkruar dhe dërguar prej tij. Ai dhe familjarë të afërt të tij kanë pasur disa procese gjyqësore me gjyqtar Arben Dosti, për të cilat mund të kenë kundërshtitë e tyre lidhur me mënyrën e zgjidhjes së çështjeve prej tij, por nuk kanë asnjë pretendim apo dyshim për veprime*

⁸⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 4.10.2021.

⁹⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 11.10.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.10.2021.

⁹¹ Shkresa nr. *** prot., datë 4.10.2021.

⁹² Shkresa nr. *** prot., datë 11.10.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.10.2021.

⁹³ Ankesa nr. *** prot., datë 21.7.2021.

⁹⁴ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.11.2021.

korruptive të tij, për njëanshmëri në gjykim, e aq më tepër të kenë informacion se ai të jetë dënuar jashtë shtetit.

37.1.3. Megjithëse, referuar letrës së dërguar ky shtetas ka deklaruar se ka patur procese gjyqësore me gjyqtarin Dosti, në kushtet kur, me gjeneralitet (emër/mbiemër) A.Ç, janë të regjistruar disa shtetas në Republikën e Shqipërisë, Komisioni nuk mund të konkludojë nëse me anë të këtij denoncimi janë përdorur ose jo të dhënat e tij. Por, gjithsesi, për sa kohë nuk u arrit identifikimi i denoncuesit, i cili në dukje ka dashur të mbetet anonim dhe nuk u mundësua marrja e të dhënave të tjera të mundshme në mbështetje të fakteve të denoncuara, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e ngritura në këtë ankesë mbeten të paprovuara.

Denoncimi i shtetasit të identifikuar me gjeneralitetet (emër/mbiemër) A.LI⁹⁵

37.2. Referuar ankesës së depozituar në Komision, ky denoncues hedh dyshime se gjyqtari Arben Dosti është i përfshirë në veprime korruptive duke bashkëpunuar me avokat, duke ndërhyrë në shorte dhe në kryerjen e veprimeve të tjera arbitrare. Gjithashtu, denoncuesi hedh dyshime se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, ka qenë i dënuar jashtë shtetit.

37.2.1. Komisioni konstatoi se në zarin ardhur, me të cilin është përcjellë ky denoncim është shënuar si dërgues, krahas emrit A.LI, dhe studio ligjore “J”.

37.2.2. Pasi u kryen kërkime në faqen zyrtare të QKB-së, u identifikuan ndër të tjerë dy subjekte tregtare, në të cilat shtetasi me gjeneralitet (emër mbiemër) A.LI shfaqet si përfaqësues ligjor dhe ortak i vetëm, e konkretisht: (i) shoqëria “J” sh.p.k., me Nipt ***, dhe (ii) shoqëria “J.G.A” me Nipt **/. Rezultoi se numrat e kontaktit të paraqitur në ekstraktin historik të regjistrimit tregtar të shoqërisë “J” sh.p.k., ishin të padisponueshëm.

37.2.3. Në datën 18.10.2021, pasi u telefonua në numrin e paraqitur në ekstraktin historik të regjistrimit tregtar të shoqërisë “J.G.A” sh.p.k., u përgjigj shtetasi i identifikuar si A.LI, të cilit iu referua fakti i depozitimit të denoncimit – në dukje të bërë nga ana e tij dhe kërkesa e Komisionit për të marrë të dhëna e deklarime prej tij në cilësinë e dëshmitarit, për nevoja të hetimit administrativ që lidhen me procesin e rivlerësimit për subjektin Arben Dosti. Gjatë komunikimit telefonik, ky shtetas – i prezantuar si A.LI, mohoi të kishte dërguar denoncim ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti, dhe si rrjedhojë nuk shfaqti interes për t’u paraqitur dhe për të dhënë dëshmi para Komisionit.

37.2.4. Në vijim, në datën 19.10.2021 ky shtetas (i prezantuar si A.LI) telefonoi në numrin e institucionit dhe shprehu gadishmërinë për t’u paraqitur në ambientet e Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit dhe për të dhënë dëshminë e tij. Pasi iu komunikua se trupi gjykues për shkak të disponibilitetit, kishte vendosur më parë që ai të ftohej për të dhënë dëshminë tij në zyrat e Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit, në datën 21.10.2021, ora 15:00, z. LI konfirmoi prezencën e tij në ditën dhe orën e caktuar.

37.2.5. Në datën 21.10.2021, ora 15:00, shtetasi A.LI u paraqit në ambientet e Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit dhe dha dëshminë e tij në prani të anëtarëve të trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar.

37.2.6. I pyetur lidhur me denoncimin/ankesën e depozituar në datën 22.7.2021 nëpërmjet shërbimit postar në Komisionin e Pavaruar të Kualifikimit, i cili si dërgues mban emrin e tij dhe të studios ligjore që ai përfaqëson, z. LI deklaroi ndër të tjera se⁹⁶ *u njoh me ankesën që është bërë, por se kjo është një ankesë të cilën ai as nuk e ka bërë as nuk e ka konceptuar dhe as nuk e ka nënshkruar, pra është e falsifikuar.*

37.2.7. Në vijim të dëshmisë, i pyetur nga anëtarët e trupit gjykues dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar, z. LI deklaroi mbi mosmarrëveshjet e tij si avokat që ka pasur me subjektin e rivlerësimit – kryesisht në fillim të emërimit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, kërkesat e shumta të cilat ka bërë për përjashtimin e tij, faktin se subjekti i ka vendosur disa herë gjobë dhe se ka qenë një

⁹⁵ Ankesa nr. *** prot., datë 22.7.2021.

⁹⁶ U mbajt procesverbali për marrjen e deklarimeve të shtetasit A.LI, i datës 21.10.2021.

nga gjyqtarët që ka firmosur për heqjen e licencës së tij të avokatisë. Por, gjithashtu shprehu edhe disa konsiderata personale për aspekte pozitive të punës së tij si gjyqtar, identifikuar me çështje konkrete për të cilat deklaroi se janë gjykuar prej tij.

37.2.8. Sa më sipër, mbas verifikimit të këtij denoncimi dhe në analizë të dëshmisë së dhënë nga shtetasi A.LI, rezulton se edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një denoncues, i cili në dukje ka dashur të mbetet anonim. Si rrjedhim, në mungesë të të dhënave të besueshme mbi faktet e denoncuar, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e ngritura në këtë ankesë mbeten të paprovuara.

38. Komisioni ndërmoi hapa të tjerë hetimorë⁹⁷ për verifikimin e dyshimeve të ngritura mbi subjektin e rivlerësimit, se ka qenë i përfshirë në vepra penale apo të ketë qenë i dënuar në shtete të huaja.

39. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjet asnjë provë si edhe nuk u konstatua asnjë rrethanë, qoftë edhe në formën e ndonjë të dhëne/indicieje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, që të lidhte përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme dhe/apo të lidhej me dyshimet e ngritura nga institucionet e verifikimit për dënimin e tij me burgim në shtet të huaj.

40. Gjithashtu, në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfuara nga institucionet e verifikimit, Komisioni administroi⁹⁸ dosjet e 6 çështjeve gjyqësore penale, të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

40.1. Pas shqyrtimit dhe analizimit të këtyre dosjesve, trupi gjykues vlerëson se nuk u vërejtën indicie/të dhëna/fakte mbi bazën e të cilave do mund të vlerësohej integriteti dhe figura e subjektit të rivlerësimit.

41. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit si edhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi me forcë dyshimet e hedhura nga institucionet e verifikimit (megjithëse edhe sipas tyre të pakonfirmuara) për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme dhe dënimin me burgim në shtetin italian, duke i referuar si shpifje të qëllimta nga persona keqdashës, të cilat institucionet shtetërore nuk mund dhe nuk duhet t'i marrin për bazë.

41.1. Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit shprehu gadishmërinë e tij për t'u paraqitur në çdo moment në çdo institucion shqiptar apo ndërkombëtar, për të deklaruar dhe depozituar shenjat e gishtave, apo çdo informacion tjetër të nevojshëm, për të verifikuar dhe konfirmuar se ndaj tij nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë procedim penal, nuk është ndjekur penalisht, nuk është dënuar, dhe as ka pasur ndonjëherë masë sigurimi. Subjekti ka argumentuar se nuk e kupton si mund të jetë dënuar në shtetin italian, kur për herë të parë ai ka qenë në këtë shtet gjatë kohës që ka qenë gjyqtar. Për më tepër, arsyeton se, në kushtet kur sipas informacionit ai është dënuar për një vepër të rëndë penale, e cila në çdo vend të botës parashikon dënim të rëndë me burgim për disa vite, si është e mundur që të ketë qenë i dënuar në vitin 1998 dhe në vitin 1999 të ndodhej në Shqipëri, pasi në muajin shkurt të vitit 1999 është pajisur me pasaportë dhe në muajin prill të vitit 1999 është pajisur me vizë në Konsullatën Greke në Gjirokastrë⁹⁹.

41.2. Gjithashtu, subjekti ka parashtuar faktin se sipas Gjendjes Civile, rezulton se në Shqipëri ka 10 persona me gjeneralitet (emër/mbiemër) Arben Dosti¹⁰⁰, nga të cilët tre prej tyre, përfshirë dhe vetë ai, kanë lindur dhe banuar në Kuçovë, dhe se sipas informacioneve të marra prej tij ka rezultuar se: (i) Arben Dosti, i datëlindjes *.*1969, jeton në Itali, kurse (ii) Arben Dosti, i datëlindjes *.*.1973, jeton në Greqi.

⁹⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 8.10.2021, drejtuar Policisë së Shtetit, Zyrës Qendrore Kombëtare Interpol – Tirana; dhe shkresa nr. *** prot., datë 15.10.2021, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

⁹⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 22.2.2021 dhe shkresa “kthim përgjigjeje” e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me nr. *** prot., datë 26.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 1.3.2021).

⁹⁹ Kopje e fletës së pasaportës, ku pasqyrohet dhe viza 1-vjeçare e marrë; është depozituar si provë nga ana e subjektit.

¹⁰⁰ Ka depozituar si provë shkresën e Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative Gjirokastrë (Bashkia Gjirokastrë) me nr. *** prot., datë 10.11.2021. Nga verifikimi i të dhënave të pasqyruara në këtë shkresë, konfirmohet se janë 10 shtetas të cilët mbajnë gjeneralitet (emër/mbiemër) Arben Dosti, më i madhi në moshë i lindur në vitin 1960 dhe më i vogli i lindur në vitin 1976.

41.3. Subjekti ka sqaruar se prej muajit korrik të vitit 1992 (periudhë në të cilën ka përfunduar shkollën e mesme në qytetin e Kuçovës) e deri në maj të vitit 2002 ka qëndruar dhe punuar në shtetin e Greqisë dhe se aktivitetin e kryer gjatë qëndrimit në këtë vend e ka treguar në shpjegimet e dhëna për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Pas kthimit në Shqipëri ka qëndruar në Kuçovë, duke u marrë me aktivitet privat, vazhduar shkollën e lartë, si edhe duke u angazhuar në veprimtari politike¹⁰¹. Në këtë kontekst, ka argumentuar se ai si person ka kryer në vazhdimësi aktivitet publik në qytetin e Kuçovës, i cili nuk mund të ketë lidhje me shpifjet e hedhura për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, e aq më tepër në krimin e organizuar. Për më tepër, subjekti argumenton se pozicionet që ai ka mbajtur në partinë politike ku ka aderuar, nuk kanë qenë me emërim, por me zgjedhje nga anëtarësia, dhe si rrjedhim, në një qytet të vogël si Kuçova, nëse do të kishte kontestime apo dyshime për figurën e tij, nuk do kishte mundësi të kandidonte dhe jo më të ishte fitues¹⁰².

41.4. Në vijim të prapësimeve të tij lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti ka referuar faktin se bashkëshortja e tij në vitet 2015- 2016, ka punuar në Sektorin e Kontrollit të Brendshëm të Policisë së Burgjeve, institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, dhe se për efekt të vendit të punës dhe informacionit që kishte në dispozicion, kërkohej të pajisej me certifikatë sigurie nga DSIK-ja. Në këto kushte, ai dhe bashkëshortja (sipas kërkesave të ligjit) kanë plotësuar formularin e kërkuar nga ky autoritet dhe pas verifikimeve bashkëshortja e tij është pajisur me formularin e sigurisë, me shënimin “Për njohje me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, kategoria e certifikatës “Tepër sekret”¹⁰³.

41.5. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti depozitoi pranë sekretarisë gjyqësore prova të reja të disponuara prej tij, dokumentet si vijon: (i) kopje të dëshmisë së penaltetit për përdorim të përgjithshëm, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë e shtetit grek¹⁰⁴; dhe (ii) ekstrakt i gjendjes gjyqësore, lëshuar nga Prokuroria e Republikës pranë Gjykatës L., Itali¹⁰⁵. Referuar dëshmisë së penaltetit të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Greqi, vërtetohet se gjendja penale e subjektit të rivlerësimit, sipas të dhënave që deri më 7.11.2021 janë regjistruar në bazën e të dhënave të Sistemit të Integruar Informativ të Amzës Kombëtare Penale, është ZERO. Ndërsa, referuar ekstraktit të regjistrimit të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga Prokuroria e Republikës pranë Gjykatës L, Itali, për subjektin e rivlerësimit, vërtetohet se në bankën e të dhënave në Regjistrin e Gjendjes Gjyqësore, rezulton ASGJË.

41.6. Ndërsa, në lidhje me dyshimet e ngritura për veprimtari korruptive me avokat apo persona të tretë, ka deklaruar se asnjëherë nuk ka shpërdoruar detyrën, cenuar vendimmarrjen e tij, nisur nga asnjë lloj ndikimi, aq më tepër për interesa korruptive. Gjithashtu, ka parashtruar për çdo rast që ka konstatuar se ka elemente të veprës penale, e ka kallëzuar në prokurori¹⁰⁶, duke vënë në dukje faktin se pjesë e kallëzimeve ka qenë edhe një avokat (SH.M), i cili është duke u hetuar nga SPAK, për të cilin pretendon se premtoi dhe mori para në emrin e tij për një vendimmarrje, e cila rezultoi e ndryshme nga premtimi i avokatit dhe kërkimi i prokurorit.

¹⁰¹ Subjekti ka pasqyruar në mënyrë kronologjike të gjithë aktivitetin dhe karrierën e tij partiake (politike), pozicionet për të cilat ka konkurruar dhe ato në të cilat është zgjedhur.

¹⁰² Në mbështetje të deklarimeve të tij, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentat: referencë me nr. *** prot., datë 28.9.2021, lëshuar nga P.S. Kuçovë, nënshkruar nga kryetari, z. S.Sh; (ii) referencë e lëshuar nga z. Y.H (ish-nënkryetar i Bashkisë Kuçovë, ish-nënkryetar i Këshillit të Qarkut Berat dhe ish-kryetar i P.S Kuçovë, etj.), konfirmuar me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 18.11.2021, redaktuar nga noteri publik, znj. E. D; dhe (iii) referencë e lëshuar nga z. A.K (ish- kryetar i Bashkisë Kuçovë), konfirmuar me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 18.11.2021, redaktuar nga noteri publik, znj. E.D.

¹⁰³ Ka depozituar si prove kopje të dokumentit “Certifikatë sigurie” të lëshuar nga DSIK-ja, me nr. ***, me datë lëshimi 29.10.2015, e vlefshme deri në datën 27.10.2020.

¹⁰⁴ Dokument i apostiluar dhe i përkthyer në gjuhën shqipe, konfirmuar me vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 24.11.2021, redaktuar nga noteri publik, z. V.M.

¹⁰⁵ Kopje dokumenti, që mban vulën e Prokurorisë së L. Itali dhe nënshkruar nga funksionari gjyqësor përkatës, i cili duket se është dërguar me shërbimin postar në Shqipëri dhe në vijim është përkthyer në gjuhën shqipe dhe vulosur nga përkthyesja zyrtare, znj. M.S.

¹⁰⁶ Ka depozituar si provë kopje të kallëzimit penal të depozituar prej tij ndaj avokatit Sh.M., protokolluar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me nr. *** prot., datë 28.9.2020.

Analiza e provave të administruara në dosje dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit/vlerësimi përfundimtar i Komisionit për kriterin e kontrollit të figurës

42. Me dërgimin e rezultateve të hetimit subjektit iu bë e ditur se nga verifikimet e kryera - deri në atë fazë të hetimit, rezulton se nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

42.1. Gjithsesi, Komisioni vëren se, edhe pse në mungesë të rrethanave apo të dhënave të reja që do vinin në dyshim konkluzionin paraprak të dërguar me rezultatet e hetimit sa i përket kriterit të kontrollit të figurës, me dërgimin e prapësimeve dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit u përqendrua kryesisht në kundërshtimin e dyshimeve të ngritura në raportin e DSIK-së, që lidhen me figurën e tij.

42.2. Sikurse u konstatua më sipër, vetë organet e verifikimit kanë referuar se informacionet të cilat ngrejnë dyshime se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, mund të ketë qenë i përfshirë në vepra të rënda kriminale, nuk janë të konfirmuara. Edhe nga hetimi i kryer, nuk rezultuan të dhëna të cilat mund të ngrejnë dyshime për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në vepra penale, apo për më tepër dënimin e tij në shtet të huaj, me burgim.

42.3. Nga ana tjetër rezulton se informacioni i dërguar nga institucioni i verifikimit në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, nuk ka pasqyruar regjistrimin e ndonjë kallëzimi apo procedimi penal në ngarkim të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, në informacionin e DSIK-së nuk janë pasqyruar çështjet konkrete në të cilat dyshohet se subjekti i rivlerësimit është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, në formën e shpërdorimit të detyrës.

42.4. Vlen të theksohet këtu se, të paktën në dy raste rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë bërë kallëzim penal për ngjarje që lidhen me ushtrimin e funksionit të tij, e konkretisht në një rast ka kallëzuar ekspertët e një çështjeje, në të cilën ai ishte në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, kallëzim i cili rezulton se lidhet me rezultatet e ekspertimit të tyre dhe, në një rast, ka kallëzuar avokatin e palës së pandehur, duke hedhur dyshime se ai ka premtuar dhe marrë para në emrin e tij.

42.5. Sa më sipër, nga analizimi në tërësi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, provave të administruara gjatë hetimit administrativ, si edhe ato të depozituara me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe gjatë seancës dëgjimore, Komisioni arrin në përfundimin se për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosti:

- 1.Nuk provohet ekzistenca e ndonjë mase sigurimi apo dënimi penal në shtet të huaj;
- 2.Nuk provohen dyshimet e ngritura për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme;
- 3.Nuk provohet ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme.

42.6. Si rrjedhim, Komisioni i qëndron konstatimit fillestar se për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosti, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

43. Si përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor¹⁰⁷

¹⁰⁷ Raporti për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Arben Dosti, me nr. *** prot., datë 23.10.2020.

44. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

44.1. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të ish-KLD-së.

44.2. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësi profesionale; (b) aftësi organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësi personale dhe angazhimi profesional.

44.3. Referuar këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, ka njohuri të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, duke shfaqur aftësi në arsyetimin ligjor. Ai është është eficient dhe i aftë për të përballuar ngarkesën në punë dhe në kryerjen e veprimtarisë gjyqësore, duke qenë efektiv në përfundimin në kohë të gjykimeve. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjithashtu, nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

44.4. Gjithsesi, në raportin e vlerësimit të përpiluar nga KLGJ-ja janë listuar disa gjetje lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, për aspekte të veçanta të gjykimit për dosje të ndryshme të vëzhguara, nga ku Komisioni konstaton gjetjet si vijon: (i) në dy vendime penale nuk është shprehur për shuarjen e masës së sigurimit ndaj të pandehurit; (ii) në një gjykim civil në fazën përgatitore të çështjes, nuk ka marrë vendim për zhvillimin në mungesë të gjykimit të palës së paditur.

44.5. Subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me gjetjet e konstatuara nga raporti i KLGJ-së. Subjekti dërgoi prapësimet e tij të shoqëruara me shpjegimet përkatëse. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse mbi gjetjet e konstatuara në raportin e KLGJ-së, ku nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të mjaftojnë për të mbërritur në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësi profesionale.

Rivlerësimi i aftësi profesionale i kryer nga Komisioni

45. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; (iii) kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

45.1. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të ish-KLD-së.

45.2. Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësi profesionale të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënave nga burimet arkivore, si edhe në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit - për gjetjet e listuara në këtë raport, Komisioni çmon se nuk konstatohen problematika thelbësore lidhur me vlerësimin e kriterit profesional.

45.3. Në vlerësimin e subjektit, z. Arben Dosti, u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 15 denoncime të tjera të depozituara nga publiku në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, nga verifikimi paraprak i të cilave vërehet se 14 prej tyre lidhen me çështje të gjykuara prej tij, ndërsa 1

prej tyre hedh dyshime për shkelje të etikës, por se nuk lidhet me dosje konkrete të gjykuar nga gjyqtari Dosti.

Denoncimi i shtetasit S.Q¹⁰⁸

46. Nga verifikimi i kësaj ankese, denoncuesi ngre pretendime lidhur me vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, për rrëzimin e kërkesës së tij për kundërshtimin e vendimit të prokurorisë për mosfillimin e hetimeve të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2015.

46.1. Referuar të dhënave të paraqitura në këtë ankesë dhe atyre të pasqyruara në vendimin¹⁰⁹ e gjyqtarit Dosti të datës 3.5.2016, rezulton se denoncuesi ka bërë kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke ngritur pretendime lidhur me disa rrethana të ndryshme dhe/apo për falsifikime të kryera në procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij, për të cilat referon se kanë ndikuar pa të drejtë në dënimin e dhënë ndaj tij me 25 vjet burg, sipas vendimit nr. ***, datë 7.1.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tepelenë.

46.2. Pasi Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur mosfillimin e hetimeve lidhur me kallëzimin e bërë, denoncuesi e ka kundërshtuar këtë vendim në Gjykatë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e përbërë nga gjyqtari Arben Dosti, pasi shqyrtoi pretendimet e ankuesit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij.

46.3. Gjithashtu, rezulton se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi S.Q. Gjykata e Apelit Gjyqësor Gjirokastrë në datën 12.10.2016, ka vendosur¹¹⁰ lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

46.4. Siç u konstatua edhe më sipër, rezulton se ky shtetas ka bërë edhe kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit, i cili duket se lidhet me vendimmarrjen që i përket çështjes së denoncuar, bazuar në të cilin Prokuroria për Krime të Rënda, në datën 16.1.2020, ka regjistruar materialin kallëzues nr.***. Rezultoi se, pas verifikimeve të kryera mbi pretendimet e ngritura në kallëzim, nga prokurori i çështjes është vlerësuar se ekzistojnë rrethanat për të vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke disponuar në datën 29.1.2020 me vendim mosfillimi, vendim i cili duket se nuk është ankimuar nga kallëzuesi.

46.5. Na shqyrtimi dhe analizimi i këtij denoncimi dhe materialeve të administruara që lidhen me të, Komisioni nuk vëren fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektit e rivlerësimit, gjyqtarin Arben Dosti.

Denoncimi i shtetasës Y.Sh. (Xh)¹¹¹

47. Denoncuesja ngre pretendime se gjyqtari Arben Dosti, në shkelje të ligjit, ka vendosur lirim me kusht të një të dënuari (ish-bashkëshortit), dënuar për “Dhunë në familje” dhe për “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”.

47.1. Komisioni administroi dosjen gjyqësore¹¹² që i përket çështjes penale për të cilën është dhënë vendimi nr. ***, datë 27.12.2016, me kërkues shtetasin E.Xh, me objekt “Lirim me kusht”.

47.2. Nga verifikimi i kësaj dosje rezulton se me vendimin nr. ***, datë 23.6.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, shtetasi E.Xh. është deklaruar fajtor për veprën penale “Dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a paragrafi i 4 i Kodit Penal dhe është dënuar me 18 muaj burgim. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Gjyqësor Gjirokastrë, duke e dënuar shtetasin E.Xh me 12 muaj burgim. Gjithashtu, ka rezultuar se me vendimin nr. ***, datë 19.12.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka deklaruar fajtor shtetasin E.Xh për veprën penale “Prodhim dhe

¹⁰⁸ Ankesa nr. *** prot., datë 30.11.2017.

¹⁰⁹ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me nr. ***, datë 3.5.2016, për rrëzimin e kërkesës për kundërshtimin e vendimit të prokurorisë për mosfillimin e hetimeve të kallëzimit penal nr. ***, të vitit 2015 (depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit).

¹¹⁰ Vendimi i Gjykatës së Apelit Gjyqësor Gjirokastrë me nr. ***, datë 12.10.2016.

¹¹¹ Ankesa nr. *** prot., datë 1.12.2017.

¹¹² Shkresa nr. *** prot., datë 14.9.2021 e dërguar nga Komisioni dhe shkresa “kthim përgjigjeje” me nr. *** prot., datë 28.9.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, duke e dënuar me 8 muaj burgim. Me vendimin nr. ***, datë 5.2.215, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka kryer bashkimin e dënimeve të mësipërme, duke caktuar ndaj shtetasit E.Xh një dënim të vetëm prej 13 muajsh burgim.

47.3. Duke pretenduar se plotëson kriteret e nenit 64 të Kodit Penal, shtetasi E.Xh ka paraqitur kërkesë në gjykatë për lirimin me kusht, e cila është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit.

47.4. Në datën 27.12.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë – e përbërë nga gjyqtari i vetëm Arben Dosti, ka vendosur: (i) pranimin e kërkesës së të dënuarit E.Xh; (ii) bazuar në nenin 64 të Kodit Penal lirimin e të dënuarit E.Xh, duke urdhëruar pezullimin e pjesës së mbetur pa vuajtur prej 52 ditësh burgim dhe vënien në provë për një periudhë prej 52 ditësh.

47.5. Por rezulton se prokurori i çështjes (i seancës) ka parashtruar se kërkuesi, E.Xh, ka dy dënime penale të kryera për vepra penale me dashje, duke e konsideruar atë përsëritës, dhe si rrjedhojë pretendon se ai nuk plotëson një nga kushtet (të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative), për aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal dhe lirimin me kusht të kërkuesit, të dënuarit E.Xh.

47.6. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjekti të japi shpjegimet e tij shteruese dhe të argumentojë mbi përmbushjen/plotësimin e kriterëve për aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal, dhe si rrjedhojë disponimin me vendim për lirimin me kusht të kërkuesit E.Xh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi këtë denoncim

48. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, ka parashtruar se, referuar vendimeve të dhëna ndaj shtetasit E.Xh (të pasqyruara si më sipër), konstatohet se gjatë së njëjtës periudhë ndaj tij janë dhënë dy dënime penale, të cilat janë bashkuar në një dënim të vetëm nga gjykata. Gjatë periudhës së gjykimeve të mësipërme, ky shtetas ka qenë në gjendje të lirë dhe është ndaluar për efekt të vuajtjes së dënimit penal në datën 18.1.2016. Referuar akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore, rezulton se IEPV Tepelenë në raportet e dërguara ka vlerësim pozitiv për sjelljen e këtij shtetasi gjatë kohës së vuajtjes së dënimit. Në raportin e Shërbimit të Provës Gjirokastrë janë vlerësuar një sërë rrethanash si gjendja shëndetësore, gjendja e vështirë ekonomike, mospasjen e ndihmës së familjes për integrim, si edhe mungesa e interesit për të zgjidhur mosmarrëveshjet në familje. Në këtë kuptim, subjekti shpjegon se në vendimin e tij ka marrë në konsideratë edhe faktin që marrëdhëniet në familje mes të dënuarit dhe bashkëshortes së tij ishin mbaruar përfundimisht, kjo për shkak të mosmarrëveshjeve, dënimit penal të personit, si edhe faktit të zgjidhjes së martesës mes tyre. Gjithashtu, ka marrë në konsideratë edhe gjendjen shëndetësore të të dënuarit. Diskutimi i vetëm që u ngrit gjatë gjykimit ishte ai i faktit nëse i dënuari do të konsiderohej përsëritës dhe si pasojë nuk mund të përfitonte nga e drejta për lirim me kusht, apo do të konsiderohej i padënuar më parë.

48.1. Subjekti ka argumentuar se në arsyetimin e vendimit është shprehur për pretendimin e prokurorit të seancës se kërkuesi ka dy dënime penale për vepra penale të kryera me dashje dhe, si pasojë konsiderohet përsëritës, duke e vlerësuar si pretendim i cili nuk është i bazuar dhe për këtë arsye nuk e ka marrë në konsideratë.

48.1.1. Në vendimin e dhënë, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se *kërkuesi ka dy dënime penale dhënë njëri pas tjetrit, për të cilat organi i akuzës ka kërkuar bashkimin e tyre në gjykatë. Kërkuesi ka filluar vuajtjen e dënimit pas dhënies së vendimit për bashkim dënimesh. Rezulton se në bashkim të dënimeve, ndaj kërkuesit është caktuar një dënim i ri të cilin kërkuesi po e ekzekuton. Gjykata çmon se në rastin në shqyrtim ndodhemi në të njëjtat kushte kur në të njëjtin gjykim ndaj të pandehurit jep dy dënime për vepra penale të ndryshme dhe bën bashkimin e tyre në një të vetëm, neni 55 i K.Penal. Në kushtet kur kemi dy dënime të bashkuar në një, nuk mund të themi që kërkuesi po kryen njërin nga dënimet dhe është përsëritës për tjetrin, pasi ai po kryen një dënim të vetëm të dhënë me vendim gjykatë. Vendimi i gjykatës për bashkimin e dënimeve nuk është një vendim vetëm për efekt ekzekutimi të vendimeve, dhënë më parë. Në këtë vendim është caktuar një dënim i ri, i vetëm për t'u vuajtur, i cili nuk është shumatorë e vendimeve të mëparshme... Qëllimi i nenit 64 të K.Penal është që personave t'u jepet një mundësi rehabilitimi dhe risocializimi. Në rast se dënohen përsëri, që do të thotë që procesi i rehabilitimit ka dështuar, legjislatori ka vendosur si kusht mospërfitimin nga neni 64. Në*

rastin në shqyrtim nuk rezulton që kërkuesi të ketë vuajtur më parë një dënim penal dhe të mos jetë rehabilituar, duke treguar kështu rrezikshmëri të personit...Gjithashtu në gjykim përfaqësuesi i IEVP Tepelenë u shpreh se kërkuesi E.Xh nuk ka përfitur nga amnistia e vitit 2015, pasi kishte për të vuajtur 13 muaj burgim, ndërkohë që amnistia përfshinte vetëm ata persona që kishin më pak se 12 muaj burgim për të vuajtur. Në rast se do konsideroheshin si dënime të kërkuesit dy vendimet e para, pa u konsideruar si i tillë vendimi i bashkimit të dënimeve, kërkuesi duhet të përfitonte nga amnistia dhe do ishte liruar nga burgu që në fillim të vitit 2016.

48.2. Në vijim të prapësimeve të tij, subjekti ka parashtruar se qëllimi i dënimit penal nuk është ndëshkimi, por rehabilitimi, risocializimi i personave në shoqëri dhe se për këtë arsye është parashikuar mundësia ligjore, për shkak të plotësisimit të disa kushteve të parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal. Subjekti ka argumentuar se vendimmarrjen e tij e ka marrë edhe bazuar në interpretimin e bërë kësaj dispozite në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. ***, datë 25.5.2015. Subjekti ka referuar se orientimet e Gjykatës së Lartë janë mbajtur në konsideratë prej tij në shqyrtimin e kërkesës së të dënuarit E.Xh.

48.2.1. Në këtë kontekst, ai argumenton se ashtu siç është shprehur edhe Gjykata e Lartë, masa e dënimit penal është në vetvete një “parashikim” nga ana e gjykatës i kohës që konsiderohet e mjaftueshme për të arritur në riedukimin e të dënuarit, në raport kjo me rrezikshmërinë e veprës së kryer dhe të autorit të saj. Kjo kohë e mjaftueshme, nund të jetë e ndryshme për persona të ndryshëm; dhe pikërisht për këtë arsye ligjvënësi ka parashikuar mundësinë e lirimit me kusht për këtë kategori të dënuarish, të cilët, pasi kanë vuajtur një pjesë të konsiderueshme të dënimit të dhënë, janë riedukuar plotësisht dhe nuk ekziston më nevoja për t’i mbajtur në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Nëse personi është i dënuar më parë dhe kryen një vepër penale, do të thotë që ky person paraqet rrezikshmëri shoqërore, pamundësi rehabilitimi dhe si pasojë nuk mund të jetë subjekt i lehtësirave penale. Në këtë kuadër, subjekti argumenton se konsiderohet përsëritës në kuptim të nenit 64 të Kodit Penal, një person i cili është dënuar me një vendim penal, ka vuajtur dënimin penal dhe më pas kryen një vepër tjetër penale me dashje. Për këtë person procesi risocializues ka dështuar dhe në këto kushte, nuk është subjekt i lehtësirave penale. Nga ana tjetër, nëse një person në një gjykim dënohet për dy ose më shumë vepra penale, atëherë ky person nuk mund të quhet përsëritës, pasi ndaj tij nuk ka pasur më parë periudhë rehabilitimi/risocializimi. I njëjti arsyetim vlen edhe kur një person dënohet me dy vendime penale të ndryshme, me trupa gjykues të ndryshëm, për të cilat si në rastin më sipër, kryhet bashkimi i dënimeve dhe periudha e vuajtjes së dënimit, pra risocializimit, është e njëjtë. Në përfundim, subjekti ka arsyetuar se nëse personi nuk ka kryer më parë një periudhë rehabilitimi/risocializimi, atëherë ky person nuk mund të konsiderohet përsëritës në kuptim të nenit 64 të Kodit Penal, duke i qëndruar plotësisht vendimmarrjes dhe arsyetimit të dhënë prej tij në vendimin nr. ***, datë 27.12.2016, për lirimin me kusht të dënuarit E.Xh.

Vlerësimi i Komisionit

49. Nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me të si edhe provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, Komisioni nuk vërejtí problematika në vendimmarrjen e subjektit për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit lidhur me këtë denoncim janë bindëse dhe se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektin e rivlerësimit, gjyqtarin Arben Dosti.

Denoncimi i shtetasës F.LI¹¹³

50. Denoncuesja ngre pretendimin se subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar një gjykim të njëanshëm dhe të padrejtë, dhe se në vendimin përfundimtar ajo nuk përmendet fare si ndërhyrëse dytësore.

¹¹³ Ankesa nr. *** prot., datë 9.5.2018.

50.1. Gjithashtu, denoncuesja pretendon se ky gjyqtar në vendimin e dhënë nuk ka marrë parasysh shkeljet ligjore dhe falsifikimet e konstatuara për paditësin nga KLSH-ja, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë si edhe institucione të tjera.

50.2. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni¹¹⁴ për administrimin e dosjes gjyqësore që lidhet me çështjen e denoncuar nga shtetasja F.Ll, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë¹¹⁵ informon se kjo dosje ndodhet për shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë, duke na vënë në dispozicion kopje të vendimit civil me nr. ***, datë 7.3.2017, i cili disponohej prej tyre. Rezulton se ky vendim është dhënë nga gjyqtari Dosti dhe rezulton se në të është shënuar si palë ndërgjyqëse – person i tretë, shtetasja F.Ll.

50.3. Në vijim, Komisioni administroi dosjen e plotë gjyqësore që i përket çështjes objekt denoncimi¹¹⁶. Nga verifikimi i kësaj dosjeje, kemi të bëjmë me një çështje civile komplekse, për të cilën ka pasur disa procese gjyqësore dhe vendime të dhëna nga gjykatat, që lidhen me të (Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjykata Administrave e Shkallës së Parë dhe ato të Apelit).

50.4. Konstatohet se denoncuesja – shtetasja F.Ll ka bërë kërkesë për ndërhyrje kryesore si paditëse në çështjen që po shqyrtonte gjyqtari Dosti, kërkesë e cila duket se është refuzuar prej tij. Madje, për këtë shkak, por edhe për shkaqe të tjera të pretenduara prej saj- denoncuesja ka bërë kërkesë për përjashtimin nga gjykimi të këtij gjyqtari. Gjithashtu, rezulton se kjo shtetase ka bërë kërkesa edhe për të ndërhyrë dytësisht në procesin me palë paditëse, Ç.Sh, dhe të paditur, shoqërinë “***” sh.p.k.

50.5. Rezulton se për çështjen me paditës: Ç.Sh, të paditur: shoqërinë tregtare “***” sh.p.k., person i tretë: F.Ll, me objekt: “Lirim dhe dorëzimi bashkëpronarëve të pasurisë, truallit të zënë nga vendosja e tabelës së reklamave sipas kontratës së palës ndërgjyqëse. Detyrimin e të paditurit t’i paguajë paditësit dhe bashkëpronarëve të tij shpërblimin për përdorimin e sendit nga data 29.4.2014 e deri në ditën e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë – në përbërje të së cilës ishte gjyqtari Arben Dosti, ka vendosur (vendimi nr. *** datë 7.3.2017): (i) pranimin e padisë; (ii) detyrimin e të paditurit shoqërisë “***” sh.p.k., të lirojë dhe dorëzojë paditësit pasurinë; (iii) detyrimin e të paditurit t’i paguajë paditësit shumën prej 171,150 lekësh, si shpërblim për përdorimin e sendit në pronësi të paditësit, nga data 29.4.2014 deri 7.3.2017; (iv) detyrimin e të paditurit t’i paguajë paditësit shumën prej 164.3 lekësh për çdo ditë vonesë në ekzekutimin e vendimit, llogaritur që nga data 8.3.2017.

50.6. Mbi ankimin e bërë nga palët në këtë proces, çështja u gjykua në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, e cila me vendimin e saj gjyqësor me nr. ***, datë 3.5.2017, vendosi: “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 7.3.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me trup tjetër gjykues...”

50.7. Gjykata e Apelit ka konstatuar se në gjykim ka pasur shkelje procedurale, e konkretisht nuk ishte zgjidhur mirë pozita procedurale e palës F.Ll, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe karakterin detyrues të konkludimeve të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. ***, datë 21.9.2016 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, që ka ndryshuar vendimin gjyqësor të datës 17.6.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke vendosur: pranimin e kërkesës së F.Ll për të ndërhyrë si person i tretë në këtë gjykim. Gjithashtu, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se nga Gjykata e Shkallës së Parë duhej të ishte bërë një hetim i gjithanshëm dhe i plotë i çështjes dhe në varësi të pretendimeve të palëve; duhej të thërriste një inxhinier topograf, i cili referuar akteve në dosje, si edhe gjendjes faktike në terren të kryente rishtazi një aktekspertimi, ku të përcaktohej vendndodhja e pronave respektive të paditësit dhe znj. Fatbardha Lluka; të përcaktohej nëse ka mbivendosje ndërmjet tyre, si edhe në cilën pronë është vendosur tabela reklamuese e palës së paditur.

50.8. Sa më sipër, rezulton se në gjykimin e kësaj çështjeje, subjekti i rivlerësimit nuk ka zgjidhur drejt pozitën procedurale të shtetases F.Ll, si edhe nuk ka kryer hetim të plotë gjyqësor.

¹¹⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 14.9.2021.

¹¹⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 28.9.2021.

¹¹⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 23.9.2021 e dërguar nga Komisioni dhe shkresa “kthim përgjigjeje” e Gjykatës së Lartë me nr. *** prot., datë 6.10.2021.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi këtë denoncim

51. Nëpërmjet prapësimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se vendimi nr. ***, datë 7.3.2017, për të cilën ka ankesa znj. F.Ll, është i drejtë, i mirëarsyetuar dhe se në çdo rrethanë të njëjtë do të kishte të njëjtin arsyetim dhe vendimmarrje, pavarësisht se ky vendim është prishur dhe çështja është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë.

51.1. Në këtë vendim, shpjegon subjekti, ka arsyetuar pozitën procedurale të personit të tretë në një gjykim civil, dallimin midis ndërhyrësit kryesor dhe ndërhyrësit dytësor, formën e paraqitjes së kërtimeve nga ndërhyrësi kryesor dhe të prapësimeve nga ndërhyrësi dytësor. Konkretisht, në gjykim ishte duke u shqyrtuar padia e pronarit Ç.Sh (bashkëpronar) kundër të paditurit shoqëria “****” sh.p.k., me objekt: “Lirim dhe dorëzim të pasurisë nr. ***, trualli të zënë nga vendosja e tabelës së reklamave”. Znj. F.Ll ka bërë kërkesë për ndërhyrës kryesor në gjykim, duke pretenduar se trualli në të cilën ishte vendosur tabela e reklamës ishte në pronësi të saj dhe jo të z. Ç.Sh e të tjerë. Kërkesa për ndërhyrës kryesor është pranuar nga gjykata, duke u zbatuar kështu urdhërimi i Gjykatës së Apelit që kërkuesja, F.Ll, të pranohej si person i tretë në gjykim. Bazuar në nenin 189 të K.Pr.Civile, ndërhyrësja kryesore, F.Ll, ka paraqitur padi dhe ka pretenduar pronësinë mbi truallin mbi të cilin ishte vendosur tabela e reklamës, duke kontestuar vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili kishte njohur pronar paditësin.

51.2. Në vijim të parashtrimeve të tij, subjekti ka argumentur se padia e paraqitur nga ndërhyrësi kryesor duhet të plotësojë të gjitha kushtet e kriteret e treguara në nenet 154-156 të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë kontekst, ka vlerësuar se në kushtet kur ndërhyrësi kryesor në padinë e tij godiste vlefshmërinë e vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave dhe të drejtën e pronësisë së të gjithë bashkëpronarëve, atëherë në gjykim duhet të thirreshin të gjithë bashkëpronarët, të cilët në eventualitetin e pranimit të kësaj padie, u cenohej dhe hiqej e drejta e pronësisë. Nëse nuk do të ishin thirrur në gjykim, do ishte shkelje e rëndë procedurale, siç me të drejtë ka ecur praktika gjyqësore. Ndërhyrësi kryesor edhe me ndihmën e gjykatës që është investuar në marrjen e informacionit nga Zyra e Gjendjes Civile, ka arritur të identifikojë trashëgimtarët e ish-pronarit, të cilët aktualisht ishin pronar të pronës në konflikt. Gjatë procedurës së njoftimit, është konstatuar se disa prej tyre kishin ndërruar jetë. Në këto kushte, gjykimi nuk mund të zhvillohej me persona të vdekur dhe ka orientuar palën paditëse (ndërhyrësin kryesor) që të thërriste në gjykim trashëgimtarët e pronarëve të vdekur. Verifikimi i tyre do të kryhej nëpërmjet paraqitjes në gjykim të dëshmive të trashëgimisë që nxirren nga noteri dhe jo nga gjykata, pasi gjykata nuk mund të marrë përsipër dhe të kryejë lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, kur ky proces ligjor i është njohur noterit publik. Por, sipas subjektit, ndërhyrësi kryesor nuk e ka kryer një veprim të tillë dhe është përpjekur me formalitete rregullimi të objektit të padisë, por që në thelb mbetej kundërshtimi i të drejtës së pronësisë të paditësit Çajup Shehu dhe bashkëpronarëve të tjerë. Ndërhyrësi kryesor, është orientuar nga gjykata, se në kushtet kur në gjykim nuk do të thërriteshin të gjithë bashkëpronarët që kishin fituar me vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave, padia do të konsiderohej me të meta dhe kështu ka ndodhur, por, edhe pse iu la kohë për plotësimin e të metave të konstatuara nga gjykata (sipas parashikimit të bërë në nenin 154/a të K.Pr.Civile), ato nuk janë plotësuar dhe në këto kushte është vendosur kthimi i padisë së ndërhyrësit kryesor pa veprim, si edhe revokimi i vendimit për pranimin e tij në cilësinë e ndërhyrësit kryesor.

51.3. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se pas kësaj vendimmarrjeje, znj. F.Ll ka bërë kërkesë për të ndërhyrë në gjykim si ndërhyrës dytësor, sipas nenit 191 të K.Pr.Civile, kërkesë të cilën e ka pranuar duke sqaruar ndërhyrësin dytësor se pozita e tij procedurale është në ndihmë të të paditurit, shoqërisë “****” sh.p.k., në lidhje me përmbushjen e detyrimeve që ajo kishte me paditësin Ç.Sh dhe bashkëpronarët e tjerë dhe se nuk mund të ngrinte pretendime pronësie të sajat mbi sendin ose mbi ligjshmërinë e vendimmarrjes së Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për paditësin, siç mund të ngrinte në cilësinë e ndërhyrësit kryesor.

51.4. Në këto kushte, arsyeton subjekti, ka vazhduar gjykimin dhe ka konstatuar mospërmbushje të detyrimeve kontraktore të shoqërisë “****” sh.p.k., ndaj paditësit dhe bashkëpronarëve të tjerë, sipas kontratës së lidhur midis tyre.

51.5. Siç e ka referuar edhe në vendim e dhënë, Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 28.5.2015 ka arsyetuar se: “...Kolegji Civil vlerëson të theksojë se, ndryshe nga rasti i konstatimit të pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, i cili në zbatim të Vendimit Unifikues nr. 5, datë 30.10.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mund të kryhet edhe kryesisht nga gjykata, konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një vendimi të ish K.K.K.Pronave, qoftë edhe përgjatë argumentimit të një vendimi gjyqësor, mund të bëhet vetëm me kërkesë të palëve, e në rastin konkret vetëm nëpërmjet ngritjes në të njëjtin gjykim të një kundërpadie me këtë efekt nga ana e palës së paditur, apo me anë të paraqitjes së një padie të posaçme në një gjykim të ndryshëm për këtë qëllim”. Pra, sa më sipër, ai ka argumentuar se znj. F.LI, mund të kundërshtonte të drejtën e pronësisë së paditësit Ç.Sh dhe bashkëpronarëve të tjerë, vetëm nëpërmjet paraqitjes së një padie ose kundërpadie. Kundërpadi nuk mund të ngrinte, pasi nuk ishte e paditur në gjykimin e iniciuar nga paditësi Ç.Sh, por se mund të ngrinte vetëm padi, të cilën mund ta paraqiste duke iniciuar një proces gjyqësor tjetër kundër Ç.Sh dhe bashkëpronarëve të tjerë ose duke u futur si ndërhyrës kryesor në gjykimin që po zhvillohej, ashtu siç ka kërkuar dhe pranuar gjykata. Por, paraqitja e padisë ka një sërë detyrimesh që duhet të përmbushen, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 154 të K.Pr.Civile, të cilat kjo palë ka dështuar t’i realizojë dhe në këto kushte ka dështuar edhe qëllimi i futjes së saj si ndërhyrës kryesor në gjykim.

51.6. Subjekti ka sqaruar se vërtet vendimmarrja e tij është prishur nga Gjykata e Apelit, e cila ka kthyer çështjen për rigjykim, por ka rezultuar se rigjykimi është zhvilluar me të njëjtat palë, po me ndërhyrës dytësor dhe jo kryesor, znj. F.LI, dhe është pothuajse kopje e vendimit të tij, me të njëjtin arsyetim dhe vendimmarrje (ndryshon masa e shpërblimit, pasi ndryshon koha e gjykimit). Në këto kushte, shprehet se është vendimmarrja e Gjykatës së Lartë që do të ndajë dhe shpjegojë anën procedurale të gjykimit, për sa kohë rezulton se pretendimet për pronësi të personit të tretë, znj. Fatbardha Luka, nuk janë marrë parasysht edhe nga gjykatat e tjera.

Vlerësimi i Komisionit

52. Nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me të, si edhe provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, Komisioni nuk vërejtí problematika në vendimmarrjen e subjektit për gjetje thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit lidhur me këtë denoncim janë bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion provues dhe si rrjedhim arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektit e rivlerësimit, gjyqtarin Arben Dosti.

Denoncimi i shoqërisë “**” sh.a¹¹⁷**

53. Nëpërmjet këtij denoncimi, shoqëria “****” sh.a., ankohet mbi procese gjyqësore me objekt “shpërblim dëmi”, kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe persona të tretë shoqëritë e sigurimit.

53.1. Shoqëria “****” sh.a., pretendon se këto gjykime kanë rezultuar të gjitha, jo vetëm me përgjegjësi të OSHEE – edhe në ato raste kur përgjegjësia ka qenë haptazi e të dëmtuarve, por edhe vlerat e dëmshpërblimit të akorduara nga gjykatat, janë shuma marramendëse. Sipas saj, shumat e këtyre përmasave lënë shkak për dyshime të forta për skema joligjore dhe korruptive nga të gjitha aktorët e përfshirë në këto procese.

53.2. Për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosti, kjo shoqëri ankohet për vendimin e dhënë prej tij në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër (vendimi nr. ***, datë 30.7.2018) - që lidhet me çështjen me palë ndërgjyqëse: B.B etj., kundër OSHEE, dhe “****” sh.p.k., me objekt “Shpërblim dëmi”.

53.3. Nga shqyrtimi i këtij denoncimi rezulton ankimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është gjykata e shkallës më të lartë dhe në kushte të tilla, trajtimi i këtij denoncimi nuk është në kompetencë të Komisionit. Gjithashtu, nuk janë konstatuar indicie apo të dhëna për të

¹¹⁷ Ankesa nr. *** prot., datë 15.10.2018.

provuar pretendimet e denoncuesit për gjetje që do ndikonin në vlerësimin e e figurës së subjektit të rivlerësimit.

Denoncimi i shtetasës E.L¹¹⁸

54. Nga verifikimi i kësaj ankese rezulton se shtetasja E.L, gjykuar dhe dënuar për veprën penale të “Mashtrimit me pasoja të rënda”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, hedh dyshime se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë – pjesë e së cilës ka qenë dhe gjyqtari Arben Dosti, ka treguar njëanshmëri duke mbajtur anën e kallëzuesit dhe se ka marrë vendim e ndikuar nga veprime korruptive, duke pretenduar se ka qenë ajo që ka kallëzuar skemën e mashtrimit. Denoncuesja referon se vendimi i marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe se gjithashtu ajo ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

54.1. Pasi shqyrtoi këtë denoncim dhe materialet shkresore që lidhen me të, Komisioni nuk vëren fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe për figurën e subjektin e rivlerësimit, gjyqtarin Arben Dosti.

Denoncimi i shtetasit K.M¹¹⁹

55. Nga verifikimi i kësaj ankese, denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, së bashku me dy gjyqtarë të tjerë, në cilësinë e anëtarëve të trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka marrë vendim të padrejtë lidhur me një çështje pronësie, pasi janë ndikuar nga veprime korruptive. Denoncuesi pretendon se këta gjyqtarë kanë bërë ndarjen e pronës pa dijeninë e pronarit, kanë pranuar padi jashtë afatit, kanë njohur dhe kthyer prona në bashkëpronësi pa pasur dijeni personi vet, kanë bërë vetë akte ekspertimi dhe kanë detyruar Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë të kompensojnë me lekë pronarët me letra false.

55.1. Në shpjegimet e tij të dhëna (nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit) lidhur me pretendimet e ngritura në këtë ankesë, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se për të njëjtin fakt të pretenduar prej denoncuesit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal”¹²⁰. Subjekti ka deklaruar se i qëndron plotësisht vendimmarrjes, pasi sipas tij vendimi është absolutisht i mirëarsyetuar, duke i dhënë përgjigje çdo pretendimi dhe prapësimi të palëve në gjykim, duke u shqyrtuar pretendimet në raport me provat e paraqitura.

55.2. Nga shqyrtimi i këtij denoncimi, si edhe në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni konstaton se nuk ka indicie për të provuar pretendimet e këtij denoncuesi për gjetje që do ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe/apo figurën e subjektit të rivlerësimit.

Denoncimi i *-, përfaqësuar nga z. N.M¹²¹**

56. Nëpërmjet këtij denoncimi, pretendohet se vendimi i ndërmjetëm i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë - me relator z. Arben Dosti, i datës 18.1.2019, që i përket çështjes civile me kërkuar M.D dhe D.M, me objekt: “1- Kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit. 2- Marrjen e masës së sigurimit të padisë...”, është marrë në shkelje flagrante dhe abuzive me dispozitat ligjore, duke mos u zbatuar dhe shkelur haptazi Kodi i Procedurës Civile, e konkretisht:

56.1. Së pari, vendimi i ndërmjetëm i gjykatës për marrjen e masës së pezullimit – sipas nenit 203 të K.Pr.Civile, sigurimi i padisë nuk lejohet në rastet e padisë që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit.

56.2. Së dyti, masa e pezullimit bie në kundërshtim dhe me përcaktimet e Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 10/2004, në të cilin ndër të tjera përcaktohet se *masa e sigurimit nuk mund të merret për të rivendosur gjendjen e mëparshme, ashtu siç ka ekzistuar para lindjes së mosmarrëveshjes.*

¹¹⁸ Ankesa nr. *** prot., datë 16.11.2018.

¹¹⁹ Ankesa nr. *** prot., datë 24.12.2018.

¹²⁰ Konstatuar ky rast edhe nga Komisioni, në kuadër të vlerësimit të kriterit të kontrollit të figurës.

¹²¹ Ankesa nr. *** prot., datë 25.1.2019.

56.3. Së treti, referuar nenit 202 (paragrafi “b”) të Kodit të Procedurës Civile, në rast të kërkesës për të marrë sigurimin e padisë, paditësi duhet të depozitojë garanci pasurore, gjë e cila sipas denoncuesit nuk ka ndodhur.

56.4. Së katërti, kushtet e nevojshme për të kërkuar marrjen e masës së sigurimit dhe pezullimin e ekzekutimit janë: (i) ekzistenca e mundshme e një të drejte, për të cilën kërkohet mbrojtje në procesin gjyqësor të filluar gjatë ekzekutimit, pra nëse ka pritshmëri për goditjen e titullit apo veprimeve përmbartimore; dhe (ii) pasja e dyshimit se ekziston frika që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do bëhet i pamundur ose i vështirë.

56.5. Komisioni administroi dosjen e plotë gjyqësore që lidhet me çështjen objekt ankimi¹²².

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi këtë denoncim

57. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se i qëndron plotësisht vendimmarrjes së tij, që në vlerësimin e tij nuk ka asnjë mangësi si në arsyetim, ashtu dhe në zbatim të dispozitave ligjore, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

i. Në lidhje me pikën e parë të cituar nga ankuesit, se sigurimi i padisë nuk lejohet në rastet e padisë që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, neni 610 i K.Pr.Civile e rrëzon këtë pretendim. Në këtë fazë mund të vendoset pezullimi, por me afat maksimal 20 ditë, siç edhe ka vendosur.

ii. Në lidhje me pretendimin se masa e sigurimit bie në kundërshtim me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 10/2004, sqaron se vendimmarrja e tij s’ka asnjë lidhje dhe nuk bie ndesh me urdhërimet unifikuese. Në rastin që ka shqyrtuar, nuk po rivendikohej një gjendje e kaluar, por po ndalohej vijimi i procedurës përmbartimore, derisa veprimi përmbartimor i kundërshtuar të verifikohet nga gjykata. Nëse nuk do ishte vendosur masë sigurimi, atëherë procedura përmbartimore do vazhdonte, sendi potencialisht mund të ishte shitur në ankand dhe çështja do ishte akoma më e ngatërruar, duke hyrë në konflikt dhe persona të tretë, blerës të mundshëm. Ligji procedural gjatë fazës përmbartimore, për çdo veprim përmbartimor ka parashikuar të drejtën e debitorit për ankim në gjykatë, si edhe të drejtën e gjykatës për të pezulluar procedurën përmbartimore deri në përfundim të shqyrtimit të ankimit ndaj veprimit përmbartimor.

iii. Ndërsa lidhur me pretendimin se përse nuk u vendos garanci pasurore, duke referuar nenin 202 të K.Pr.Civile, subjekti arsyeton se ky është një pretendim kontradiktor nga denoncuesi për sa kohë edhe vetë ai në ankesën e bërë shprehet se përse u aplikua neni 2003 i K.Pr.Civile, që tregon se pezullimi sipas këtyre dispozitave nuk mund të aplikohet gjatë fazës përmbartimore. Atëherë, ngre pyetjen ai, si duhej të vendosej garancia pasurore?! Në përfundim, subjekti argumenton se ligji i aplikueshëm në këtë rast është neni 610 dhe jo neni 202 e vijues i K.Pr.Civile.

iv. Ndërsa në lidhje me pretendimin e katërt, subjekti sqaron se përgjigjja është dhënë në shpjegimet e pikës 1 dhe 2 (si më sipër), duke argumentuar se denoncuesit ngatërrojnë sigurimin e padisë në gjykim themeli, me sigurimin e padisë gjatë fazës përmbartimore. Kushtet që pretendojnë të mos jenë zbatuar sipas nenit 202 të K.Pr.Civile, nuk zbatohen.

Vlerësimi i Komisionit

58. Nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me të, si edhe provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, Komisioni nuk vërejti problematika në vendimmarrjen e subjektit për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit lidhur me këtë denoncim janë bindëse dhe, si rrjedhim, arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektin e rivlerësimit, gjyqtarin Arben Dosti.

¹²² Shkresa nr. *** prot., datë 14.9.2021 e dërguar nga Komisioni dhe shkresa “kthim përgjigje” e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me nr. *** prot., datë 28.9.2021.

Denoncimet e shtetasit K.M¹²³

59. Denoncuesi ngre pretendime kundrejt disa subjekteve të rivlerësimit, për disa procese civile dhe penale që lidhen kryesisht me çështje pronësie. Rezulton se, përsa i përket subjektit të rivlerësimit, denoncuesi ankohet lidhur me vendimmarrjen e tij që i përket çështjes penale në të cilën ai shfaqet në cilësinë e kallëzuesit, duke pretenduar se gjykimi i tij ka qenë i njëanshëm dhe i kundërligjshëm.

59.1. Konstatohet se në gjykimin e çështjes me të pandehur shtetasin M.M, akuzuar për veprën penale të vetëgjyqësisë, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, me viktimë të veprës penale denoncuesin K.M., subjekti i rivlerësimit në datën 6.11.2018 ka vendosur (Vendimi nr. ***) deklarin e pafajshëm të shtetasit M.M.

59.2. Në vijim rezulton se pas ankimit të bërë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor lidhur me vendimin penal të sipërcituar, Gjykata e Apelit Gjyrokastër ka vendosur ndryshimin e vendimit dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, pra, deklarin fajtor të të pandehurit M.M, për kryerjen e veprës penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 75,000 lekë gjobë.

59.3. Nga shqyrtimi i këtij denoncimi dhe dokumentacionit bashkëlidhur tij, Komisioni konstaton se në këtë rast denoncuesi ankohet për vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, pra, ankimi i përket themelit të çështjes dhe çmon se nuk ka indicie për të provuar pretendimet e këtij denoncuesi për gjetje që do ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe/apo figurën e subjektit të rivlerësimit.

Denoncimi i shtetasit I.B, (në cilësinë e avokatit)¹²⁴

60. Nga verifikimi i këtij denoncimi, avokati B, ankohet kundër vendimit të gjyqtarit Dosti me nr. *** akti, datë 25.8.2019, nëpërmjet të cilit i është dhënë dënimin administrativ me gjobë, në shumën prej 300,000 lekë, gjatë njëres prej seancave gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, e cila lidhet me çështjen penale në ngarkim të shtetasit M.D. Pretendon se arsyetimi i vendimit të dënimin me gjobë është kontradiktor, me një fabul që nuk përfaqëson të vërtetën, dhe se e vërteta është e fiksuar në procesverbalin gjyqësor.

60.1. Gjithashtu, rezulton se avokati B. ngre pretendime edhe për qëndrimin e mbajtur nga gjyqtari Dosti – në cilësinë e gjyqtarit paraprak që ka shqyrtuar kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale me të pandehur, shtetasin M.D. Ai pretendon se gjyqtari Dosti po/ka manipulon/uar gjithë procesin gjyqësor kundër të pandehurit M.D, duke iu kundërvënë haptazi për të dytën herë vendimmarrjes së drejtë të organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër për dërgimin e çështjes në gjyq dhe dënimin e fajtorit.

60.2. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni¹²⁵, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër¹²⁶ vendosi në dispozicion fashikullin e plotë të gjykimit – lidhur me procesin gjyqësor penal me të pandehur shtetasin M.D, i cili përfshin aktet, provat, vendimet, procesverbalet dhe ato të regjistrimit audio (me CD) për të gjitha seancat gjyqësore që lidhen me këtë proces.

60.3. Nga verifikimi i materialeve, pjesë e fashikullit të kësaj dosjes, konstatohet se:

i. Në datën 31.1.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër në përfundim të hetimeve në kuadër të procedimit penal nr. ***, i vitit 2018, ka kërkuar dërgimin e çështjes për gjykim me të pandehur shtetasin M.D, i akuzuar për veprën penale të “Vepra të turpshme”, parashikuar nga neni 108/1 i Kodit Penal.

ii. Në datën 7.2.2019, subjekti i rivlerësimit - në cilësinë e gjyqtarit paraprak, ka caktuar seancën dëgjimore për gjykimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, të përcaktuar për t’u zhvilluar në datën 19.2.2019, ora 15:00.

¹²³ Ankesat me nr. *** prot., datë 19.4.2019 dhe nr. *** prot., datë 6.6.2019.

¹²⁴ Ankesa nr. *** prot., datë 6.6.2019.

¹²⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 2.2.2021.

¹²⁶ Shkresa nr. ***, datë 9.2.2021.

iii. Pas zhvillimit të seancës gjyqësore të datës 19.2.2019, në datën 22.2.2019 është riçelur seanca gjyqësore – e në vijim gjyqtari Dosti është tërhequr për të shpallur vendimin. Pasi është konsultuar me aktet dhe kërkesat e bëra si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu dhe gjatë gjykimit, ka çmuar se ka nevojë për vazhdimin e hetimit dhe marrjen e provave të reja. Ka disponuar me vendimin për vazhdimin e hetimeve me numër regjistri themeltar ***, datë 22.2.2019, ku janë përcaktuar dhe veprimet hetimore që kërkohet të kryhen nga prokurori dhe se seanca e ardhshme është vendosur të zhvillohet në datën 23.4.2019.

iv. Pas zhvillimit të disa seancave dëgjimore, me vendimin nr. ***, datë 10.6.2019, gjyqtari Dosti ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë, pra, dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit M.D, për veprën penale “Vepra të turpshme”, parashikuar nga neni 108/1 i Kodit Penal.

67.4 Gjithashtu, nga verifikimi i materialeve pjesë e fashikullit gjyqësor që lidhet me këtë çështje, ka rezultuar se në datën 28.5.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor e përbërë nga gjyqtari Arben Dosti, ka vendosur¹²⁷ dënimin me gjobë të avokatit I.B¹²⁸.

60.4. Në këtë vendim është arsyetuar se z. I.B, avokat i viktimës së veprës penale, ka shprehur konsiderata lidhur me veprimet e prokurorisë dhe gjykatës, që nuk kishin lidhje me momentin procedural në të cilën ndodhej çështja gjyqësore. Pasi i është tërhequr disa herë vërejtje nga gjykata, avokati ka vazhduar duke mos respektuar urdhërimet e gjykatës dhe debatuar në mënyrë jo korrekte me trupin gjykues. Në vijim, pasi është lajmëruar nga trupi gjykues, gjykata i ka komunikuar në seancë avokatit vendimin e dënimit me gjobë. Në kohën që gjykata po konsultohej me ligjin procedural lidhur me masën e gjobës, avokati ka vijuar me sjelljen jo korrekte, duke detyruar trupin gjykues të urdhërojë largimin e tij nga seanca gjyqësore. Pas largimit të avokatit, gjykata ka marrë vendimin për dënimin e tij administrativisht me gjobë në masën 30,000 lekë.

60.5. Rezulton se, pas kërkesës për përjashtimin nga gjykimi të gjyqtarit Dosti, të bërë në datën 29.5.2019 nga mbrojtësi ligjor i viktimës, avokati I.B, në datën 31.5.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, e përbërë nga gjyqtari P.V, ka vendosur¹²⁹ rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në prova e ligj.

60.6. Gjithashtu, vërehet se nëpërmjet materialit shkresor me titull “Shpjegime lidhur me CD me pamje filmike, bashkëngjitur dosjes për dërgimin në gjyq të çështjes penale”, gjyqtari Dosti informon Komisionin e Pavarur të Kualifikimit se: *Bashkëngjitur dosjes për dërgimin në gjyq të kërkesës së prokurorit, ndaj të pandehurit M.D, i akuzuar për veprën penale “Vepra të turpshme”, parashikuar nga neni 108 i Kodit Penal, është dhe një CD me pamjet filmike të seancës gjyqësore, seancë në të cilën avokati i viktimës së veprës penale është gjobitur dhe nxjerrë jashtë nga salla, nga trupi gjykues. Ky dokument është mbajtur nga trupi gjykues, pasi pas kësaj seance avokati ka pretenduar me shkresa dhe në një sërë emisionesh televizive, se në mënyrë të kundërligjshme, trupi gjykues ka nxjerrë nga salla edhe prindërit e viktimës të veprës penale. Nëpërmjet regjistrimit audio dhe pamjeve video, dallohet qartë se ka qenë avokati i cili u është drejtuar me fjalën “Hajdeni” dhe prindërit e viktimës kanë dalë pas tij. Në seancën e ardhshme gjykata ka sqaruar prindërit e viktimës së veprës penale, lidhur me të drejtat procedurale të viktimës, të pandehurit dhe rolin e paanshëm të gjykatës dhe të gjyqtarit të seancës paraprake në gjykimin e çështjes gjyqësore.*

60.7. Nga shqyrtimi i këtij denoncimi dhe dokumentacionit të administruar në dosje që lidhet me çështjen objekt denoncimi, Komisioni arrin në përfundimin se nuk ka indicie për të provuar pretendimet e këtij denoncuesi për gjetje që do ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale, kriterin etiko – profesional, apo për figurën e subjektit të rivlerësimit.

¹²⁷ Vendimi nr. *** Akti, datë 28.5.2019.

¹²⁸ Në datë 28.5.2019, vendimi i është dërguar me dëftesë komunikimi avokatit B. Gjithashtu, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me shkresën nr. *** akti, datë 17.6.2019, ia ka dërguar këtë vendim Zyrës së Përmbartimit Gjirokastër, pasi ky vendim është kthyer në titull ekzekutiv.

¹²⁹ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me nr. ***, datë 31.5.2019.

Denoncimi i shtetasit D.L.¹³⁰

61. Nga shqyrtimi këtij denoncimi, dokumentacionit të dërguar bashkëlidhur tij si edhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, konstatohet se, nuk ekzistojnë shkaqe, fakte apo rrethana të cilat do mund të vlerësoheshin nga Komisioni dhe, si të tilla, të mund të përbënin prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe për figurën e subjektin e rivlerësimit, gjyqtarit Arben Dosti.

Denoncimi i shtetasit A.Ç.¹³¹

62. Nga verifikimi i këtij denoncimi dhe dokumentacionit bashkëlidhur tij, rezulton se në këtë rast denoncuesi ankohet për vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, e konkretisht për rrëzimin e kërkesës së bërë prej tij me objekt: “Kundërshtimin e vendimit të datës 16.11.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. *** të vitit 2016, shfuqizimin e këtij vendimi, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve të mëtejshme”.

62.1. Pas shqyrtimit dhe analizimit të këtij denoncimi trupi gjykues vlerëson se ankimi i përket themelit të çështjes, garant i së cilës është gjykata e shkallës më të lartë. Në kushte të tilla, trajtimi i këtij denoncimi nuk është në kompetencë të Komisionit.

Denoncimi i shtetasit N.V¹³² dhe Denoncimi i Bankës * sh.a., (***)¹³³**

63. Nga verifikimi i këyre dy denoncimeve ngrihen pretendime për të njëjtën çështje të gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët N.D, M. I dhe Arben Dosti, e konkretisht për çështjen civile me paditës: Gj.Gj, të paditur: shoqëria “****” sh.p.k., Bashkia Sarandë, ZVRPP-ja Sarandë, Avokatura e Shtetit, person i tretë: Banka “****” sh.a., me objekt: “Detyrimin e palëve të paditura të njohin paditësin investitor në masën 60% të sipërfaqes ndërtimore të objektit 9-katësh. Detyrimin e shoqërisë *** sh.p.k., të përmbushë detyrimin sipas kontratës së bashkëpunimit datë 6.6.2004, duke e njohur pronar mbi 605 m² të sipërfaqes. Përcaktimin në natyrë të sipërfaqes takuese dhe detyrimin e ZVRPP Sarandë të regjistrojë në pronësi të tij sipërfaqen ndërtimore”.

63.1. *** Bank, ngre pretendime mbi shkelje procedurale dhe vendimmarrje të padrejtë që lidhet me gjykimin të kryer për çështjen e sipërcituar – për të cilën është dhënë vendimi nr. ***, datë 22.11.2019.

63.2. Shtetasi N.V pretendon se është refuzuar me pa të drejtë dhe në kundërshtim me ligjin, ndërhyrja e tij si person i tretë në gjykim. Gjithashtu, ngre pretendime për vendimmarrje të padrejtë, të pabazuar në ligj e në prova.

63.3. Komisioni administroi dosjen e plotë gjyqësore që lidhet me çështjen objekt ankimi¹³⁴.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi këto denoncime

64. Pasi nga Komisioni, me dërgimin e rezultateve të hetimit iu kërkuar të jepte shpjegimet e tij lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në lidhje me ankesën mbi vendimmarrjen, shqyrtimi i saj është atribut i një gjykate më të lartë, por gjithsesi në prapësimet e tij ka argumentuar vendimmarrjen për këtë rast.

64.1. Lidhur me çështjen objekt denoncimi subjekti ka sqaruar se midis shoqërisë “*** sh.p.k., dhe shtetasve N.V dhe T.V, është lidhur një kontratë shkëmbimi (e titulluar prej palëve sipërmarrjeje), në të cilën N dhe T.V, vendosnin në dispozicion të shoqërisë truallin, mbi të cilin shoqëria investuese “****” sh.p.k., do të ngrinte një objekt banimi shumëkatësh. Sipas marrëveshjes, pas përfundimit të objektit, pronarët e tokës do të përfitonin 20% të sipërfaqes ndërtimore. Në këtë sipërmarrje shoqëria

¹³⁰ Ankesa nr. *** prot., datë 19.8.2019.

¹³¹ Ankesa e përcjellë nga Kolegji Posaçëm i Apelit me shkresën nr. *** prot., datë 2.10.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.10.2019.

¹³² Ankesa nr. *** prot., datë 4.12.2019.

¹³³ Ankesa nr. *** prot., datë 19.12.2019.

¹³⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 14.9.2021 e dërguar nga Komisioni dhe shkresa “kthim përgjigje” e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me nr. *** prot., datë 28.9.2021.

“***” sh.p.k., paraqitet në rolin e investitorit dhe në rolin e ndërtuesit të objektit, në emrin e të cilës ka dalë edhe leja e ndërtimit. Në cilësinë e investuesit shoqëria i ka shitur paditësit, Gj.Gj, 60% të investimit mbi këtë objekt, dhe si rrjedhim shoqërisë i mbeti vetëm 20% e investimit, ndërkohë që pjesa prej 20% e pronarëve të truallit mbetet e pandryshuar. Rezulton se objekti është ndërtuar deri në një masë, ku sipas ekspertëve të caktuar nga gjykata është konsideruar “pothuajse i mbaruar”. Gjithashtu, ka rezultuar se ortakut dhe administratori i shoqërisë “***” sh.p.k., është dënuar penalisht për veprën penale të “Mashttrimit” dhe ka është duke vuajtur dënimin penal, i cili nuk ka lidhje me marrëdhënien juridike në shqyrtim. Për këtë shkak, gjatë gjykimit të çështjes administratori i shoqërisë “***” sh.p.k., sillej në gjykim nga ambientet e I EVP-së, ku vuante dënimin penal.

64.2. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se për shkak të vonesave dhe penaliteteve në vlera monetare, të parashikuara mes investitorit, shoqërisë “***” sh.p.k., dhe pronarëve të truallit, këta të fundit nëpërmjet një vendimi gjyqësor detyrimin në vlera monetare e kanë konvertuar direkt në gjykatë, në përqindje ndërtimi në objektin shumëkatësh. Por, ky gjykim është zhvilluar në mungesë të të paditurit dhe se ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

64.3. Në këtë periudhë, sqaron në shpjegimet e tij subjekti, paditësi Gj. Gj padit në gjykatë shoqërinë “***” sh.p.k., duke i kërkuar pjesën e vetë të përqindjes, 60% mbi objektin e ndërtuar. Njëkohësisht ka paditur Bashkinë Sarandë dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Dega Sarandë. Person i tretë në gjykim është edhe ***, e më pas *** Bank. Të paditur në këtë gjykim kanë qenë edhe pronarët e truallit N dhe T.V. Në këtë gjykim, pronarët e truallit janë thirrur për shkak se një pjesë takuese të pasurisë së shoqërisë “***” sh.p.k., që pretendohet nga paditësi Gj.Gj u kishte kaluar në pronësi këtyre të fundit me vendim gjyqësor, referuar si më sipër.

64.4. Gjithashtu, subjekti ka referuar faktin se gjatë gjykimit vendimi që u kishte kaluar pronarëve të tokës është prishur nga Gjykata e Apelit, pas rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit të shoqërisë “***” sh.p.k. Në kushtet e prishjes së vendimit të shkallës së parë, subjekti argumenton se pozita juridike në marrëveshjen e bërë me shoqërinë “***” sh.p.k., për pronarët e truallit mbeti ajo e marrëveshjes, prej 20%, e cila nuk cenohej nga padia në gjykim. Si rrjedhojë, paditësi si iniciues i procesit kërkoi pushimin e gjykimit ndaj pronarëve të truallit, duke vazhduar gjykimin ndaj personave të tjerë. Subjekti arsyeton se, meqenëse të drejtën për inicim të procesit, disponim të objektit dhe personave që shtrin kërkimet e ka paditësi, dhe për sa kohë gjykata nuk konstatoi bashkëndërgjyqësi të detyrueshme, e pranoi kërkesën për pushimin e gjykimit ndaj pronarëve të truallit, porse, në vijim të gjykimit pronarët e truallit paraqitën kërkesë për futjen në gjykim si person i tretë, në fillim si kryesor dhe më pas si dytësor.

64.5. Subjekti argumenton se padia e ndërhyrësit kryesor N.V nuk mund të pranohej në atë fazë të gjykimit, si për shkak të procedurës së ndryshme që po zhvillohej gjykimi dhe duhej të gjykohej padia e re (para dhe pas ndryshimeve ligjore të K.Pr.Civile), ashtu edhe për shkak se e njëjta padi ishte duke u shqyrtuar në gjyqin që po zhvillohej pas kthimit për rigjykim të çështjes nga Gjykata e Apelit. Njëkohësisht, u verifikua dhe mosekzistenca e interesit të pronarëve të truallit, për sa kohë në këtë gjykim, konflikti ishte mes investitorëve të sendit dhe nuk kishte asnjë pretendim ndaj pronarëve të truallit.

64.6. Në këtë kontekst, subjekti arsyeton se ndërhyrja si person dytësor duhej të kryhej në dobi të interesave të ndonjë prej palëve të paditura ose personit të tretë. Personat nuk provuan interesin në këtë gjykim dhe në ndihmë të cilës do të hynin si persona të tretë dytësor. Me shoqërinë “***” sh.p.k., janë në konflikt gjyqësor, me Bashkinë, ASHK-në dhe personin e tretë nuk kanë interesa të përbashkëta. Për më tepër subjekti argumenton se vendimet e ndërmjetme të gjykatës për mospranimin e personave të tretë (kryesor dhe dytësor), pronarët e truallit mund t’i ankimonin në gjykatë.

64.7. Ndërsa në lidhje me faktet e denoncuara nga ***Bank, subjekti ka sqaruar se kjo palë ka qenë në pozitën procedurale të personit të tretë, pozitë e cila nuk kërkoi që ta ndryshonte deri në fund të gjykimit, duke parashtruar se pozitën procedurale e ndryshojnë vetë palët dhe jo gjykatat kryesisht. Subjekti ka argumentuar se pretendimeve të bankës i është dhënë përgjigje në vendim, përfshirë dhe dyshimit të saj për goditjen e kontratave të hipotekimit.

64.8. Në lidhje me dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, subjekti ka parashtruar se kjo vendimarrje nuk ka cenuar asnjë nga palët ndërgjyqëse, pasi vetëm vendosja në posedim e sendit është dhënë me ekzekutim të përkohshëm, kjo për shkak edhe të kujdesit që duhej të kryhej, për të mos degraduar sendi.

Vlerësimi i Komisionit

65. Ndryshe nga sa argumenton subjekti, por pa dashur të hyjë në logjikën e arsytimit dhe vlerësimit mbi vendimarrjen e bërë, Komisioni çmon se në këtë rast, për sa kohë tendenca e ndërhyrësit dytësor prihet të bashkohet me njërin nga palët, rezulton se pronarët e truallit përmbushin kushtet dhe kanë provuar interesin e ligjshëm në këtë gjykim për të hyrë si persona të tretë në dobi të shoqërisë “***” sh.p.k., duke qenë se rezulton e provuar se ata ishin në konflikt gjyqësor me këtë shoqëri dhe për më tepër kishin pretendime financiare ndaj saj.

65.1. Gjithsesi, në kushtet kur Gjykata ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për të cilin bëhet ankimi i veçantë¹³⁵ dhe në këtë vendim ka referuar të drejtën e kërkuarëve për ankim, pra, duke mos cenuar të drejtën e tyre, Komisioni çmon se ky vendim, i cili rezulton të jetë i mirëarsyetuar, është marrë në përmbushje të bindjes së brendshme të trupit gjykues, në përbërje të të cilit është dhe gjyqtari Dosti. Për më tepër vërehet se, pas ankimit të veçantë të bërë lidhur me këtë vendim, Gjykata e Apelit Gjyrokastër ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër¹³⁶.

65.2. Sa i përket pretendimeve të tjera të ngritura në këto dy denoncime, Komisioni vlerëson se ato i përkasin themelit të çështjes, garant i së cilës është gjykata e shkallës më të lartë.

Denoncimi i shtetasve Sh.H dhe N.H - në cilësinë e përfaqësuesit ligjor¹³⁷

66. Nga verifikimi i kësaj ankese, vërehet se denoncuesit ngrenë pretendime për vendimarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër me gjyqtar Arben Dosti, e konkretisht lidhur me vendimin penal në ngarkim të të pandehurit K.C, si një vendim i dhënë në kundërshtim me ligjin.

66.1. Nga shqyrtimi i këtij denoncimi dhe dokumentacionit bashkëlidhur tij, konstatohet se natyra e pretendimeve lidhen me themelin e çështjes/vendimit, të cilat vlerësohet se janë objekt i kontrollit gjyqësor nga gjykata e shkallës më të lartë. Në kushte të tilla, trajtimi i këtij denoncimi nuk është në kompetencë të Komisionit.

66.2. Gjithashtu ka rezultuar se pretendimet e denoncueses të parashtruara në këtë ankesë ndaj gjyqtarit Dosti - janë shqyrtuar edhe nga ish-inspektorati i KLD-së, i cili ka vendosur arkivimin e ankesës.

Denoncimi i shtetasit Gj.LI¹³⁸

67. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, ka ndërhyrë në proces gjyqësor penal të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, me qëllim favorizimin e kallzuesit, duke cenuar kodin e etikës së magjistratit.

67.1. Mbas verifikimit të këtij denoncimi, Komisioni konstatoi se denoncuesi nuk ka paraqitur të dhëna/fakte dhe dokumentacion mbi bazën e të cilave do mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, lidhur me figurën apo me kriterin etiko – profesional.

67.2. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, lidhur me këtë denoncim subjekti ka sqaruar se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat është zhvilluar gjykimi penal, ku shtetasi Gj.LI ka qenë i pandehur për veprën penale të “Mashttrimit” ndaj shtetasit K.Z. Viktima akuzonte shtetsin Gj.LI për kthimin e huas dhe mosdhënien prej Gj, bashkëshortes së tij, M.LI, e cila ishte huadhënëse. Në këtë gjykim subjekti deklaroi se ka marrë pjesë si dëshmitar, pasi në kohën e dhënies së vlerave

¹³⁵ Vendim i ndërmjetëm i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e përbërë nga trupi gjykues me kryesues gjyqtare N. D dhe anëtarë gjyqtarët Arben Dosti dhe M.I, me numër regjistri themeltar *** datë 6.11.2019.

¹³⁶ Vendimi i Gjykatës së Apelit Gjyrokastër me nr. ***, datë 23.12.2019.

¹³⁷ Ankesa nr. *** prot., datë 23.1.2020.

¹³⁸ Ankesa nr. *** prot., datë 5.3.2020.

monetare ka qenë prezent në momentin e dorëzimit. Procedura e thirrjes në gjykim është bërë nga trupi gjykues i çështjes dhe se ai në këtë rast ka përmbushur detyrimin ligjor si qytetar.

67.3. Në vlerësim edhe të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i qëndron konstatimit fillestar lidhur me faktet e denoncuar në këtë ankesë.

Denoncimi i shtetas H.K¹³⁹

68. Nga verifikimi i kësaj ankese, denoncuesja ngre pretendime lidhur me vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit për pranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal me nr. ***, regjistruar për veprën penale “Mjekimi i pakujdesshëm”.

68.1. Konstatohet se, bazuar në kallëzimin e shtetasit E.A, pas vdekjes së babait të tij, A.A, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “Mjekimi i pakujdesshëm”. Pas përfundimit të hetimeve, Prokuroria ka kërkuar pushimin e çështjes, kërkesë e cila është pranuar nga gjyqtari Dosti.

68.2. Denoncuesja sqaron se, pas kërkesës së Prokurorisë, në datën 11.11.2019 u zhvillua seanca gjyqësore dhe nga ana e gjyqtarit Dosti u pranua kërkesa e prokurorit për pushimin e hetimit, e motivuar kjo kërkesë me arsyetimin e prokurorit se gjatë hetimit nuk u gjetën elemente të veprës penale.

68.3. Në ankesën e bërë, shtetasja H.K–motra e të ndjerit A.A., hedh dyshime se vdekja e vëllait të saj nuk ka qenë për shkaqe natyrale, duke pretenduar se Prokuroria nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore – përfshirë dhe ato të cilat i ka kërkuar të kryhen nëpërmjet dëshmisë së dhënë prej saj, si person që ka dijeni për rrethanat e hetimit, në kuadër të këtij procedimi penal. Duke pasur ankesa lidhur me kryerjen e veprimeve hetimore nga Prokuroria, të cilat sipas saj nëse do kryheshin siç duhej, do të çonin në zbardhjen e së vërtetës, denoncuesja pretendon se edhe pranimi i kërkesës për pushimin e çështjes është një vendim i padrejtë i gjyqtarit Dosti.

68.4. Në vijim, shtetasja H.K. ka sqaruar se i është drejtuar gjyqtarit Dosti, duke i kërkuar ta sqaronte për argumentat dhe provat që paraqiti prokurori për të pushuar procedimin penal, si edhe rrethana të tjera që lidhen me çështjen.

68.5. Bashkëlidhur këtij denoncimi, është depozituar shkresa “kthim përgjigjeje” e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër¹⁴⁰, drejtuar shtetas H.K, firmosur nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e Zëvendëskryetarit të Gjykatës, në të cilën referohet ndër të tjera se: - *Kësaj shtetasje i është dhënë përgjigje më parë lidhur me mosdakordësinë për pushimin e çështjes, që lidhet me vdekjen e vëllait të saj (duke nënvizuar si i ka kthyer përgjigje në të dyja cilësitë, si drejtues i gjykatës dhe si gjyqtari që ka shqyrtuar dhe ka dhënë vendimin në lidhje me kërkesën e prokurorit). Ndërsa, për kërkesat në lidhje me hetimin e çështjes apo ekzistencën e provave të reja, kjo shtetase është orientuar t’i drejtohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.*

68.6. Gjithsesi, denoncuesja ka sqaruar se të gjitha provat që ka pasur i ka depozituar më parë në Prokurori. Nga ana tjetër, nuk ka të dhëna nëse vendimi i gjyqtarit Dosti është ankimuar nga trashëgimtarët e viktimës, në këtë rast nga vetë kallëzuesi – djali i tij, E.H, apo nga denoncuesja, e motra e tij, etj.

68.7. Në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, parashikohet se trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtë: (i) të kërkojnë ndjekjen penale të fajtorit; (ii) të informohen për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod; (iii) të njoftohen për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit; (iv) të bëjnë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen; (v) të kërkojnë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal; (vi) të ushtrojnë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

¹³⁹ Ankesa nr. *** prot., datë 15.9.2021.

¹⁴⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 5.3.2021.

68.8. Referuar nenit 360 të Kodit Civil, trashëgimtarët ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, gjyshi e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimtarëve, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti. Këta thirren në trashëgim sipas radhës të caktuar në këtë Kod.

68.9. Gjithashtu, në pikën 1 të nenit 329/c të Kodit të Procedurës Penale, është parashikuar se, kur pas vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar, ai mund të revokohet nga gjyqtari i seancës paraprake me kërkesë të prokurorit, të viktimës ose trashëgimtarëve të saj.

68.10. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të konfirmojë dhe të provojë me dokumentacion justifikues ligjor: (i) nëse i është njoftuar vendimi i pushimit (vendimi për pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes) kallëzuesit dhe/ose trashëgimtarëve të viktimës; (ii) nëse është bërë ankim në gjykatë kundër vendimit të pushimit të hetimeve (vendimit të pranimit të kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes), të marrë nga subjekti gjyqtar i seancës paraprake; dhe (iii) nëse kërkesat e depozituara pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që lidhen me çështjen objekt denoncimi, nga shtetasja, znj. H.K, kanë qenë të karakterit procedural, kjo edhe në kuptim të nenit 329/c të Kodit të Procedurës Penale, apo kanë qenë kërkesa për informacion/të karakterit informues.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi këtë denoncim

69. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se, në gjykimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes është thirrur dhe ka qenë prezent, kallëzuesi, E.H, djali i të ndjerit A.H. Pasi është diskutuar në themel, kallëzuesi është shprehur që është dakord me kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes penale. Pas dhënies së vendimit, rezulton se znj. H.K ka paraqitur një shkresë në gjykatë për marrjen e informacionit, si edhe mbi pretendimet e saj në lidhje me kujdesin mjekësor ndaj të ndjerit, vëllait të saj, së cilës, në cilësinë e drejtuesit të gjykatës, i ka kthyer përgjigje.

69.1. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se kërkesa e prokurorit për pushimin e çështjes i është njoftuar kallëzuesit, z. E.A, djali i viktimës A.H dhe se kundër vendimit nuk është kryer ankim. Ndërsa lidhur me shtetasen H.K, subjekti parashtron se ajo ka kërkuar shpjegime procedurale, duke paraqitur dhe prova, por se ai i është përgjigjur në dhënien e informacionit me karakter të përgjithshëm – me karakter informues, referuar vendimit gjyqësor, për të cilin referon se pas marrjes formë të prerë është i aksesueshëm nga të gjithë.

69.2. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar kopje të: (i) vendimit gjyqësor nr. ***, datë 11.11.2019, (ii) shkresën “letër kërkesë” të znj. H.K, e datës 14.11.2019; (iii) shkresën “kthim përgjigjeje”, datë 22.11.2019; (iv) dëftesë komunikimi datë 22.11.2019; (v) shkresën “kthim përgjigjeje”, datë 5.3.2021; dhe (vi) shkresa e Postës Shqiptare për gjurmimin e objektit të dorëzuar në datën 8.3.2021.

Vlerësimi i Komisionit

69.3. Nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe të bazuara në dokumentacion provues dhe, si rrjedhim, arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe për subjektin e rivlerësimit.

Çështje të tjera të verifikuara dhe të vlerësuara nga Komisioni

Çështja penale me të pandehur shtetasin A.C

70. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore¹⁴¹, që i përket çështjes penale me të pandehur shtetasin A.C, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 të Kodit Penal, konstatohet se:

i. Mbas hetimeve të kryera, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka dërguar për gjykim dhe ka kërkuar deklarinim fajtor të shtetasit A.C, për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284/1 të K.Penal, dhe dënimin me tre vjet e gjashtë muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3, duke u dënuar përfundimisht me 2 vjet e 4 muaj burgim.

ii. Mbrojtësi ligjor i të pandehurit ka kërkuar të aplikohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit, parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal.

iii. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e përbërë nga subjekti i rivlerësimit si gjyqtar i vetëm, në datën 29.3.2017 ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit A.C, për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284/1 të K.Penal, dhe dënimin me 3 (tre) vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale dënimit i zbritet 1/3 – ta, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin me 2 (dy) vjet burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit, duke e vendosur në provë të pandehurin A.C për një periudhë prej 2 vjetësh, me kusht që gjatë kësaj periudhe prove të mos kryejë veprë tjetër penale, si dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, Gjirokastrë.

iv. Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është apeluar nga prokurori vetëm sa i takon aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal.

v. Gjykata e Apelit Gjirokastrë në datën 29.7.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në lidhje me fajësinë, masën e dënimit dhe shpenzimet gjyqësore. Ndryshimin e vendimit sa i përket mënyrës së vuajtjes së dënimit, duke u vendosur mosaplikimi i nenit 59 të Kodit Penal.

vi. Nga verifikimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se shtetasi A.C ka ushtruar rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

70.1. Konstatohet se Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë - përbërë nga gjyqtari i vetëm, z. Arben Dosti, në rastin objekt shqyrtimi në arsyetimin e dhënë për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal dhe pranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të dënimit penal, rezulton se ka vlerësuar këto rrethana: (i) i pandehuri është hetuar dhe gjykuar në gjendje të lirë, pa masë sigurimi personal; (ii) sipas akteve të paraqitura nga mbrojtja në gjykim – rezulton se familja e të pandehurit përbëhet nga prindërit e tij dhe i pandehuri, dhe se prindërit e të pandehurit janë në moshë relativisht të madhe, të rënduar nga ana shëndetësore dhe aktualisht janë pensionistë, e vetëm i pandehuri është në gjendje pune për të mbajtur ekonomikisht familjen e tij; (iii) i pandehuri ka një moshë relativisht të re; (iv) si edhe bimët narkotike të mbjella ishin në fazën e inkubatorit, të pambjella në terren, duke ekzistuar mundësia që i pandehuri të hiqte dorë nga vepra penale. Gjykata ka çmuar se dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale, rrethanave, vendit të kryerjes dhe rrezikshmërinë e autorit.

70.2. Por, nga ana tjetër në arsyetimin e bërë për sa i përket llojit dhe masës së dënimit, Gjykata e Shkallës së Parë ka referuar si rrethanë rënduese rrezikshmërinë e veprës penale.

70.3. Ndërsa, në vendimin e saj Gjykata e Apelit Gjirokastrë – ka çmuar se në rastin shqyrtim nuk duhet të aplikohet neni 59 të Kodit Penal, duke argumentuar se kriteri bazë i aplikimit të këtij neni është rrezikshmëria e pakët e personit dhe plotësimi i disa kushteve të tjera siç është mosha, kushtet shëndetësore, etj. Në vijim të arsyetimit të saj, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka parashtruar se në kushtet kur sasia e bimëve narkotike të mbjella ishte relativisht e lartë, kjo tregon rrezikshmëri jo të pakët të të pandehurit. Fakti që prindërit janë pensionistë nuk justifikon aplikimin e nenit 59 të K.P.

¹⁴¹ Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2021

Gjithashtu, nuk provohet që i pandehuri është i punësuar e për rrjedhojë që me këto të ardhura mban familjen.

70.4. Nga verifikimi i materialeve të administruara lidhur me çështjet penale në ngarkim të shtetasit A.C rezulton se, mbas fillimit të gjykimit, por para dhënies së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ky shtetas është dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Vlorë, për konsumimin e veprës penale të “Prodhim dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

70.5. Por, gjithsesi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, sa i përket çështjes penale ndaj shtetasit A.C, të gjykuar për konsumimin e veprës penale të “Kultivimit të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, vuri në dispozicion vetëm kopje të vendimeve dhe procesverbaleve të seancave, për shkak se dosja e plotë ndodhej në Gjykatën e Lartë, bazuar në rekursin e bërë nga shtetasi A.C.

70.6. Në këto kushte, Komisioni kërkoi nga¹⁴² Gjykata e Lartë dosjen e plotë gjyqësore që i përket kësaj çështjeje penale. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi¹⁴³ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, dosjen e plotë të procedimit penal të dërguar për gjykim ndaj të pandehurit, shtetasin A.C, për kryerjen e veprës penale të “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal.

70.7. Nga aktet e dërguara nga Gjykata e Lartë¹⁴⁴, për këtë çështje penale, rezulton se nuk është përfshirë fashikulli i hetimeve të prokurorisë.

70.8. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë¹⁴⁵, dërgoi fashikullin e plotë që lidhet me procedimin penal nr. ***, për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal, dërguar për gjykim në ngarkim të të pandehurit A.C.

70.9. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë¹⁴⁶ – në vijim të përgjigjes së kërkesës së Komisionit dërgoi edhe procesverbalin/et e zbardhur/a së bashku me CD-në e regjistrimit të seancave gjyqësore.

70.10. Nga verifikimi i materialeve të dosjes së dërguar nga Gjykata dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, si edhe nga Gjykata e Lartë, lidhur me çështjen penale objekt shqyrtimi, rezulton se në aplikim në nenit 406 është pranuar gjykimi i shkurtuar, pasi gjykata ka çmuar se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Në fashikullin hetimor të dërguar nga Prokuroria konstatohet se është administruar certifikata elektronike e gjendjes gjyqësore të të pandehurit, shtetasit A.C, sipas së cilës ka rezultuar se ai është i padënuar. Të vetmet akte/prova të reja që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë ato të paraqitura nga pala mbrojtëse në funksion të kërkesës së bërë për aplikimin e nenit 59, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien e të dënuarit në provë.

70.11. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japi shpjegimet tij shteruese dhe të argumentonte mbi arsyet dhe kriteret në të cilat u bazua në disponimin me vendim për pranimin e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, krahas atyre të dhëna në arsyetimin e vendimit, si edhe të konfirmojë nëse ai kishte dijeni/informacion për faktin e gjykimit dhe dënimit të këtij shtetasi (të pandehurit A.C) nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë apo Gjykata e Apelit Vlorë, për konsumimin e veprës penale të “Prodhim dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje

71. Lidhur me çështjen objekt vlerësimi, subjekti ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur se ka pasur kërkesë të Prokurorisë për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit, A.C, për veprën penale të “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga nenin 284/1 i Kodit Penal. Gjykimi

¹⁴² Shkresa nr. *** prot., datë 20.10.2021.

¹⁴³ Shkresa nr. *** prot., datë 14.10.2021.

¹⁴⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 25.10.2021.

¹⁴⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 22.10.2021.

¹⁴⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 26.10.2021.

për këtë çështje është zhvilluar në prezencë të prokurorit, të pandehurit, i cili ka qenë pa masë sigurimi, dhe mbojtësit të tij ligjor. Ka sqaruar gjithashtu se, ky gjykim është zhvilluar me procedurë të shkurtuar, duke referuar konkluzionet dhe kërkesat përfundimtare të prokurorit, si edhe vendimmarrjen e tij lidhur me këtë rast (të sqaruara si më sipër).

71.1. Lidhur me rrethanat dhe kriteret e vlerësuara prej tij në aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit krahas referimit të arsytimit të bërë në vendimmarrjen e tij, ka parashtruar sa më poshtë vijon:

i. I pandehuri është gjykuar në gjendje të lirë, pa masë sigurimi, duke qenë prezent në gjykim dhe se ky fakt ka treguar një rrezikshmëri shoqërore të ulët të këtij personi;

ii. I pandehuri ka qenë i padënuar më parë, pasi në certifikatën e gjendjes gjyqësore ishte shënimi “i padënuar” dhe se ky fakt merret parasysh nga gjykata, pasi provon rrezikshmërinë e ulët të të pandehurit, duke argumentuar se qëllimi i dënimit penal nuk është ndëshkueshmëria, por rehabilitimi, risocializimi në shoqëri, i cili është më i shpejtë dhe më i efektshëm tek personat e padënuar;

iii. I pandehuri ka konsumuar veprën penale të “Kultivimi i bimëve narkotike” dhe fakti kriminal ka ndodhur në vitin 2015. Në këtë kontekst argumenton se, në vendimin e tij ka mbajtur në konsideratë faktin se në vitet 2015 - 2016 ka patur rritje të aktivitetit kriminal të kultivimit të bimëve narkotike, e për më tepër në qarkun e Gjirokastrës ky aktivitet është vërejtur nga numri i procedimeve të ardhura për këto çështje, apo me kapjen e sasive të mëdha të bimës “canabis sativa”, deri në tonelata. Përfshirja e personave ka qenë e të gjitha moshave, për shumë arsye dhe se këta persona kanë qenë në të gjitha rolet e kryerjes së aktivitetit kriminal, por se përgjithësisht në gjykatë kanë ardhur punëtorët që kujdeseshin për rritjen e bimëve narkotike. Është konstatuar fakti se shumica e kanë kryer këtë aktivitet për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike në familjet e tyre.

iv. I pandehuri A.C, në kohën e gjyqimit, ka qenë në moshë të re. Në familje jetonte me prindërit e tij, dy pensionistë, e në këtë këndvështrim ka argumentuar se është fakt i njohur botërisht se të ardhurat nga pensionet nuk janë të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të tyre, qoftë edhe atyre shëndetësore dhe se burgosja e të pandehurit mund të shkaktonte cenim të gjendjes shëndetësore dhe shpirtërore të këtyre personave. Për më tepër, subjekti arsyeton se nuk është e nevojshme që i pandehuri duhet të provonte se më parë ishte në marrëdhënie pune, për të provuar përkujdesjen ndaj prindërve të tij, por i rëndësishëm është vlerësuar fakti se në çdo kohë ai mund të fillonte punë për krijimin e të ardhurave për vete dhe për prindërit e tij.

v. I pandehuri A.C ka kultivuar bimë narkotike. Në vendimin e saj, Gjykata e Apelit shprehet se rrezikshmëria e të pandehurit është e lartë, për shkak të sasisë së bimëve narkotike të kultivuar. Por, në vendimmarrjen e tij, subjekti referon se ka marrë në konsideratë edhe fazën në të cilën ndodheshin këto bimë, të cilat ende nuk ishin të mbjella, pasi ishin në fazën inkubatore, dhe si rrjedhojë deri në ato momente nuk plotësonin asnjë kriter për t’u konsideruar të përdorshme dhe të rrezikshme për shëndetin e njerëzve. Në këtë këndvështrim, subjekti ka arsyetuar se deri në arritjen e kohës për vjeljen e tyre, do të kalonin disa faza dhe një periudhë e gjatë kohore, me mundësinë e të pandehurit edhe për të hequr nga vepra penale ose në dështimin e kultivimit të tyre.

vi. Vepra penale e kultivimit të bimëve narkotike është kryer në fshehtësi, duke argumentuar se ka një diferencë midis veprave penale të kryera në publik dhe atyre të kryera në fshehtësi dhe se dallimi është tek fakti që veprat penale në fshehtësi nuk dihen dhe nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në rendin dhe sigurinë publike.

vii. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit penal, detyrimisht shoqërohet me një periudhë prove. Në këtë periudhë prove, personi i dënuar, mban kontakt me Shërbimin e Provës dhe përmbush detyrimet që i vendos ky shërbim, në funksion të procesit rehabilitues të tij.

71.2. Për sa më sipër, subjekti deklaroi se në rastin në shqyrtim kanë ekzistuar të gjitha rrethanat të mbështetura në prova që ndaj të pandehurit, A.C, të aplikohet neni 59 i Kodit Penal, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burg.

71.3. Ndërsa në lidhje me ekzistencën e një dënimi penal të mëparshëm, subjekti ka deklaruar se në gjykim, nga prokurori, i pandehuri, apo avokati i tij, nuk u pretendua ekzistenca e një dënimi penal.

Vlerësimi i Komisionit

72. Nga shqyrtimi në tërësi i çështjes së mësipërme, dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me të, si edhe provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, pa i hyrë logjikës së arsytimit dhe vlerësimit mbi vendimmarrjen që lidhet me themelin e çështjes, Komisioni çmon se ajo është bazuar në bindjen e brendshme të gjyqtarit Dosti, në verifikim dhe analizë të kriterëve mbi bazën e të cilave aplikohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe në mungesë të ndonjë kriteri të qartë ndalues. Nuk u provua që subjekti të kishte dijeni mbi faktin e dënimit të këtij shtetasi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë për konsumimin e veprës penale të “Prodhim dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, rrethanë e cila në vlerësimin e Komisionit tregon mbi rrezikshmërinë e të pandehurit dhe faktit të mungesës së sigurisë për rehabilitimin e tij. Nga hetimit administrativ rezultoi se në fashikullin hetimor është administruar certifikata elektronike e gjendjes gjyqësore e të pandehurit, shtetasit A.C, sipas së cilës ai figuron i padënuar.

72.1. Në këtë kontekst, trupi gjykues i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit mbi vendimmarrjen e tij lidhur me këtë çështje dhe, si rrjedhim, arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Arben Dosti.

Trajtimi i informacioneve nga burimet e hapura

73. Nga informacionet e përfutuara nga mediat *online*, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, ka vendosur masën e sigurimit personal “arrest shtëpie” për shtetasit Ç.Ç dhe P.N, për të cilët raportohet se janë arrestuar në flagrancë me 58 kg marijuanë.

73.1. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni¹⁴⁷, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka dërguar¹⁴⁸ fashikullin e procedimit penal me nr. ***, i vitit 2017, regjistruar për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, që lidhet me ngjarjen e referuar si më sipër, të raportuar në media.

73.2. Nga verifikimi i materialeve të kësaj dosjeje, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtari që ka shqyrtuar vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit për shtetasin P.N.

73.3. Konstatohet se, pas kërkesës së bërë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest me burg” për shtetasin nën hetim, P.N, subjekti i rivlerësimit ka vendosur¹⁴⁹: (i) vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë; dhe (ii) caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi” me mbikëqyrje elektronike, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale dhe ligji nr. 10496/2011, “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

73.4. Rezulton se kundër vendimit të sipërcituar ka paraqitur ankim Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Në shqyrtim të kësaj kërkesë, Gjykata e Apelit Gjirokastër ka vendosur: (i) miratimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër sa i përket disponimit për vleftësimin “Arrest në flagrancë” ndaj personit nën hetim P.N; (ii) ndryshimin e këtij vendimi sa i përket disponimin për caktimin e masës së sigurimit, duke i dhënë masën e “Arrestit me burg”, sipas nenit 238 të K.Pr.Penale.

73.5. Në vendimin e saj, Gjykata e Apelit Gjirokastër parashtron se, pavarësisht se kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit (sipas neneve 228 dhe 229 të K.Pr.Penale) janë alternative dhe jo kumulative, referuar Vendimit Unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nëse në gjykim vërtetohet qoftë edhe njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të

¹⁴⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 14.10.2021.

¹⁴⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 22.10.2021.

¹⁴⁹ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me nr. ***, datë 20.6.2017.

hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mosekzistencën e kushteve dhe kritereve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit personal dhe kufizimin e lirisë së të gjykuarit.

73.6. Konstatohet se Gjykata e Apelit ka vlerësuar ndryshe sa i përket: (i) rrezikut të ikjes; (ii) mundësisë që personi nën hetim të ndërhyjë në procesin e drejtësisë; dhe (iii) përshtatshmërisë së masës së sigurimit në raport me sanksionin penal të parashikuar për veprën penale për të cilën ky person dyshohet të ketë kryer.

73.7. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japi shpjegimet e tij shteruese mbi kriteret dhe kushtet në të cilat u bazua në disponimin me vendim për caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi” me mbikëqyrje elektronike, krahas atyre të dhëna në arsyetimin e vendimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje

74. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara, subjekti i rivlerësimit ka referuar se në trajtimin e çështjes penale, pas kërkesës së prokurorit për vlefhtësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, në vendimin e tij është shprehur ndër të tjera se: “...Gjykata vëren se masa e sigurimit nuk është masë ndëshkimore për personin që dyshohet se ka kryer një veprë penale dhe nga ana tjetër, nuk jepet për të lehtësuar punën e organit të prokurorisë në hetimin e çështjes penale, por ajo duhet të aplikohet vetëm në zbatim të shkaqeve, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në mënyrë të qartë në nenet 228, 229, dhe 230 të K.Pr.Penale. Për më tepër, masa e sigurimit personal nuk njësohet me dënimin penal, pasi është një veprim procedural që kufizon përkohësisht lirinë e personit ndaj të cilit po zhvillohet procedimi penal. Ky kufizim është i përkohshëm dhe shkalla e tij varet nga nevoja konkrete të procesit të hetimit.”¹⁵⁰

74.1. Në vijim, në prapësimet e tij subjekti pasi ka bërë një arsyetim të gjerë të kushteve të përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit, ka analizuar në mënyrë të detajuar kriteret e veçanta, të cilat duket se Gjykata e Apelit i ka vlerësuar ndryshe nga ai në vendimmarrjen për caktimin e masës së sigurisë ndaj personit nën hetim, shtetasit P.N, si më poshtë vijon:

i. Së pari, lidhur me rrezikun e largimit, çmon se ekziston në ato raste kur arrestimi i një personi të dyshuar ka qenë i vështirë ose i pamundur, apo kur dihet se personi do të largohet sapo t’i jepet mundësia për një gjë të tillë për rastin në shqyrtim, ka vlerësuar se nuk u provua në gjykim se ekziston rreziku i ikjes së personit nën hetim, por se rrezikshmëria e ikjes u pretendua vetëm për shkak të dënimit që parashikon vepra penale, pa pretenduar dhe analizuar rrezikshmërinë e autorit të dyshuar apo ekzistencën e rrethanave rënduese dhe/apo lehtësuese, sipas neneve 229/2 të K.Pr. Penale¹⁵¹.

ii. Së dyti, argumenton se rreziku i ndërhyrjes në procesin e drejtësisë është një nga arsyet për të hequr lirinë e personit. Por, në çështjen në shqyrtim nga ana e tij, u vlerësua se nuk ka ekzistuar asnjë provë apo mundësi reale që personi nën hetim të ndërhyjë në procesin e drejtësisë, pasi veprimet procedurale në vendin e ngjarjes kishin përfunduar dhe nuk u paraqit asnjë rrethanë apo pretendim që personi nën hetim të paraqesi rrezikshmëri për cenimin e marrjes së provave apo të vërtetësisë së tyre, konkretisht të akteve të ekspertimit, të cilat kryhen në Institutin e Policisë Shkencore.

iii. Së treti, lidhur me nevojën për të parandaluar pasojat e mëtejshme të veprës penale, ose kryerjen e veprave të tjera penale, ka referuar vendimin e Gjykatës së Lartë (vendimi nr. 22, datë 26.5.2015), në të cilin është arsyetuar ndër të tjera se: “...Gjykata Europiane ka theksuar se, gjykatat e shteteve anëtare duhet të kenë parasysh që në vlerësimin e rastit konkret nëse ekziston nevoja për caktimin e masës së arrestit me paraburgim për parandalimin e kryerjes së veprës penale, të marrin në konsideratë të gjitha rrethanat e çështjes si: historiku i jetës në të kaluarën, personaliteti i personit

¹⁵⁰ Në arsyetimin e tij ka referuar edhe dy vendime të Gjykatës së Lartë.

¹⁵¹ Ka referuar se “...Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në lidhje me këtë element, është shprehur se masa e rëndë e dënimit që parashikon dispozita penale nuk mund të jetë faktor që të krijojë bindjen tek gjyqtari se ekziston rreziku i ikjes së personit të dyshuar. Gjithashtu ajo ka theksuar se efekti i vendimit të autoritetit gjyqësor sipas neni 5&3 të Konventës është që të sigurojë paraqitjen e personit të dyshuar në gjyq dhe masa e arrestit me burg, si më ekstremja, jepet vetëm kur gjyqtarët krijojnë bindjen se masat e tjera janë të papërshtatshme..”, (shih vendimin nr. 22, datë 25.6.2015, i Gjykatës së Lartë).

të dyshuar, vështirësitë ekonomike që mund të ketë, etj.” Në rastin konkret shpjegon ai, rezultoi e provuar se personi nën hetim ka qenë i padënuar më parë, është me arsim të lartë, me gjendje civile “i martuar” dhe baba i dy fëmijëve të mitur, nëna e tij është invalide, rrethana që krijojnë dyshimin se kjo ngjarje mund të jetë një episod i shkëputur nga jeta e tij.

74.2. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se në lidhje me personin nën hetim, P.N, ka konstatuar ekzistencën e kritereve të përgjithshme për caktimin e një mase me karakter shtrëngues (nenet 233 – 238, të K.Pr. Penale). Ndërsa në lidhje me kushtet e veçanta, ka analizuar se masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” e alternuar me mbikëqyrje elektronike, nuk lejon ikjen e personit, cenimin e procesit të marrjes së provave apo rrezikun e kryerjes së ndonjë vepre tjetër penale. Në vendimmarrjen e tij, ka pasur në konsideratë orientimet e Gjykatës së Strasburgut (GJEDNJ), si edhe të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, që *masa e rëndë e dënimit që parashikon dispozita penale nuk mund të jetë faktor që të krijojë bindjen tek gjyqtari se ekziston rreziku i ikjes së personit të dyshuar.*

74.3. Gjithashtu, subjekti ka referuar faktin se personi nën hetim, P.N, ka qenë prezent gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit, e cila ka prishur vendimmarrjen e tij dhe si pasojë, është hetuar me masën e sigurimit “Arrest me burg” dhe se në gjykimin e themelit të çështjes gjykata e ka deklaruar fajtor dhe ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burg, për pjesën e pavuajtur të dënimit.

Vlerësimi i Komisionit

75. Nga shqyrtimi në tërësi i çështjes së mësipërme, dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me të, si edhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, pa i hyrë logjikës së arsyesimit dhe vlerësimit mbi vendimmarrjen që lidhet me themelin e çështjes, Komisioni çmon se edhe në këtë rast ajo është bazuar në bindjen e brendshme të gjyqtarit Dosti, në verifikim dhe analizë të kushteve/kritereve të përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara nga legjislacioni penal për caktimin e masës së sigurimit personal dhe llojit të saj. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerëson se duken bindëse shpjegimet e subjektit mbi vendimmarrjen e tij lidhur me këtë çështje dhe, si rrjedhim, arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektit e rivlerësimit, gjyqtarit Arben Dosti.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

76. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, dy çështjeve të tjera të trajtuara nga Komisioni, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

76.1. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

IV. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

77. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 3.12.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)

Kryesuese

Pamela QIRKO

Relatore

Brunilda BEKTESHI

Anëtare

Amela Idrizi

Sekretare gjyqësore